

## Arkitektura si mjet ndërtimi dhe shkatërrimi

### Forum Albania

Dokumentime: *Konkursi ndërkombëtar për transformimin e "Piramidës"*

Shkatërrimi si simbol për një të ardhme më të mirë / *Artan Raça*

Piramida midis të shkuarës dhe së ardhmes / *Arben Shtylla*

"Piramida" / *Artan Fuga*

Rikuperimi i boshllëqeve urbane në Medinën e Tripolit / *Dorina Papa*

Legjislacioni për mjedisin pa barriera / *Blerta Çani, Bardhylka Kospiri*

Të njohim arkitektët Shqiptarë: *Arkitektja Valentina Pistoli*

1.60 Insurgent space / *ditar i hapësirave intime të Tiranës*

Java ndërkombëtare e arkitekturës në Shkup / *Janku, Burda, Kovaçi*

### Forum International


Two different ways to be a successful architect / *Raimund Fein*

L'abitare tra innovazione e tradizione / *Andrea Lofi, Herald Qyja*

Architecture Pritzker Prize 1998 / *Renzo Piano*

### Editorial / *Sotir Dhamo*

Ndërtimi përmes shkatërrimit dhe shkatërrimi përmes ndërtimit





## Revistë Periodike Shkencore:

© Besnik Aliaj, Sotir Dhamo, Dritan Shutina



### Kontakt:

Rr. Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar  
KP 2995, Tirana Albania  
Tel:+ 355.(0)4.24074 - 20 / 21  
Fax:+ 355.(0)4.2407422  
Cel: +355.(0)69.20 - 34126 / 81881  
forum\_ap@universitetipolis.edu.al

**Ky numër u mundësua nga Universiteti POLIS & Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit**

Mirënjohje për Ministrinë e Turizmit, Rinisë Kulturës dhe Sporteve për materialet e konkursit ndërkombëtar për transformimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "P Arbnori" në Teatër të Dramës dhe Qendër të Arteve Pamore

**Këshilli i Redaksional:** Dr. Peter Nientied (Holandë)  
Dr. Vera Bushati  
Dr. Besnik Aliaj  
Dr. Arben Shtylla  
Dr. Gëzim Qëndro  
Prof. Thoma Thomai  
Prof. Dr. Vezir Muharremaj  
Prof. Dr. Nasip Meçaj  
Prof. Dr. Hamlet Bezhani  
MSc. Ark. Doris Andoni  
MSc. Ark. Sotir Dhamo  
MSc. Ing. Dritan Shutina  
MSc. Ark. Rudina Toto

**Konsulentë:** Ark. Artan Raca  
Ark. Kristi Andoni

**Drejtor:** Besnik Aliaj


**Kryeredaktor:** Sotir Dhamo

**Redaktor letrar:** Prof. Naim Balla

**Redaktoi në Anglisht:** Kleitia Vaso

**Art Design / Layout:** 

**Shtypur nga:** 



# Përmbajtja

## Editorial

### Ndërtimi përmes shkatërrimit dhe shkatërrimi përmes ndërtimit

Ndërhyrjet "antiqytet", kontekstualizmi urban dhe transformimi evolutiv i kontekstit

Sotir Dhamo.....9

## Forum Albania

### Speciale "Piramida"

Dokumentime në Arkitekturë

Konkursi ndërkombëtar për transformimin e

"Piramidës".....40

### Shkatërrimi si simbol për një të ardhme më të mirë

Artan Raça .....98

### Piramida midis të shkuarës dhe së ardhmes

Arben Shtylla .....108

### "Piramida"

Artan Fuga .....110

### Rikuperimi dhe transformimi i boshllëqeve urbane në Medinën e Tripolit, Libi

Dorina Papa .....114

### Standarde të panjohura apo të pazbatuara?

Legjislacioni shqiptar dhe mjedisi pa barriera

Blerta Çani, Bardhylka Kospiri .....144

### Të njohim arkitektët Shqiptarë: Arkitektja Valentina Pistoli

Sotir Dhamo .....154

### 1.60 insurgent space

Ditar pamor i Tiranës dhe hapësirave të saj intime

Një reflektim sesi mund të hyhet nëpër të çarat e arkitekturës | zhvillimit shoqëror, nëpërmjet artit dhe aftësia e tij sintetizuese.

Stefano Romano .....160

### SAW - Java Ndërkombëtare e Arkitekturës në Shkup

Pas përfaqjes me "Bigness" ... titujt nuk vlejnë më

Eranda Janku, Mamica Burda, Elios Kovaçi .....168

## Forum International

### Two different ways to be a successful architect

Raimund Fein .....188

### Vienna, l'abitare tra innovazione e tradizione

Andrea Lofi, Herald Qyqja .....192

### Architecture Pritzker Prize 1998

Renzo Piano .....204







PROTECT the PYRAMID (join us every Saturday)  
by DJ MIKO

MBAJE MENDJEM  
NE QIELL

D.K.  
4ever  
Kaush  
ENBO  
B.I. 2010 E  
BALLU













ASCIOS

FIRONA  
FANTRICS  
BY M. M. M. M.





TINJER  
AMALA  
ZURRI



# NDËRTIMI PËRMES SHKATËRRIMIT DHE SHKATËRRIMI PËRMES NDËRTIMIT

ndërhyrjet “antiqytet”,  
kontekstualizmi urban  
dhe transformimi evolutiv i kontekstit

Sotir Dhamo

Metropoli e ka këtë forcë të madhe tërheqëse, që përmes asaj që është shndërruar mund të mendohet me nostalgji për atë që ka qënë<sup>1</sup> (I. Calvino). Edhe pse materiali në vijim ka qënë përgatitur prej kohësh, mendoj se mund të vlejë si një guidë teorike për të shqyrtuar disa pista arsyetimi në lidhje me qëndrimet që mund të mbajmë në një kontekst të caktuar për vazhdimësinë e tij, ose “fshirjen” dhe ndërprerjen e menjëhershme të lidhjeve të tij me pjesën tjetër të kontekstit fizik dhe social, apo edhe transformueshmërinë e tij në kuptimin e evoluimit në një formë tjetër. Artikulli synon të tregojë se qëndrimet lidhur me “fshirjen” apo “vazhdimësinë” e një objektit përfaqësojnë vetëm ekstremet. Po të çlirohemi nga emocionet e shkaktuara nga koniunktura të përkohshme do të kuptojmë se hapësira e të menduarit është shumë më e thellë dhe mundësi krijuese, se sa vetëm ekstremet. Artikulli synon të rikujtojë vetëm disa prej tyre.

## Ndërtimi përmes shkatërrimit

Qytetet kurrë nuk marrin formën përfundimtare, ato nuk ndalen në procesin e tyre të përshtatjes me format e reja të jetës. Kjo përshtatje përndahet në të gjitha qelizat e tij dhe ndeshja / beteja e asaj që vjen me atë që shkon krijon atë tablo që shohim. Por në se kemi ndeshje, “luftë”, apo përshtatje (urbane), kjo varet nga faktorë të ndryshëm që ekskluzivisht ekzistojnë në atë qytet. Transformimi i një qyteti nuk ndodh vetëm duke ndërtuar, por edhe duke “shkatërruar”. Si dhe sa? Ky është problemi. Historia e arkitekturës ka pasur qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Të njohura me termin “perceptions”<sup>1</sup>: shembje në shkallë të gjerë dhe në vijë të drejtë për të krijuar rrugë krejtësisht të reja, u përdorën së pari tek ai që njihet si “plani i artistëve” për Parisin në vitin 1793. Piktori Jacques-Louis David drejtonte një komision artistësh revolucionarë. Kjo lidhej edhe me tendencën franceze

<sup>1</sup> Framton, *Storia dell'architettura moderna*, Zanichelli, 1993, fq 15, 16.



Sotir Dhamo është arkitekt urbanist me eksperiencë të gjerë profesionale në fushën e dizajnit dhe planifikimit urban, autor i disa studimeve që fillojnë nga Instituti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Ministria e Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit, Go-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, etj. Sotiri është një nga bashkëthemeluesit dhe drejtuesit e Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban në Tiranë. Ai mban gjithashtu gradën “Master” në Administrimin Publik të fituar në SHBA në universitetin e Syracuse, NY. Aktualisht S.Dhamo është edhe lektor i lëndës së Analizave Urbane në Universitetin POLIS me fokus të veçantë transformimet dhe zhvillimet e hapësirës në nivel urban dhe territorial.



## ABSTRACT: FROM "URBICIDE" TO THE CONTEXT EVOLUTION

This article focuses on some traditional and alternative approaches regarding the different degrees of intervention in the city fabric. Their impact on the urban context is different. By presenting some evidence about such interventions, the article stresses the idea that there is still a lot of room for further exploration and experimentation. This exploration can be achieved only if architects and urban planners use creative and alternative thinking that goes beyond the anti-city approach of the modernists and the postmodern contextualism. Neither of these approaches explains the true complexity. The evolution of the context based on the concept of "becoming", conceived by the philosopher G. Deleuze, opens a new direction of thinking that great potential to be experimented with in architecture and urban design. From this perspective the rhetoric about "erasing" or "conserving" a building or a context is too simplistic, and in both cases the risk is the isolation of the context from the rest of the city fabric and its social life.

In addition, the article presents some evidence from the history of architecture, showing that in some cases political decisions about "erasure" at a large scale impacted not only the city where such a method was applied, but also other cities, introducing a new era in city development, such is the case of "percements" in the Hausmannian Paris. There exist also other cases of demolition at a large scale during the modern time, which were implemented in some degraded high-rise residential areas as a remedy for the high

për racionalitet. Plani i artistëve ishte treguesi për strategjinë e bulevardëve, që u shndërrua në instrumentin e rindërtimit të Parisit në kohën e Napoleonit të Tretë. Ky i fundit dhe Baroni George Haussmann lanë gjurmët e tyre të "forta" jo vetëm në Paris, por edhe në qytete të tjera të mëdha të Francës dhe të Europës Qendrore, ku ndodhën transformime "haussmanniane" gjatë gjysmës së dytë të shekullit pasardhës. Kështu në vitin 1853 Haussmanni në cilësinë e Prefektit të Senës u detyrua të ndërmarrë këto operacione për shkak të kushteve shumë të këqija në Paris përfshi ndotjen e ujit të pijshëm, mungesën e kanalizimeve, mungesën e hapësirave boshe për varreza dhe parqe, zona të gjera me banesa të ndyra, si edhe trafikun e rënduar. Zgjidhja radikale e propozuar nga Haussmann-i ishte "percements" për të përmirësuar aspektin fizik të këtij problemi kompleks. Kështu, sikurse thotë Choay, Parisi u transformua nga një qytet i organizuar përreth lagjeve tradicionale në një metropol të bashkuar


"nga ethet e kapitalizmit"<sup>2</sup> (tek Frampton). Struktura urbane ekzistuese u "pre" nga rrugët, të cilat synonin të lidhnin pikat kryesore dhe distriktet, që qëndronin në anë të kundërta.

(Seria 1 "Percements" dhe Parisi i vjetër)

Në po këtë kuptim vlen të përmendet qëndrimi i disa autorëve të fazës së parë të arkitekturës moderniste, ku me tipiku është Le Corbusier, propozimet urbanistike të të cilit kërkonin t'u jepnin përgjigje një shoqërie të rindërtuar. Për këtë arsye qëllimi kryesor i ndërhyrjeve të këtij lloji ishte manifesti. Nga kjo mund të kuptohet edhe arsyeja e përzgjedhjes nga ana e tij në mënyrë gati mekanike e "monumenteve të mëdha"<sup>3</sup>. Kjo, në fakt, krijoi një paradigmë të re të ndërhyrjeve në qytet të bazuar në simbolin e "Phoenix-it". Ato ilustronin

2 Frampton, po aty.

3 Rowe, Colin. dhe Koetter, Fred (1978) *Collage city* (tenth printing 2001, The MIT Press, Cambridge, Massachusetts and London, England) (fq. 71-77).




Seria 1:  
"Percements" dhe Parisi i vjetër







Seria 1:  
"Percements" dhe Parisi përpara Haussmann-it  
Avenue de l'Opéra, 1877



në periferi të Amsterdemit, i cili në origjinën e tij u "propagandua" si qyteti i së ardhmes. Në të dyja rastet shembjet u motivuan pasi shpenzimet për mirëmbajtjen e tyre si edhe kostot e segregimit social ishin shumë të larta. Komplekset u kthyen në të kundërtën e arsyes për të cilën ishin ndërtuar. Në të dy rastet u synua që komplekset e mëdha dhe me tipologji standarde të zëvendësoheshin me tipologji më të variueshme dhe në shkallë


më të vogël, përveç faktit që në rastin e dytë disa nga ndërtesat e kompleksit original janë ruajtur si pjesë e diversitetit, që duhet të ofronte zona dhe si pjesë e dëshmisë se si ka qenë ndërtuar kompleksi sipas idesë origjinale.

(Seria 3 shembjet e Pruitt Igoe dhe Bijlmermeer)

## Urbicidi<sup>6</sup>/ Çau\_shima

Format dhe qëllimi se si çndërtojmë  
6 "Urbicide" është një term që vjen nga bashkimi i dy fjalëve latinisht "urbs" që do të thotë "qytet"; dhe "occido" që do të thotë "të vrasësh". Nënkup-ton "dhunë kundër qytetit"; Nga Wikipedia <http://en.wikipedia.org/wiki/Urbicide>.

/ shkatërrojmë janë një tregues se si funksionon një shoqëri. Ndërsa në rastet e sipërpërmendura operacionet e forta mbi trupin e qytetit duket se fitojnë një konsensus relativisht të gjerë pasi motivohen ose nga misione profesionale të eksperimentimit në shkallë të madhe, ose nga aksione politike të caktuara; ka edhe raste kur vendimet për "shkatërrimin" e pjesëve të qytetit apo edhe të objekteve të veçanta janë të njëanshme, ose në rastin më të mirë të diskutueshme për efektshmërinë e tyre. Kur ky "pastrim"



"Pastrimi" i lagjeve të vjetra për ndërtimin  
e "Avenue de l'Opéra", 1876



"Rue Champlain",  
nuk eksiton më, 1858





apo tjetërsim arrin përmasa të impaktit në shkallë të madhe dhe merr formën e “dhunës në trupin urban” apo në hapësirën e organizuar, mund të klasifikohet në atë që Michael Moorcock<sup>7</sup> në vitin 1963 e ka quajtur “urbicid” për paralelizëm me termin gjenocid. Më tej ky term u përdor nga kritikët e ristrukturimeve urbane të viteve '60 në SHBA. Ada L. Huxtable më 1972, si edhe Marshall Berman (shkrimtar

<sup>7</sup> Përdorimi i parë i termit “urbicide” nga Michael Moorcock u bë në novelën “Dead God’s Homecoming” (Science Fantasy #59, Nova Publishing, June 1963); Nga Wikipedia.

dhe teoricien politik marksist amerikan) më 1996 shkruajnë për destrukturimet urbane në zonat, si Bronx duke u ndalur në impaktin e rihvillimeve agresive në kontekstin urban dhe social. Pas ngjarjeve të luftës në Sarajevë termit iu dha edhe ngjyrimi i shkatërrimit të zonave urbane përmes dhunës së luftës. Po ashtu, Bill Millard<sup>8</sup> shkruan në vitin 2004 në artikullin e tij në librin Content (botuar nga Rem Koolhaas) “Dhuna kundër

<sup>8</sup> Bill Millard, në librin Content, artikulli “Violence against architecture”: Quixote Comes of Age in Sarajevo”, Rem Koolhaas, 2004, fq. 38-43.

arkitekturës: Don Kishoti kthehet në Sarajevë”. Këtu ai flet për sulmet ndaj objekteve të monumenteve të kulturës dhe infrastrukturës, si xhami, kisha, sinagoga, muzeume, biblioteka, tregje, kafene, banesa, ura, në tentativën për të çrrënjosur qytetin dhe shenjat fizike të ekzistencës së një kulture hibride. Në po të njëjtin artikull ky autor jep edhe disa shembuj të tjerë urbicidi, si në Lagos, Nigeri në vitin 1956 për shkak të politikave të



Tanneries përgjatë Lumit Bièvre (aktualisht i mbuluar), 1868





Këndi nga "Rue de la Colombe" dhe "Rue Basse-des-Ursins", në Ishulli "la Cité"



Banesa të punëtorëve ne suburbët e Parisit



"Rue de l'Arbalète", 1865

Seria 1: "Percelements"  
dhe Parisi përpara Haussmann-it

ndjekura nga qeveria për tokën ku shembja e banesave nga shteti u bë arma kryesore në luftën për të drejtat e tokës; në Jerusalem, Bregu Perëndimor dhe Gaza duke filluar që nga vitet 1990-2000 ku urbicidi ka ndodhur për shkak të ndërtimeve dhe shkatërrimeve të përsëritura; etj. Sipas Marshall Berman-it, urbicidi është nga historitë më të vjetra në botë. Ai thotë se në Dhiatën e Vjetër në librat e Jeremiah-ut dhe Lamentations-it flitet për urbicidin. Perandoria Romake kërkoi shkatërrimin e plotë të Jerusalemit sikurse edhe paqen shkatërruese të Kartagenës<sup>9</sup>; edhe pse këto të ishin të përkohshme.

Meqenëse ky term i tejkalon kufijtë e një fushe të vetme dhe shtrihet që nga politika ndërkombëtare, antropologjia dhe sociologjia e bën mjaft të vështirë të gjendet

<sup>9</sup> **Carthaginian Peace** can refer to the *peace imposed on Carthage by Rome in 146 BC, where by the Romans systematically burned Carthage to the ground; From Wikipedia.*

një përkufizim që të kënaqë të gjitha këto fusha. Kjo e bën të diskutueshme atë se çfarë mund të klasifikohet brenda termit "urbicid", por mund të themi se ky term është përdorur nga studiuesit, arkitektët apo planifikuesit për të nënkuptuar ato situata, ku qytetet janë apo kanë qenë pjesë e luftës së drejtpërdrejtë apo të çfarëdo lloji dhune të ushtruar mbi kontekstin fizik. E rëndësishme është të kuptohet gjithashtu se cilat mund të jenë shkaqet e urbicidit. Gjatë jetës së tyre, ndërtimeve i'u është dashur të përballen me shumë ndryshime, duke filluar që nga ndryshimet e strukturave shoqërore e deri tek luftërat. Ajo që shohim në qytet është shpesh rezultat i tensioneve të shtrira gradualisht në kohë apo i ndërhyrjeve të përnjëhershme në një moment të caktuar.

Është me interes të sjellim edhe një variant tjetër të termit "urbicid",





“Rue de l’Arbaete”, 1865

“Rue Fresnel”, ana e majtë, 1865

që pasqyron po të njëjtin fenomen në Rumaninë e periudhës së Çausheskut. Ky i fundit ka “kontribuar” në shkatërrimin e qendrës historike të Bukureshtit për të ndërtuar blloqe apartamentesh standarde me dendësi të lartë dhe zyra qeveritare. Ndër operacionet më të mëdha ka qenë ai për ndërtimin e “Shtëpisë së Popullit”, ose atij që sot është pallati i parlamentit. Për të ndërtuar këtë kompleks autoritetet komuniste ndërmorën një program masiv të shembjeve (në 500 ha) gjatë të cilit banorëve iu lanë në dispozicion vetëm 72 orë për të lëvizur përpara se buldozerët të hynin në zonë. Kjo u duk si një bombë atomike që ra mbi qytet dhe kështu zona mori emrin “Ceaushima” = Ceausescu + Hiroshima<sup>10</sup>; i cili në mënyrë sarkastike lidh Çausheskun me Hiroshimën. Ky term

u përdor gjatë viteve ’80 për të përshkruar shembjen e zonave të mëdha në Bukuresht me urdhër të presidentit Çaushesku duke krahasuar rezultatet me ato të sulmit atomik në Hiroshima. Historiani D C Giurescu<sup>11</sup> shkruan se sistemimet urbane të ndërmarra nga regjimi komunist shkatërruan 29 qytete tradicionale në masën 85-90 % dhe gjymtuan rëndë 37 qytete të tjera përfshirë edhe Bukureshtin.

(Seria 4 Çaushima për ndërtimin e “Shtëpisë së Popullit”)

Në fakt, ne shpesh mendojmë vetëm si ndërtohet qyteti, duke neglizhuar faktin se si shkatërrohet ai, me ose pa dashje. Shkatërrimit, që është pjesa tjetër e ciklit të jetës së ndërtimeve, i kushtohet më pak vëmendje nga sa ai duhet të meritonte. Për interesat e këtij artikulli do të na duhet të

<sup>10</sup> Nga Wikipedia: <http://en.wikipedia.org/wiki/Ceau%C5%9Fima>.

<sup>11</sup> Wikipedia, po aty.




bëjmë një analizë paksa jo të zakonshme, duke marrë parasysh se edhe shkatërrimi sikurse ngritja e ndërtimeve është pjesë e vendimeve të rëndësishme të njeriut. Nga një këndvështrim arkitektonik qytetet mund të konsiderohen si një konglomerat

me vendime administrative? Shembujt më poshtë na bëjnë të mendojmë edhe njëherë.

## Nga cikli “Urbicidi” në Tiranë – dhuna kundër arkitekturës

Historia e Tiranës dhe qyteteve të tjera shqiptare tregon se jo pak herë ato



*Seria 2:  
Krahasimi i “Plan Voisin” në Paris, Le Corbusier 1925 dhe “Royal Chancellery” në Stokholm, Asplund 1922*

masash dhe hapësirash, që vijnë nga agregimi i formave të ndryshme sociale dhe kulturore. Kjo gjë i jep atyre cilësinë interesante të të qenit heterogjenë. Sikurse pohon Henri LeFebre (sociolog dhe filozof francez), shkatërrimi i qytetit apo pjesëve të veçanta të tij mund të konsiderohet si një tentativë për të shkatërruar ambientin fizik që mbart heterogjenitetin e qytetit.

Epoka e zhvillimeve globale ka vënë përsëri në shënjestër kontekstin e qytetit përmes “erozionit” më gradual. Por përse dhe si ne “çndërtojmë” pas gjithë mundimit që kemi bërë për të ndërtuar? A është e mundur të gjendet ekuilibri dhe të shmangen gabimet kur kemi të bëjmë

janë përballur me dhunën në arkitekturë dhe urbanistikë. Ky është një koncept pak i njohur nga pikëpamja terminologjike në Shqipëri, por është shumë i përdorur në “trupin” e qyteteve tona sidomos gjatë periudhës së regjimit komunist. Në këto raste “urbicidi” ka pasur më shumë natyrën e vendimmarrjeve administrative për qëndrime ideologjike dhe manovra strategjike të caktuara: ndërprerja e lidhjeve me të kaluarën (sindromi i “feniksit” për arsye të tjera nga ato të përmendura më sipër). Po ashtu, edhe gjatë periudhës pas vendosjes së sistemit pluralist, vendimmarrja administrative ka qenë preja e interesave të ngushta të cilat filluan të “errodojnë” qytetin









*Bijlmermeer, gjendja në vitin 1992 dhe parashikimi për vitin 2010*

planet rregulluese si instrumenti kryesor i përdorur për transformimin e qyteteve, propozonin në mënyre sistematike zonat të cilat do t'i nënshtroheshin transformimit tërësor që fillonte nga shembja e tyre. Qasja “antiqytet” përfaqësohej më së miri në shprehjen e përdorur në atë periudhë: “Ra plani”. Si të tilla trajtoheshin kryesisht zonat tradicionale të qytetit me banesa 1-2 katëshe.

Tirana e “Rrugës së Barrikadave”, ose siç quhej më parë “rruga e çarshisë”, konsiderohej si një nga arteriet e para tregtare dhe më të preferuara të zonës qendrore të Tiranës. Ajo arriti deri në fillim të viteve '80, kur u prish për ndërtimin e “Kullave të Rrugës së Barrikadave”, të cilat ishin pjesë e modelit të “qytetit të ri”. Kjo rrugë ende sot nuk ka marrë formë. “Prodhimi i një hapësire “ameboid”







krejtësisht të kundërt me paraardhësen ishte rezultati i vetëm. Në fakt qëllimi i vërtetë për të cilin u krye ky operacion urban u arrit: “fshirja fizike” e rrjetit të lidhjeve me “të vjetrën”: “mbeturinat” e fundit të Pazarit të Vjetër dhe lagjet e tregtarëve të dikurshëm. Konteksti fizik i tyre dukej se nxiste një sërë shkëmbimesh të cilat duheshin zëvendësuar. Kjo u arrit me ndryshimin me forcë të kësaj forme të organizimit të hapësirës. Në vend

të tyre u krijua konteksti fizik i “pallateve të hedhura” në distancë midis tyre, të cilat edhe pse qëndronin ndanë rrugës, nuk bënë kurrfarë lidhje me të dhe mbi të gjitha, qëndronin krejtësisht “armiqësore” ndaj asaj pjese të lagjes që ende kishte mbetur. Kjo nuk ishte më “Rruga e Barrikadave” ca më shumë ajo e “çarshisë”. “Pallatet” edhe pse nga pikëpamja arkitektonike u trajtuan në mënyrë të veçantë dhe sollën skema të

*Seria 3 shembjet e Lagjeve Pruitt Igoe në Saint Luis, SHBA dhe Bijlmermeer në Amsterdamin e jugut, Hollandë*

*Seria 4: Çaushima për ndërtimin e “Shtëpisë së Popullit”*





Seria 5:  
Rruga e "Barrikadave"  
përpara dhe gjatë shkaterimit







arkivi i filmit



arkivi i filmit



arkivi i filmit



arkivi i filmit



arkivi i filmit



arkivi i filmit



arkivi i filmit



arkivi i filmit







*Rruga e "Barrikadave" përpara shkatërrimit*

papërdorura deri atëherë në Tiranë, të vendosura kaq "ftohtë" ndaj kontekstit urban, dukej se mund t'i gjeje kudo nëpër Shqipëri.

(Seria 5 Rruga e Barrikadave dhe shkatërrimi i saj)

(Seria 5' shkatërrimi dhe ndërtimi i "Kukësit të vjetër")

Disa vite më parë nga ngjarja e mësipërme, në sheshin qendror të Tiranës u krye një tjetër akt, i cili në logjikën e sotme është i diskutueshëm. Në vend që sheshi qendror i Tiranës të plotësohej me ndërtesat që kishin mbetur pa u realizuar nga projekti i vitit 1931 të Florestano De Faustos, u pa më e arsyeshme të shembej objekti i shtatë: "Bashkia e Vjetër e Tiranës" (përfunduar më 1931) dhe kështu të krijohet simetria e munguar. Shpesh në ditët e sotme i referohemi me keqardhje ketij veprimi

të shembjes spektakolare me teknika dinamiti, e cila së bashku me shembjen e objekteve të tjera pranë saj (përfshi edhe "Kafe Kursal" dhe gështenjat e vjetra), do të krijonte hapësirën për ndërtimin e atij që sot është Muzeu Historik Kombëtar. Sot, edhe pse me vonesë, e kuptojmë se edhe ky operacion nuk bëri gjë tjetër veçse kontribuoi në zhdukjen e memorieve, si edhe përforcoi vakuumin e qendrës që sa vinte e bëhej më i madh, duke zhdukur gradualisht orientuesit e kufijve të hapësirës konkrete dhe duke u larguar gjithmonë e më shumë nga projekti origjinal i saj. Objekti i Muzeut Historik Kombëtar i ngritur në pedestal shkallësh, mundi të "sillej" mjaft mirë si një "hapësirëzënë", por nuk mundi kurrë të "sillet" si një hapësirë përcaktues. Këtë veti nuk e ka arritur akoma edhe sot. Vakuumi që e rrethonte atë nuk mundi





kurrë të zëvendësonte rolin e një rrjeti të tërë hapësinor dhe rrjeti marrëdhëniesh, që u “fshinë” për ndërtimin e tij.

(Seria 6 shkatërrimi i Bashkisë së vjetër dhe rrjetit hapësinor rreth saj)

Këto dy ngjarje të përshkruara më sipër nuk janë të vetmet operacione shkatërrimi. Me kryerjen e këtyre lloj ndërhyrjeve, gradualisht njeriu po ndihej i “huaj” në grumbullimet e “gjithkundgjeshme” të ndërtesave. Elementet bazë të “ankorimit” të tij u zhdukën. “Aksi orientues” i zhvillimit hapësinor dhe historik të qyteteve humbi. Identifikimi dhe orientimi të kuptura si funksione bazë të të banuarit, u cenuan rëndë. Kjo tronditi lidhjet e njeriut me vendin konkret dhe mbështetjen ekzistenciale të tij kaq të rëndësishme për mirëqenien shpirtërore në një vendbanim. Hapësirat e reja të

krijuara nuk ishin në gjendje të ofronin “fyturë” të re, përveç se gjendjes së zbrazëtisë dhe të “askujtgjëse”. Ndërtimet e “reja” më shumë se sa të krijonin një rrjet urban kontribuan në “shqyerjen”, “dhunimin” dhe ndërprerjen e vazhdimësisë. Ky proces varfërimi shpirtëror në rritje dhe varfërimi ekonomik, krijuan një cikël vicioz, i cili çoi në përkeqësimin e mëtejshëm të të dyjave. Nga këto shembuj mund të kuptojmë shumë qartë se urbicidi është një mënyrë për të fshirë diferencat / identitetin që dikush tjetër ka krijuar dhe për të përmbysur mënyrën se si zhvillohen marrëdhëniet sociale. Kërkesa për këtë të fundit mund të ketë frymëzim për arsye të ndryshme, si politike, ideologjike, etnike, ekonomike etj. Gjatë periudhës së diktaturës në Shqipëri këto kishin një frymëzim të qartë ideologjik.


*Bashkia e vjetër e Tiranës përpara shkatërrimit*



## Shkatërrimi përmes ndërtimit

“Ndërtim-shkatërrimi” i qyteteve tona, i nisur në këtë mënyrë, edhe gjatë 20-vjeçarit që do të ndiqte, nuk mund të ishte ndryshe

në se gjatë diktaturës ndodhi “fshirja” e përnjëhershme e lagjeve të tëra përmes instrumentit të planit, kjo fazë e re e la qytetin në mëshirën e “erozionit” gradual të



*Seria 6:  
shkatërrimi i Bashkisë së vjetër dhe  
rrjetit hapësinor rreth saj*


veçse vazhdimi i “agresionit” gradual. Nuk ishte e rastit që në këto hapësira pa konsistencë të lulëzonte anarkia e plotë e ndërtimeve si shprehje e moralit predominues të kohës: fitimit të viteve të humbura dhe fitimit sa më të shpejtë. Tashmë urbicidi përmes ndërtimit “të pamenduar” filloi të sulmojë “qelizën” e qytetit: një ose disa sheshe ndërtimi. Edhe pse krahasimisht në përmasa me qytetin ky “virus” është i vogël, ai është i përhapur gjerësisht në qytet dhe dita dites po gërryen çdo cep dhe lagje të Tiranës, madje po bëhet i dukshëm edhe në lartësi. Kështu,

shtrirë në të gjithë qytetin. Këto ndërhyrje “të vogla” kryhen tashmë në emër të “rregullave”, të cilat shiten si “të vërteta” me status dhe nën alibinë e mungesës së planit si një vizion i përgjithshëm. Sipas këtyre rregullave “hapësirëngënëse”, hapësira kuptohet vetëm në terma gjeometrike dhe nuk tregohet vëmendje për kritere të tjera të kualitetit të hapësirës. Rreziku i shfaqur në qytet përmes këtij urbicidi gradual është edhe më i madh. Këtu përfshihen edhe rastet kur përmes neglizhencës, mosvëmendjes dhe mosndërhyrjes, arrihet në degradimin e plotë të një objekti, i cili si “rrugë të vetme” të



mëtejshme ka shembjen. Çdo lloj ndërtese mund të “na lerë” në momentin që ne nuk i kushtojmë më rëndësi, e keqpërdorim apo nuk arrijmë të hyjmë më në komunikim me

të brendshme të qendrës tregtare mbi të cilën ngrihet edhe banesa shumëkatëshe. Në se ishte kështu atëherë të mos e prishnim. A nuk do të ishte më profesionale që pjesë



potencialin, që ende mund të ketë për të ushtruar influencën mbi ne.

(Seria 7 “virusi shesh”: shkatërrimi i hotel “Butrintit”, Plazh Durrës dhe i vilave të mbetura)

Kinema “17 Nentori”, u la për një kohë të gjatë jashtë vëmendjes. Të gjithë mund të mbajnë mend kolonadën modeste të kinemasë, nën të cilën mund të kenë pritur radhën për të marrë një biletë apo edhe për të hyrë në shfaqjen e filmit. Keqardhje edhe me të madhe mund të ndiesh sot kur shoh “copy-paste-in” e trishtë të hyrjes së kinemasë që është “plagjuar” mbi një fasadë

originale të kinemasë të integroheshin me ndërtimin e ri? Apo qoftë edhe interpretimi i saj përmes konotacioneve asociative; por jo imitimi i saj i drejtpërdrejtë ... (Natyrshet në se do të mirëkuptonim se ndërtimi në atë vend ishte i pashmangshëm) Po kështu ndodhi edhe me Kinema “Partizanin” dhe të tjera.

(Seria 8 Shkatërrimi i kinemave “17 Nëntori”, “Republika”, “Agimi”, “Ali Demi”)

(Seria 9 Shkatërrim i “Kinema Partizanit”)


Duhet pranuar pa kompleks se shpesh



Seria 3:  
shkatërimi i "Kukësit të Vjetër"  
dhe ndërtimi i "Kukësit të Ri"









Seria 5:  
shkatërrimi i "Kukësit të Vjetër"  
dhe ndërtimi i "Kukësit të Ri"









urbicidi është bërë pjesë e mendjes së arkitektëve dhe urbanistëve. Kjo buron jo vetëm nga arsye korruptive, por më shumë nga mungesa e edukimit që reflektohet në mungesën e ndjeshmërisë, e cila është në stade primitive dhe pre e koncepteve vetëm teknikiste. Kjo përforcohet edhe me shumë nga dembelizmi dhe mungesa e pasionit për të eksploruar në mënyrë krijuese dhe jashtë mënyrave standarde të të ndërtuarit në një kontekst të caktuar. Shumica e arkitektëve të cilët kanë ndërtuar në qytet, nuk kanë arritur të dalin mbi mediokritetin që ka karakterizuar në masë shoqërinë tonë këto vitet e fundit.

Të ndërtuarit nuk është vetëm një ndërhyrje e fortë në hapësirë, por ai influencon edhe në sjelljen e njeriut. Kriza e sotme hapësinore i ka rrënjët që në goditjet ndaj “zemrave” të qyteteve, të cilat shkatërruan orientuesit dhe elementet kryesore të strukturimit dhe identifikimit të njeriut. Sikurse thote arkitekti spanjoll Goitia<sup>12</sup>, struktura e qytetit ka për bazë natyrën e njeriut shprehje e të cilit është. Por nga ana tjetër, kjo strukturë e formuar nga procesi jetësor, “punon”, “gdhend” mbi banorët e saj kur ata takohen me realitetin e jashtëm”.

*Forma “vazhdon” (funksioni adaptohet)- “asgjë nuk lind nga asgjëja”*

Procesi në qytet është i pandalshëm. Në se i referohemi historisë së arkitekturës funksionet e hapësirave urbane apo edhe të objekteve të veçanta ndryshojnë në epoka të ndryshme. Kjo fillesë arsyetimi i ka shërbyer arkitektit dhe teoricienit Italian A. Rossi për t’i bërë një nga kritikantët e para *12 Fernando Chueca Goitia, Breve Historia del Urbanismo, Alianza Editorial, Madrid 1996, fq. 30.*

teorisë moderniste të funksioneve dhe për të dalë tek teoria e qëndrueshmërisë së formës. Sipas tij, elementi që shpreh thelbin e arkitekturës nuk është funksioni, por elementi “i fortë” është forma. Përveç shembujve shumë të njohur të përshtatjes së funksioneve sipas kohës, Rossi jep në librin e tij edhe shembuj ekstremë se si funksioni i adaptohet formës, sikurse ka qenë ideja e Sisto V për të transformuar Colosseumin e Romës në fabrikë përpunimi leshi; ku në katet përdhe sistemoheshin laboratorët, ndërsa në katet e sipërme vendoseshin banesat e punëtorëve. Kështu Koloseu do të mund të transformohej në një lagje të madhe punëtorësh dhe një fabrike racionale.

(Foto 10: Forma si element i fortë: Të jetosh në Bunker)

Qyteti vazhdon të “gjenerojë” vazhdimësinë e formës së tij nga elementet e forta të mbetur gjatë historisë. Durrësi me muret e tij tregon mbijetesën në kushtet ekstreme. Kjo lidhet me reaksionin dhe rezistencën që forma e qytetit apo elemente të caktuara të saj paraqesin ndaj “tensioneve” që lindin në pëlhurë për shkak të ndryshimeve historike, apo “agresionit” të çfarëdolloj mënyre qoftë. Shembujt tregojnë “qëndrueshmërinë”, rezistencën e formës dhe aftësitë gjeneruese që ka ajo në vetvete dhe në shkallë urbane. Le të kujtojmë edhe njëherë Qutremere de Quincy: ... arti i të ndërtuarit me rregulla është bazuar në një “gjen paraekzistues” ... “asgjë nuk vjen nga asgjëja” ... pavarësisht nga ndryshime të mëvonëshme, gjithmonë ruhen të qarta principet bazë ... të kaluara përmes arsyes dhe ndjenjave. Këto janë një “bërthamë”, rreth të cilave koordinohen zhvillimet dhe varjacionet në lidhje me



formën. Prandaj tek ne kanë arritur mijëra gjëra. Një nga shqetësimet kryesore të shkencës dhe filozofisë duhet të jetë mënyra se si të zbulojë origjinën e shkakut të parë ...

(Seria 11, Durrësi: mbijetesa në kushtet ekstreme dhe erozioni gradual)

Meqenëse kjo temë është trajtuar në mënyrë specifike dhe gjerësisht në artikullin e Forum A+P 5: “Qyteti dhe dialektika e vetëkrijimit”, këtu po mjaftohem vetëm me përkujtesën e kësaj alternative si një qasje e rëndësishme në vendimmarrjen ndaj kontekstit.

*Evolucion i formës dhe i kontekstit: tërësi unike ... nuk ka më as të vjetër, as të re dhe as kontrast figurë sfond*

Në këtë kuptim, po ta shtyjmë edhe pak më tej mendimin, mund të flasim jo vetëm për vazhdimësi të formës dhe ndryshim të funksioneve, por edhe për transformim të një forme bazë në kuptimin e evolucionit të formës. Forma bazë mund të konsiderohet si një nga shtresëzimet e territorit që mund të pasuronte më tej domethëniet e tij, jo detyrimisht vetëm përmes zhdukjes apo përmes ruajtjes, por “mirëpritjes” së proceseve transformuese, të cilat do të rezultojnë në një situatë të transformuar / evoluar në krahasim me atë të mëparshmen. Kjo do të çonte edhe në një kuptim krejtësisht të ri të “objektit” të parë dhe në raporte të ndryshuara me kontekstin, apo në një kontekst krejtësisht të ri. Ky koncept, që merr parasysh evolucionin është një koncept krejtësisht i ndryshëm nga ai i “tabula rasës” së modernistëve që krijonte “zona të izoluar”, në të cilat kontrasti “figurë-sfond” midis ndërtesave dhe tokës i bazuar në principe funksionaliste dhe ahistorike, krijonte mosvazhdimësinë /

“ndërprerjen” me pjesën tjetër të qytetit.

G. Deleuze në punimet e tij flet për konceptin e “ndryshueshmërisë” / transformueshmërisë (becoming) të kuptuar si kombinimi i procesit të diagnostikimit dhe krijimit. Transformueshmërinë ai e lidh me konceptin e të qënies/egzistencës<sup>13</sup> dhe kjo është një alternativë e konceptit, sipas të cilit, format kanë raporte fikse midis tyre. Ai sjell konceptin e filozofisë së ndryshueshmërisë, si thelbi i realitetit i cili është gjithmonë në fluks. Kështu, tipari kryesor i mjedisit do të ishte procesi i të ndryshuarit. Në këtë kontekst ai flet edhe për ndryshueshmëri kreative (kreative becoming), e cila kombinon komponentin pasiv të ndryshueshmërisë që është gjithmonë prezent nga procesi i përhershëm i ndryshueshmërisë me komponentin aktiv të procesit të jetësuar nga njeriu. Ky është edhe rasti kur një arkitekt ndikon mbi këtë “ndryshueshmëri të vendit” konkret.

Këto ide të Deleuzes në arkitekturë që kanë të bëjnë me raportet figurë - sfond (ky i fundit i kuptuar si ndëveprimi midis kontekstit hapësinor të ndërtesave: linjave të komunikimit, levizjeve, hyrjeve, hapësirave dhe kufizimeve; dhe të vetë ndërtesave), janë krejt të ndryshme jo vetëm nga ato të modernistëve, por edhe nga ato të kontekstualizmit figurë-sfond të postmodernistëve. Nëse këta të fundit vendosin më shumë theksin tek vazhdimësia uniforme historike, koncepti i Deleuzes i provuar edhe nga Esenmani vendos theksin tek evolucionin e kontekstit / transformueshmëria. Sipas konceptit të

<sup>13</sup> James Williams: *Deleuze's Ontology and Creativity: Becoming in Architecture* (Pli 9 (2000), 200-19).



kontekstualizmit postmodernist, çështja reduktohet vetëm në raportet ndërvepruese midis ndërtesave dhe hapësirës boshe midis tyre. Arkitekti zbulon strukturën “e fjetur” në kontekstet historike në mënyrë që të aktualizojë një urbanizëm të ri brenda saj. Kemi të bëjmë pra me një ripërdorim të raporteve historike figurë-sfond në një kontekst të ri. Ndërtesat e reja mëtojnë të “mimetizojnë” me format historike dhe të përsërisin rrjetin e kësaj pëlhure. Por ky kontekstualizëm postmodernist nuk “informohet” nga influencat sociale dhe teknologjike, çka mund të kërkonte një qëndrim më rrënjësor ndaj hapësirës. Ky lloj zhvillimi rrallëherë mund të arrijë kohezionin social dhe energjinë origjinale të rrjetave historike, për pasojë këto lloj hapësirash mund të “vuajnë” nga i njëjti problem i izolimit sikurse edhe hapësirat moderniste. Eksperienca ka treguar se

suksesi dhe vlerat e një hapësire të caktuar nuk qëndrojnë vetëm tek hapësira “në vetvete”.

Përkundrejt kësaj situatë “të vazhdimësisë” që do të dëmtonte zhvillimin e mëtejshëm, Esennman-i flet për “zhvillimin evolutiv” që vjen nga raportet reciproke midis “të vjetrës” dhe “të resë”, raportet figurë-sfond gjithmonë në ndryshim dhe pre e tensioneve si pasojë e ndryshimit të kontekstit social. Kështu, mënyrën klasike të trajtimit të kontrastit figurë-sfond Eisenmani e “kundërshton” duke sjellë konceptin e “shfokusimit” (blurring) të kontrastit përmes “palosjes” përgjatë dhe tërthor linjave, në mënyrë që të krijohet “paqartësia” në hapësirat midis ndërtesave. Sipas këtij koncepti, forma konsiderohet si e “vazhdueshme” duke artikuluar raporte të reja midis horizontaleve dhe vertikaleve,

*Seria 7:  
“virusi shesh”: shkatërrimi i Hotel “Butrintit”,  
dhe i vilave të mbetura në Plazhin e Durrësit*



figurës dhe sfondit. Në këtë mënyrë mund të flitet për një “objekt” të llojit të ri. Kështu, nga koncepti klasik i objekteve që “kornizojnë” hapësirën mund të flasim për “modulime” / kornizime të përkohshme që arrihen përmes ndryshueshmërisë (fizike dhe perceptive) dhe që sjellin ndryshueshmëri të esencës së objektit. Kufinj të hapësirës vihen në “levizje”. Sipas këtij koncepti hapësinor, çdo herë që ne hasim me një “kufi”, skaj apo “hyrje”, ata nuk na ofrojnë një eksperiencë “përfundimtare” / fikse dhe të “sigurtë”, por eksperiencia e shikimit tonë shkrihet dhe transformohet nëpër të gjithë diapazonin e ndërtesave që krijohet nga përsëritja e formave dhe temave. Ajo që i jep identitetin këtij lloji vendi / mjedisi është se ai nuk mund të “kapet” nga një pikë e veçantë, duke krijuar përfundimisht marrëdhënie të reja kohë-hapësirë. Përmes kësaj mënyre, Eisenmani artikuloi edhe

idetë, që mund të jenë prezente në vendin konkret, si historinë e shkuar, ashtu edhe të ardhmen. Këtë koncept ai e zhvilloi në projektin për Rebstockpark, Frankfurt<sup>14</sup> ku ndjek përcaktimet e Deleuzes, në një kontekst kompleks historik, social dhe teknologjik. Në këtë rast mund të konsiderojmë “dizajnin urban, si një tërësi kompakte” ku krijohet vazhdimësi midis konfigurimeve dhe ku ndërveprojnë të gjitha hapësirat, rrugët, ndërtesat, sistemi i gjelbër, zgjatimet e ndryshme etj. Në ndryshim nga dizajni i konceptuar si një “plan ku vendosen volumet”. Në të njëjtën kohë, “rrjeti rregullues i ri-endur” dhe i “pasuruar” me gjurmët e shenjat, krijon një ambient të pasur me “përrjashtime” të menduara, që njëkohësisht i përgjigjet rregullave moderne të funksionit. Disa

<sup>14</sup> James Williams: *Deleuze’s Ontology and Creativity: Becoming in Architecture* (Pli 9 (2000), 200-19).







nga karakteristikat e këtij dizajni kanë të bëjnë me vazhdimësinë përkundrejt mosvazhdimësisë; ndryshueshmërinë (variueshmërinë) e linjave përkundrejt përsëritjes.

E gjithë kjo nuk është gjë tjetër veçse një mënyrë e re e të parit të raporteve të arkitekturës me mjedisin / vendin. “E reja” në vend të shihet si e ndryshme me “të vjetrën”, shihet sikur të

ishte “jashtë fokusit” (blurred) në raport me atë që ekziston. Pasuria e linjave dhe pasuria perceptivë që lind nga kjo situatë “shfokusimi” bën të mundur rakordimin me të tërën, ose “zhvendosjen” e së tërës, pra si të “së vjetrës”, ashtu edhe të “së resë”. Në këtë mënyrë Eisenmani sfidon kontrastin “figurë-sfond” dhe “e tashme-e ardhme”. Ai eviton “mosvazhdueshmërinë” e modernistëve, duke mos u kthyer në nostalgjinë e “konstektualizmit postmodernist”. Kështu Eisenmani gjen vlerën e zhvillimit estetik

brenda vetë problemit dhe e sheh atë më shumë në terma të “transformueshmërisë”, (becoming) se sa në gjetjen e një përgjigjeje përfundimtare të problemit.

Pra tezat e Deleuzes mbi ontologjinë e transformueshmërisë na çojnë në koncepte të rëndësishme të dizajnit, siç janë “palosja jashtëqendrore”, “nxjerrja jashtë fokusit” (blurring) dhe “zhvendosja”. Këto lidhen me kuptimin e koncepteve të “të qënit”/egzistencës përkundrejt “raportit fiks midis formave”. Kjo kërkon të kuptojmë edhe se



Durrës: foto Sotir Dhama



çdo formë mund të ndryshojë në çdo kohë dhe se raporti midis formave është vetë pjesë e kontekstit vazhdimisht në ndryshim. Disa probleme nuk mund të zgjidhen njëherë e përgjithmonë, por duhet të jenë pjesë e procesit krijues.

Ky koncept na hap një pistë krejtësisht të re të mendimit. Koncepti i ontologjisë së transformueshmërisë shpjegon futjen e objektit ekzistues dhe të kontekstit në një proces ndërveprues me objektet “e reja”. Ky proces ndërveprues krijon tërësinë

unike, që nuk ka më as të vjetër, as të re dhe as kontrast figurë-sfond. Sesi mund të shihet rasti i “piramidës” së Tiranës në këtë këndvështrim, kjo do të kërkonte një eksperiment të guximshëm, por jo të pamundur dhe me siguri më të pranueshëm se sa zhdukja.

Mbase në Tiranë do të vazhdojë të thuhet ... “ tek piramida”. Personalisht më pëlqen të besoj tek ajo që I. Calvino<sup>15</sup> thotë  
 15 I. Calvino: *Qytetet e padukshme, versioni i përkthyer shqip, Aleph, 2007, Tiranë.*

se qytetet nuk mund t’i ndash në “qytete të lumtur” dhe “qytete të palumtur”. Por qytete, të cilat përmes viteve dhe ndryshimeve vazhdojnë të formësojnë dëshirat, dhe qytete ku dëshirat ose ia dalin ta “fshijnë” qytetin ose janë “fshirë” prej tij.



Seria 8:  
Shkaterimi i kinemave "17 Nentori",  
"Republika", "Agimi", "Ali Demi"  
dhe "Partizani"










PROTECT



The PYRAMID by DIMIKO (join us every



Muzeu "Enver Hoxha" u inaugurua në vitin 1988. Për projektimin e tij u angazhuan një grup i gjerë ekspertësh të Institutit Shtetëror të Studimeve dhe Projektmeve të Arkitekturës dhe Urbanistikës Nr. 1 në Tiranë dhe të institucioneve të tjera si Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Instituti i Arteve, etj. Ky grup ekspertësh drejtohej nga arkitektët Klement Kolaneci, Piro Vaso, Pranvera Hoxha dhe Vladimir Bregu. Pas vitit 1991 kjo ndërtesëpushoi së qeni muze dhe u përshtat në funksione të tjera ndër të cilat Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Pjetër Arbërori" (QNK). Në vitin 2007 Ministria e Turizmit, Kulturës, Risnisë dhe Sporteve (MTKRS) shpalli dhe organizoi Konkursin ndërkombëtar për konvertimin dhe përshtatjen funksionale të QNK-së në teatër të dramës dhe qendër të arteve pamore. Në këtë konkurs morën pjesë katër studio arkitekture. Detyra e projektimit e hartuar nga MTKRS, si edhe projektet e paraqitura nga studiot e arkitekturës gjatë fazës së konkursit, janë paraqitur në vijim.

*The Ministry of Tourism, Culture Youth and Sport in 2007 issued the international architecture competition for the design of the reorganization of the QNK (International Cultural Center "Pjetër Arbërori") to National Drama Theatre and Performing Art Center. The terms of reference formulated by the Ministry of Tourism, Culture Youth and Sport for this competition, and the designed projects are presented in the following projects.*

#### **Qëllimi i Projektit:**

Konvertimi dhe përshtatja funksionale e QNK-së në teatër dramatik dhe qendër të arteve pamore; Rikonstrukcioni rehabilitues ndërtimor i QNK-së

#### **Pozicioni urban i objektit:**

Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Pjetër Arbërori" ndodhet në zonen e klasifikuar si qendra e Tiranës, në pikën gravitacionale të Bulevardit "Dëshmorët e Kombit" dhe e shpallur si zonë Monument Kulture me status të veçantë mbrojtje si kompleks në tërësi me ministritë, UT, Pallatin e Kongreseve, Presidencën etj.

QNK shtrihet në një territor prej 4000m<sup>2</sup> ku gjurma e saj okupon 1900m<sup>2</sup> të këtij territori. Ky territor kufizohet nga veriu me bulevardin "Bajram Curri" (që shoqëron lumin Lana); nga lindja kufizohet nga rruga "Lekë Dukagjini"; nga jugu me ndërtesën e Këshillit të Ministrave ndërsa në perëndim me bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Objekti sot është i aksesueshëm në disa drejtime për këmbësorë; nga veriu dhe lindja objekti ka akses për automjete.

Me vendim të KKRRT-së së Republikës objekti bën pjesë në kompleksin e qendrës së Tiranës dhe si i tillë ka një sërë kufizimesh në lidhje me ndërhyrjet e mundshme volumore në nivelin mbitorësor; Kufizimet për zhvillime në nivelin nëntokësor nuk ka. Në planin rregullues të qendrës së Tiranës në fuqi, objekti ruan të njëjtën fizionomi urbane së bashku me peizazhin që e shoqëron, pa specifikime të detajuara apo kufizime preçize.

#### **Gjendja egzistuese e objektit**

Ndërtesa është vënë në funksion me përfundimin e punimeve ndërtimore në vitin 1998. Është projektuar nga Instituti i Studimeve dhe Projektmeve No.1 dhe zbatuar nga ndërmarja e ndërtimit "21 Dhjetori". Funkcioni kryesor i objektit ishte muze i ish diktatorit komunist Enver Haxha për periudhën 1944-1985. Këtë funksion objekti e humbi në vitin 1992. Konceptimi volumor i objektit ka në esencë përpjekjen e një simbioze arkitektonike midis memorialit dhe simboleve të yllit e të shqiponjës në plan dhe altimetri të cilat shkrihen në siluetin e piramidës – memorial.

#### **Aktualisht objekti funksionon në dy linja:**

1. Ajo e QNK-së për organizimin e panareve të ndryshme tregëtare; shfaqje të ndryshme muzikore, disko, mbledhje apo konferenca, ekspozita të arteve pamore kryesisht pikturë apo fotografie si dhe një sallë shfaqjesh filmi. 2. Ambiente (afërsisht 80% ) të dhëna me qira në disa subjekte.

Për shkak të mungesës së mirembajtjes gjatë gjithë kësaj kohe, të administrimit jo efektiv, të dëmtive të sjella nga qiramarrësit objekti sot ndodhet në një gjendje mjaft të rënduar fizike që domosdoshmerisht kërkon ndërhyrje rikonstruktive. Të gjitha sipërfaqet e pjerrëta të fasadave të vazhduara janë të dëmtuara duke bërë lehtësisht të penetrueshëm ujin e rreshjeve dhe për pasojë dëmtime në rifinitura. Veshja me mermer e eksterierit është në gjendje kritike për shkak të përparimit të degradimit dhe mungesës së masave. Gjithashtu një rol negativ kanë luajtur vendosja e një numuri të madh makinerish dhe antenash në pjeset e taraces. Si rezultat është i domosdoshëm një verifikim paraprak i strukturave. Në drejtim të rifiniturave të brendshme ka një dëmtim në masë sidomos për pjeset e dhëna me qira, tek salla e kinemasë, etj.

Sistemi i ngrohjes-ftohjes, ventilimit dhe impiantet e lidhura me to janë totalisht i shkatërruara. Sot çdo ndarje administrative apo e dhënë me qira ka sistemin e vet, gjë që shoqërohet me vendosjen e një sërë makinerish, në mënyrë të pakontrolluar, me një shpërndarje kaotike në fasadat e objektit. Sistemi elektrik i objektit përbëhet nga një mori rrjetesh të pamundur për t'u identifikuar, kontrolluar apo riparuar.

## **Volumetria e objektit ndahet në 5 nivele:**

*Niveli i parë* (nëntoka) me kuotë projekti – 4.65m. Në të aktualisht ndodhen salla e kinemasë, disa zyra me destinacione të ndryshme, kafe bar Mumja, nyje sanitare, korridore shpërndarës, ambjente teknike të destinuar për kaldaje, kabinë elektrike, impianti AC.

*Niveli i dytë* (kati përdhe) me kuotë projekti +/-0.00

Për të arritur këtë nivel (prej niveli të shëtitores) shërbejnë pjesët e sistemuara në të gjitha drejtimet e hyrjes dhe shkallë të jashtme travertini. Në këtë nivel është salla ose odeoni koncertal, ku improvizohen edhe panairët tregëtarë.

*Niveli i tretë, i katërt, dhe i fundit* përkatesihet me kuota projekti +5.40m, +9.60m, +11.40m

Janë ambjente të orientuara radialisht rreth hapësirës së brendshme në formë ballkonadash përkundrejt atriumit-odeon; lëvizja presupozon një linjë të vazhdueshme pa ndërprerje e shfrytëzuar për një ekspozim direkt si dhe për lidhjen me nefet (hapësirat) në thellësi. Karakteristika kryesore e ambjenteve është lartësia e konsiderueshme si dhe mungesa e dritës direkte natyrale për arsye ekspozimi.

## **Programi i ri funksional për objektin:**

### **1. Teatër Dramatik – me karakteristikë kryesore “dëgjimi i mirë i fjalës së folur”**

Forma e sallës: Arena ose skema alternative

Kapaciteti: 500 vende

Elementet përbërës: Hapësirat arkitektonike të teatrit duhet të përfshijnë të katër nivelet funksionale.

1. Pjesa e publikut ose “front of house” që përfshin hollin, garderobën, ambjente funksionale sanitare, “box office”, biletari dhe hapësira të tjera ndihmëse si korridore, dalje emergjence dhe kafe bar.
2. Salla (house) me 500 vende; e organizuar sipas koncepteve moderne të projektimit me ose pa ballkonada; me hyrje sa më funksionale dhe organizim efektiv të sipërfaqes. Volumi të konsiderojë jo më shumë se 5m<sup>3</sup> / spektator
3. Skena të konceptohet me zgjidhje teknologjike të kohës si përsa i përket fleksibilitetit ashtu dhe organizimit dhe efekteve të ndriçimit. Ndryshimet e mundshme gjatë performimit të jenë lehtësisht të kryeshme, në një kohë të shkurtër dhe pa zhurmë.
4. Pjesa e mbrapme ose “backstage” të parashikojë sallë prove, dhoma veshje, dhoma artistësh, depo, zyra administrative, ambjente teknikësh dhe instalatorësh (ndriçimi, zeri, mekanike, regjistrim, filmimi etj.).

**Elemente esenciale:** Konceptimi i teatrit për një performancë të sukseshme duhet që të krijojë një atmosferë unike ndërveprimi midis audiences, artistëve dhe teknologjisë.

**Kohezioni i audiencës:** Mënyra se si aranzhohet audiencia në relacion me sallën dhe skenën përbën një faktor përcaktues në krijimin e një atmosfere teatrore ku audiencia ndjehet e angazhuar nga performanca, dhe artistët komunikojnë shumë mirë me të. Projekti duhet të ruajë një shkallë të përshtatshme njerëzore të organizimit të hapësirës ku edhe një artist i vetëm të zotërojë me forcën e fjalës gjithë audiencën. Kjo kërkon një zgjidhje dhe organizim të tillë të sallës ku spektatori është sa më afër performuesve artistë, dhe në gjendje t'i shohë dhe t'i dëgjojë mirë.

**Shikueshmëria:** Të shohësh mirë audiencën është thelbësore, kështu që edhe spektatorët të gjithë të shohin performancën artistike. Dhe jo vetëm të shohin pa pengesa apo pa kufizime shikimi por edhe duhet të jenë mjaftueshëm afër artistëve në mënyrë që të shijojnë jo vetëm zërin por edhe gjetet, mimikën dhe të vlerësojnë artin skenik.

**Akustika:** Dëgjueshmëria e mirë është po aq e rëndësishme sa edhe shikueshmëria e mirë. Performanca artistike të ndryshme kërkojnë kushte të ndryshme akustike që të vlerësohen.

GENERALLY, EXISTING HORIZONTAL RADIAL ELEMENTS LOCATED ON THE LEVEL ±0.00M AND EXISTING VERTICAL ELEMENTS LOCATED IN RADIAL DIRECTION ARE USED AS THE SUPPORTING ELEMENTS OF THE NEW STRUCTURE, SO IT IS CONSIDERED A MIXTURE IN BETWEEN SUSPENDED AND DIRECTLY SUPPORTED ELEMENTS IN EXISTING STRUCTURE.

THE CENTRAL BEARING ELEMENTS ARE COMPOSED OF STEEL (HE 280 A), ACTING MOSTLY IN COMPRESSION, SUPPORTED ON THE EXISTING RADIAL ELEMENTS OF THE LEVEL ±0.00M, THE BEARING ELEMENTS IN PERIMETER ARE COMPOSED OF STEEL (HE 380 A), ACTING MOSTLY IN TENSION FIXED ON EXISTING VERTICAL ELEMENTS LOCATED IN RADIAL DIRECTION AT THE ROOF LEVEL, INCLINED IN A CERTAIN SLOPE.

THE HORIZONTAL STEEL STRUCTURE OF THE STAGE PAVEMENT IS COMPOSED OF PRIMARY AND SECONDARY BEAMS LOCATED IN BOTH ORTHOGONAL DIRECTIONS.

THE PRIMARY BEAMS ARE FORESEEN AS CELLULAR BEAMS WITH SECTION HEIGHT OF 1.0M, THOSE STEEL BEAMS ARE COMPOSED OF WELDING TWO STEEL PROFILES TYPE (HE 700 A).

REINFORCEMENTI TE GJATESORE EKZISTUES NE HORIZONTALE PER HORIZONTALE, APO TE VERTIKALE.


NE TRAZE NJAKET E MESHITESITESH SE STRUCTURES EKZISTUES NE NJETER HORIZONTALE ELEMENTET VERTIKALE TE PRERJES.

ELEMENTET GJATESORE MARRTES ANE DORBLEME KRYENSHIT NE NJETER (DO MENDONTOJEN NE ELEMENTET KA PERMETRUALE, MENDONTOJEN PRIVE E METALIKE DORBLEME) QI FIKENEN NE ELEMENTET RADIALE TE PRERJES TE MELLENS-CONJUCTURA HORIZONTALE METALIKE DORBLEME NE VERTIKALE SPASIV DORBLEME.

TRAZET KRYENSHIT JANE PARASHIKUAR TE JONE ORTHOGONALE LAKSHORE PERKUPTE TE TYRE NIVELI ±0.00M, TRAZET NJOMDORBLEME ASHOK PARASHIKUAR DORBLEME DORBLEME DORBLEME E VERTIKALE NE STRUCTUREN MARRTES METALIKE KRYENSHIT KRYENSHIT DORBLEME, JOTE DORBLEME.

TE JONE ELEMENTET NJOMDORBLEME VERTIKALE WALLER VERTIKALE NE STRUCTUREN NE TRAZES E ANA.


ELEMENTET TE TRAZES NE ELEMENTET MARRTES.



## LONGITUDINAL SECTION E PROPOZUAR



## TRANSVERSAL SECTION E PROPOZUAR



SHKURTYMJA NE ELEMENTE TE VECARTE TE SAJENKËSIVE

SHKURTYMJA NE ELEMENTE HORIZONTALE BASHKË  
MUNDËSIKUR NE DREKTIMIN KADHAL TE SHKURTYMJEVE

STABILE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE  
DREKTIMIN KADHAL TE SHKURTYMJEVE SHKURTYMJE  
SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE


SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE


SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE

SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE SHKURTYMJE





ALTIMETRIC DIMENSIONS RELATIONSHIP

RAPORTET MËSIS DIMENSIONEVE ALTIMETRIAKE



PLANIMETRIC DIMENSIONS RELATIONSHIP


RAPORTET MËSIS DIMENSIONEVE PLANIMETRIAKE






**PROPOSED LONGITUDINAL SECTION  
PRERJA GJATESORE E PROPOZUAR**

**OPTION A**



**PROPOSED TRANSVERSAL SECTION  
PRERJA TERTHORE E PROPOZUAR**

**OPTION A**







## Shkatërrimi si simbol për një të ardhme më të mirë

Artan Raça

*“Adhurimi i së shkuarës të çon drejt një pesimizmi të pajustificuar për të tashmen dhe të pengon të kuptosh që e ardhmja është ndryshe nga ajo që mendoje...” Paul Valéry*

### ABSTRACT

Since thousands years, the destruction as the conservation has been the fundamental element of the creation of the cities, one of the means that has ensured its long life, paving the way to and enabling its urban recreation. Destruction has been almost always the preface of a new construction, the commencement of a process by which is produced in layers the very core of the city.

In this context and based on an aesthetics-architectural analysis, this article aims to argue that the Pyramid (former “Enver Hoxha” museum) failed to become a part of the treasure of architecture. As an entirely ideological work, commissioned to crown the power and the cult of the individual, it was unable to make a “place” and the city to give a “place” to it. On the other hand, having a very rare typology, it is impossible for it to survive by being reused for another destination. Its unsuccessful reuses so far, although perfectly constructively realized in monolith concrete, have proven once again its éphémère character and its inevitable fate: the destruction, to give the way to the construction of a contemporary and more necessary architecture for the country (New Parliamentary Complex), which would be also a good opportunity for an architectural revival of the city, calling to our mind the words of the architectural theoretician of the 18th century, Francesco Milizia, saying that “to beautify a city is necessary to destroy many parts of it.”

Arkitekti amerikan Louis Kahn (1901-74) në përkufizimin e tij për qytetin, si një poet i vërtetë na dhuron këtë fluturim: “Një Qytet është vendi në të cilin një fëmijë që ecën mund të shikojë diçka që i tregon çfarë ai do të dëshironte të bënte për gjithë jetën”. Atëherë le të ndjekim këtë fluturim si një mundësi për të zhbërur atë që vjen më poshtë.

Mbi të gjitha duhet vënë re se si ky përfytyrim mbi qytetin jepet duke “ecur”, pra në lëvizje dhe jo duke “banuar” në të. Nga ana tjetër, “fëmija” (një qenie e parritur ende që përmban në vetvete në mënyrë të heshtur një pafundësi mundësish) duhet të shquaj në Qytet atë që ai “do të dëshironte të bënte” përgjithmonë, ose e thënë ndryshe të shquaj atë, që ai është në “mundësi”. Pra, me fjalë të tjera, ky qëndrim “johistorik” nga një arkitekt që për historinë kishte shumë respekt dhe e njihnte mirë atë, tregon se qyteti nuk është parë vetëm si vendi ku banohet, mbretëria e të patundshmes, parcela ku mund të stivosen e të ruhen ato që “tashmë janë bërë”, por më tepër si një skenar në ndryshim i gjërave që “do të bëhen”, dhe

se Historia e tij, që njëkohësisht është edhe historia e arkitekturës përfiton një shpejtësi që e projekton atë në kohët dhe në vendet e së ardhmes.

Ne jemi mësuar ta shikojmë qytetin si produkt të grumbullimit të njerëzve, të funksioneve dhe mbi të gjitha, të objekteve të ndërtuara. Në fakt që prej mijëra vjetësh shkatërrimi ka qenë së bashku me konservimin elementi themelor i krijimit të qyteteve, një nga mjetet që i ka siguruar jetëgjatësinë, duke hapur rrugën dhe duke bërë të mundur rikrijimin urban. Pothuajse përherë shkatërrimi ka qenë parathënia e një ndërtimi të ri, fillimi i një procesi, nëpërmjet të cilit është prodhuar me shtresëzime edhe vetë thelbi i qytetit. “Për të zbukuruar një qytet, ka nevojë gjithmonë të shkatërrohen shumë pjesë të tij” shkruante artisti dhe arkitekti Francesco Milizia rreth fundit të viteve ‘700, duke treguar në Traktatin e tij se si shkatërrimi ka qenë gjithmonë një nga rrugët, më anë të së cilës janë shprehur qytetërimet e mëdha urbane. Pjesë e këtij shkatërrimi ka qenë përherë ajo që binte ndesh me estetikën,

pjesët e vdekura, gjymtyrët e gangrenizuara, arkitektura e shëmtuar.

Nëse kthehemi në diskutimin tonë lidhur me muzeun e Enver Hoxhës apo Piramidën, a mund të themi se është ky një objekt i shëmtuar? Do të ishte i mangët kufizimi i gjykimit vetëm mbi kriterin estetik, “shëmnia nuk mjafton”. Nga ana tjetër ta reduktosh arkitekturën në çështje “numrash” referendumesh, apo “gustoje” do të thotë ta neutralizosh atë. Qyteti është si një libër historie me faqe të bukura dhe të shëmtuara, padyshim që nuk mund të grisim faqet e shëmtuara, por vetëm ato që na “bëjnë keq”, ato që na “helmojnë”. Sipas gjykimit tim edhe Piramida është një objekt që bën keq, kurorëzon fuqinë, pushtetin dhe kultin e individit. Përmbajtja e saj e ndot qytetin, ndërsa arkitektura ka një ndikim traumatik dhe shkatërron bukurinë pamore. “Arkitektura -thoshte Louis Kahn- nuk egziston , por egziston vepra arkitekturore, pra vepra arkitekturore është vetëm një ofertë ndaj arkitekturës, me shpresë që kjo ta pranojë në thesarin e saj”, atëhere nëse kjo është e vërtetë, mendoj se Piramida

është pikërisht një veper që nuk arriti dot të bëhet pjesë e thesarit.

Një veper arkitekturore përpara se të vlerësohet për formën, vëllimet, materialet e teknologjinë, duhet të vlerësohet sesa arrin të krijojë një *vend*, të integrohet e të bëhet pjesë e qytetit. Në fakt ky objekt ka prodhuar një *non-lieu* nëse do ti referoheshim konceptit të etnologut dhe antropologut Marc Augé mbi *vendet dhe jovendet*. Me vendosjen e saj qëndrore dhe mospërfillëse për çfarë ka rrotull, Piramida arriti të neutralizojë një parcelë tepër të vyer për qytetin dhe ta kthejë atë vetëm në funksion të monumentalitetit të saj dhe aspak të krijimit të një *vend*, ku njerëzit mund të krijojnë marrëdhënie mes tyre.

Pikërisht për shkak të qëllimit e programit Piramida është edhe mbulesë e një varri edhe muze, edhe objekt kulti edhe arkitekturë konvencionale, edhe monument edhe memorial, pra është një lloj sfinksi apo minotauri ku formulimit arkitekturor në pjesën e pasme i shkrihet një monument në atë përpara. Në këtë pikpamje, projektuesit e saj janë treguar



Artan Raça është diplomuar në Arkitekturë në fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Tiranë më 1987. Deri në 1993 ishte arkitekt në ISPN, vit kur dhe hap studio raça arkitektura ku ushtron aktivitetin projektues në fushën e arkitekturës e dizajnit. Autor i disa projekteve në Tiranë si, “Pallati i Verdhë” në rrugën Hoxha Tahsin (2000), pallat banimi në rrugën Naim Frashëri mbi ish market VEFA(2002), dhe atyre në ndërtim si “Lingotto Center” në bulevardin Zhan D’Ark(2004), pallati “Linja” në rrugën Don Bosco(2007), tre “Vilat e Bardha” në Shirokë(2007), etj. Në vitin 2000 përkthen e boton në shqip librin “Vers une Architecture” të Le Corbusier dhe prej vitit 2007 është pedagog i projektimit arkitektonik në Universitetin POLIS në Tiranë.



## ABSTRAKT

Që prej mijëra vjetësh, shkatërrimi ka qenë së bashku me konservimin elementi themelor i krijimit të qyteteve, një nga njetet që i ka siguruar jetëgjatësinë, duke hapur rrugën dhe duke bërë të mundur rikrijimin e tij urban. Pothuaj përherë shkatërrimi ka qenë parathënia e një ndërtimi të ri, fillimi i një procesi nëpërmjet të cilit është prodhuar me shtresëzime edhe vetë thelbi i qytetit. I parë në këtë këndvështrim dhe bazuar në një analizë estetiko-arkitekture ky shkrim synon të argumentojë se Piramida, (ish muzeu Enver Hoxha) nuk arriti të bëhet pjesë e thesarit të arkitekturës. Si një vepër thellësisht ideologjike e porositur për të kurorëzuar fuqinë, pushtetin dhe kultin e individit ajo nuk mundi të bëjë një "vend" dhe qyteti t'i bëjë një "vend" asaj. Nga ana tjetër si një tipologji tepër e rrallë ajo e ka të pamundur të mbijetojë duke u ripërdorur me sukses si arkitekturë me një tjetër destinacion. Ripërdorimet e saj të pasuksesshme, edhe pse e realizuar më së miri konstruktivisht në beton të derdhur në vend, vërtetojnë edhe një herë karakterin e saj ëphémère dhe fatin e saj të pashmangshëm. Shkatërrimin, për t'i hapur rrugë ndërtimit të një arkitekture bashkëkohore dhe tepër të nevojshme për vendin (Kompleksit të Ri Parlamentar), që do të ishte dhe një rast i mirë për një rilindje arkitekture për qytetin, duke na sjellë në mend fjalët e teoricienit të arkitekturës të viteve '700 Francesco Milizia, "se për të zbukuruar një qytet lipsen të shkatërrohen shumë pjesë të tij".

tepër të aftë për të shprehur e për të përmbushur detyrën e projektimit. Në fund të fundit fuqia e arkitektit, mund të thote një arkitekt i njohur, qëndron tek bindja ndaj investitorit, pra edhe pse nuk kemi në dorë detyrën e projektimit, investitori duhet të ketë qenë i kënaqur që të gjitha ato që thamë më sipër janë mishëruar më së miri në këtë objekt.

Piramida sot është një ndërtim tërësisht i panevojshëm që e ka kryer ciklin e tij të jetës. Heqja e saj do t'i jepte një rifrymëmarrje qytetit dhe do të hapte mundësi të reja imagjinuese.

Edhe pse e realizuar më së miri konstruktivisht në beton të derdhur në vend, kjo vepër ka qenë e ndërgjegjshme se i përkiste arkitekturës ëphémère-e, e cila nuk përcaktohet nga materiali me të cilën ndërtohet, se sa nga vetë idea e përkohshmërisë që ngërthen përmbajtja e saj, dhe me sa duket shpëtimi i saj është i pamundur. Ajo është "viktimë" e programit dhe destinacionit të saj. Përdorimi i këtij objekti gjatë këtyre njëzet viteve të fundit për të tjera funksione, provoi se ripërdorimi i arkitekturës së saj nuk sjell asnjë risi, nuk jep asnjë mundësi dhe nxori edhe më në pah pamundësinë e saj për t'u bërë pjesë e qytetit dhe për të krijuar një vend. Sforcoja për ta përshtatur e ripërdorur atë, nuk do të bënte gjë tjetër veçse do të konsumonte më kot energji dhe vlera monetare. Tipologjia e saj tepër specifike nuk krijon mundësi të mjafta arkitekture për një rishpirtëzim të kësaj ngrehine, por do të prodhonte vetëm një sfinks të ri, një kitsch dhe njëkohësisht veçse do të zgjaste agoninë e saj.

Por, le të bëjmë dhe një përpjekje për ta shpëtuar. Ka vetëm një alternativë për

mendimin tim, "ballsamosja" e saj, rikthimi i kësaj vepre në gjendjen fillestare, ashtu siç ka qenë projektuar, si në interior, ashtu dhe në eksterier. Vetëm kështu mund të fitojë kuptimin dhe dinjitetin e saj si arkitekturë, duke ju treguar atyre që do të vijin më pas pa asnjëlloj dykuptimësie qëllimin për të cilin ajo u ndërtua. Pra për të gjithë tradicionalistët që e shikojnë traditën jo si një pikpamje që njerëzit e sotëm zhvillojnë për të kaluarën, por si një produkt të së shkuarës të thithur në mënyrë pasive, pra për të qënë koherent ruajtja e këtij objekti ka vetëm një rrugë metafizike: kthimin e tij në identitet si një relike turistike e kohës së socializmit shqiptar.

W. Benjamin thotë se "në çdo epokë duhet të jemi në gjendje të ndajmë traditën nga konformizmi, i cili bën çështje e mundur për ta shtypur atë", duke komentuar se armiku i vërtetë i traditës është pikërisht ky i fundit me pretendimin për besnikëri ndaj tipologjive të saj. Pra a mund të qëndrojmë ky objekt si i tillë në këmbë? Luks shumë i madh për vendin që ka zënë. A mund të fillojë edhe një herë jetën e tij së bashku me qytetin dhe njerëzit e tij? Them se është e pamundur. Gjërat do të ngatërroheshin më keq. Askush nuk mund të thotë se kjo nuk do ta rriste edhe më tepër kompleksitetin e marrëdhënieve shoqërore dhe do ti bënte mirë qytetit. Si zor që shoqëria jonë të arrinte të treste një situatë të tillë dhe për më tepër në emër të kujt do ta bënte ajo këtë sakrificë?

Atëherë ç'ta bëjmë? Nicolai Ouroussoff, kritiku tepër i hidhur i arkitekturës i New York Times-it ka një përgjigje të fortë e të thjeshtë: "t'i shkatërrojmë" ka shkruar qartë e thatë në të përditshmen newyorkeze

(kuptohet jo për Piramidën, por ka një listë të gjatë me objekte të New York-t), dhe vazhdon “...përse të mos i përqëndrojmë energjitë tona për të shkatërruar të gjithë ato objekte që jo vetëm nuk na japin gëzim por na krijojnë dhe humor të keq?”.

BAUHUAS-it arkitektit Walter Gropius. Lista vazhdon me qiellgërvishtësin Trump Place në pronë të D.Trump “që të kujton banesat popullore sovjetike”. Midis viktimave që sakrifikohen është edhe Jacob K. Javits Convention Center që ka midis emrave të



Duket si provokim, por jo pa kuptim. Në shënjestër të tij janë objekte që sipas tij e dëmtojnë qytetin dhe helmojnë jetën e tij. Edhe Ouroussoff gjatë hartimit të kësaj liste është tepër i kujdesshëm që të shpjegojë se kriteri i zgjedhjes nuk është vetëm estetik. Për këtë arsye edhe pse nuk e pëlqen, ai e kursen qiellgërvishtësin Pan Am sot Metlife një nga objektet më të mërzitshëm për newyorkezët, vepër e themeluesit të

projektuesve edhe atë të çmimit Pritzker në arkitekturë mjeshtrit I.M.Pei.

Një përgjigje tjetër na vjen nga Gjermania dhe kryeqyteti i saj Berlini, që vazhdon të qëndrojë në pararojë të këtij aksioni: *shkatërrimi është e vetmja rrugë për t'u dhënë qyteteve tona një të ardhme.* Ky është sllogani nën të cilin u hap Ekspozita Internacionale e Ndërtimit (IBA) e vitit 2010. Nëntëmbëdhjetë bashki e komuna

Fig1. piramida



të shtetit federal të Saxony-Anhalt paraqitën për herë të parë në një ekspozitë arkitekture më tepër shkatërrime sesa ndërtime. Në qytetet binjakë të Dessau-Rosslau u shkatërruan më tepër se 2300 apartamente, ndërkohë që prej vitit 1990 ruspat nuk kanë ndërmend të largohen nga Berlioni.

Por, shkatërrimi i një objekti është i lidhur pazgjithshmërisht me atë që do të bëhet më pas, ajo është ana tjetër e medaljes, bile shpesh nga rezultati që vjen pas tij i jepet përgjigje dhe arsyes së

nuk është e rastësishme për sa kohë nuk është e rastësishme që lindja e qytetit është e njëkohëshme me lindjen e saj dhe për më tepër se politika para së gjithash është administrim i punëve të qytetit.

Nëse të bësh politikë do të thotë t'i japësh formë hapësirës së bashkëjetesës *midis njerëzve*, atëhere projekti arkitektonik përbën medoemos, duam apo s'duam ne, një akt të përgjegjshëm politik. Nga ana tjetër, arkitektura i jep formë idesë së një hapësire banimi dhe është për rrjedhojë paraqitje e një ideje politike mbi qytetin.



Fig2. Fig2/1  
Reichstagu dhe kupola

shkatërrimit. Na mbetet pra të zgjedhim se ç'do të ndërtojmë? Në mes na hyn politika që mes shumë të nominuarve ka zgjedhur të ndërtojë Parlament. Ne pyesim pse Parlament? Ajo thotë pse jo parlament? Duket edhe kjo si një provokim. Por jo, është politikisht korrekt dhe arkitektonikisht brenda fushës së saj. Nuk e mohojmë dot se arkitektura është një veprim politik dhe në fakt lidhja midis arkitekturës e politikës

Nuk mund ta kompleksojmë politikën se ajo po merr vendime për qytetin, për sa kohë është puna e saj administrimi i tij. Para se të jetë një vend fizik, Qyteti është një vend Politik, bile është me vend të kritikojmë përdorimin e teknologjisë dhe të komunikacionit për të "depolitizuar" dhe "neutralizuar" arkitekturën duke e kthyer në pronë të pluralizmit të vendosur nga demokracia e tregut të lirë, duke e

reduktuar atë thjesht në një “zanat” apo në një organizëm që flet vetëm me veten e tij. Është rasti të kujtojmë se ajo duhet të jetë një përfaqësim, që do të thotë mishërim i një projekti politik alternativ në përputhje me vizionin e një metropoli të tregut të lirë. Kjo do të thotë ta kuptosh mendimin arkitektonik jo vetëm si vendi i zhvillimit kulturor, por për më tepër si një mjet konkret i veprimit politik. Kështu duke e përqëndruar të gjithë energjinë imagjinative në zhvillimin teknologjik, pa asnjë perspektivë politike, shumë utopi urbane të kultivuara në dekadat e fundit - si përshembull ajo e përpunuar nga grupi Archigram si një arkitekturë apolitike dixhitale - ka qënë e paracaktuar për të mos ndryshuar gjërat.

Ne vazhdojmë e pyesim pse Parlamentin në këtë vend kaq të rëndësishëm dhe jo në një vend tjetër? Pse të mos e ndërtojmë gjetiu për të realizuar e gjallëruar një qendër tjetër të qytetit i cili ka nevojë të ngutshme të policentrizohet? Shumë e drejtë, por nuk është në dinjitetin e Parlamentit të bëjë një detyrë të tillë dhe nuk më duket se do të jetë shumë i vlefshëm. Nga ana tjetër zbatimi i parimit të “subsidiaritetit” nuk na lejon t’ia japim këtë detyrë Parlamentit kur ndërkohë këtë nuk e kanë kryer ende stadiumet, palestrat, kinematë, sallat e koncerteve, muzeumet, qendrat financiare, bibliotekat, si dhe vëmendja e kujdesi urban për të shpërndarë të mirën në mënyrë kapilare. A nuk do të ishte më me vend, nëse duam policentrizmin, që kullat 85-së metroshe që rrethojnë qendrën e Tiranës të projektuara nga “Plani francez” të grumbulloheshin diku tjetër për të krijuar një qendër

bashkëkohore tregtare e financiare, duke liruar në këtë mënyrë edhe qendrën nga një detyrë tepër e rëndë e cila kështu shkon në kah të kundërt me çdo koncept për policentrizim të qytetit?!

Po pse kësaj ndërtese t’i jepet kaq rëndësi? Dyshimtarëve edhe kjo u duket se bie erë provokim. Por këtu jam pa mëdyshje në anën e Parlamentit. Pas flamurit Parlamenti i një shteti është simboli më i rëndësishëm. Meqënëse teoria e mëtejshme në këtë pikë do të binte erë moralizim po vazhdoj me armët e arkitekturës.



Në debatin e konsumuar deri më tani duket se nuk ka qënë e drejtë idea e krahasimit të Reichstagut gjerman me Piramidën tonë. Por në fakt është e kundërta, ato kanë lidhje, por kjo jo në favor të rikonstruktimit të Piramidës, meqë rikonstruksion bënë edhe gjermanët, (duket shumë sipërfaqësore) por në favor të vëmendjes që duhet t’i jepet kësaj ndërtese ashtu siç e vlerësuan gjermanët parlamentin e tyre. Nëse ka objekt që



klasa politike gjermane donte ta bënte shembullin e rimëkëmbjes së Gjermanisë së bashkuar dhe të unitetit popullor, pa asnjë mëdyshje ka qenë ndërtesa e Reichstagut dhe i gjithë kompleksi parlamentar.

Po të besojmë thënien e arkitektit Antonio di Pietro Averlino, alias Filarete(1400/69) se arkitektura ka një

për të simbolizuar në sytë e popullit transparencën e politikës gjermane. Por krahasimi i thjeshtë arkitekturor është pa vend po të kemi parasysh se pjesa e tij e brendshme është shkatërruar totalisht duke lënë vetëm lëkurën e jashtme si një simbol i vazhdimësisë së parlamentarizmit të shtetit gjerman. Kërkesa e klasës politike për të



nënë e një babë, përkatësisht arkitektin dhe investitorin, mund të themi pa frikë se Reichtagu i ri është vepër e arkitektit Norman Foster po aq sa edhe i politikës gjermane me të cilën ajo ka të drejtë të krenohet. Në fakt ishte propozimi i saj kupola e qelqtë mbi sallën e parlamentit, një ide e marrë nga varianti i arkitektit spanjoll Santiago Calatrava, por që arkitekti Norman Foster e ktheu në një metaforë të jashtëzakonshme arkitekture


aplikuar në të sistemet më të përparuara të një arkitekture të qëndrueshme, megjithë kostot e jashtëzakonshme, tregojnë për ambicjen dhe rëndësinë që iu dha këtij objekti për të qenë një shembull i arkitekturës së qëndrueshme për gjithë Gjermaninë.

Rasti tjetër më pak i lakuar por tepër domethënës është dhe Brasília, kryeqyteti i ri i Brazilit. I ndërtuar në 1000 ditë Brasília ishte ëndrra e tre personave: e një

politikani me vullnet të hekurt, Juscelino Kubitschek që si president i Brazilit donte të ndërtonte në zemër të vendit një kryeqytet nga zero; e një arkitekti, Oscar Niemeyer që jetonte me lapsin në dorë dhe që nga frika për avionët udhëtonte deri në tre ditë për të arritur në kantier dhe i një urbanisti të ndritur, Lúcio Costa që vizionit për një

*vendim interesant i Lúcio Costas në projektin e tij - do të shkruante kritika e kohës- ka që në sigurimi i superioritetit hierarkik të Sheshit të Ministrive dhe të Sheshit të Tri Pushteteve mbi pjesën tjetër të qytetit...”*

Ndërsa rëndësinë që ka për Bangladeshin ndërtesa e Asamblesë Kombëtare në Dacha, (Parlamanti i



qytet futurist i bashkoi një njohje të thellë të historisë së vendit të tij. E përruar më 21 prill të vitit 1960, Brazilia ishte imagjinuar për një komb që donte me çdo kusht të ishte modern e që të tregonte se nuk e meritonte thënien e gjeneralit De Gaulle “ *ky vend nuk është serioz*”. I konceptuar me një aks madhështor ku u dërtuan objektet administrtive, edhe pse në një vend joqëndror Parlamenti zë vendin më të rëndësishëm sipas autorit të projektit. “...Një

Bangladeshit) i ndërtuar në vitin 1964, një xhevahir i vërtetë i arkitekturës që arkitekti Louis Kahn ia “bëri dhuratë” para se të vdiste popullit të këtij vendi që pavarësinë do t’u fitonte më 1971, doja ta komentoja me një thënie të shkrimtarit Darah Diba, i cili tepër i vëmendshëm ndaj pushtetit institucional që evokonte ndërtesa do të shkruante më 1990 se “... *ky makrokozmo kozmogjeografik distilon një koncept të një tharmi hyjnor, i cili na udhëzon*

Fig3. Brasílias



me anë të shtigjeve tepër të sakta të ngjitimi në parajsën tokësore...Kjo është një arkitekturë që ju kthen diçka atyre që nuk kanë trashëgimi, që gjejnë aty një shëmbëlltyrë të dinjitetit të tyre, që në mungesë të diçkaje më të mirë lexojnë tek ajo një imazh të një jete ndryshe...”

Tani me shpalljen e listës tepër shpresëdhënëse të studiove të projektimit, (megjithëse do të ishte në nderin e këtij objekti që për herë të parë të organizohej një konkurs i hapur) duket se “*les jeux sont faits*” dhe topi është në duart e bashkautorëve, nënës dhe babait të këtij objekti, pra të arkitektëve dhe të pushtetit. Suksesi apo dështimi i kësaj krijese u takon vetëm atyre. Është radha që ky projekt të mos kthehet në një rast të humbur por në një mundësi për t’i dhënë qytetit një nga objektet më bashkëkohore, një simbol të rilindjes arkitekturore. Si një besimtar i arkitekturës them se ajo mund të bëjë gjëra të mrekullueshme sidomos kur është e lirë. Në këtë rast filozofi i dekonstruktivizmit Jacques Derrida do të thoshte: *Maintenant l’architecture* (tani e ka radhën arkitektura).

## Literatura

- Jacques Derrida, *Point de Folie – Maintenant l’Architecture*, Bernard Tschumi: La Villette.» *AA Files* (Summer 1986).
- David B. Brownlee, David G. De Long, *L.I.Kahn: in the Realm of Architecture*, RIZZOLI INTERNATIONAL PUBLIKATION, N.Y 1991.
- Maria Bonaiti, *Architettura è, L.I.Kahn*, gli Scritti, ELECTA 2002.
- *L’Architecture d’Aujourd’hui* n.373, nov-dec 2007.
- Filarete, *Trattato di architettura*, ed.



Anna Maria Finoli and Liliana Grassi, Il Polifilo, Milano 1972.

## Shënime për fotot

**Fig1.** Ish muzeu i Enver Hoxhës projektuar nga ISP n.1 Tiranë me kryetar grupi arkitekt K.Kolaneci, 1987.

**Fig2.** 2/1 Reischtagu, Kupola e qelqtë mbi sallën e parlamentit, projektuar nga



arkitekti Norman Foster, 1999.

**Fig3.** Sheshi i Tre Pushteteve me kullën e Kongresit ku janë vendosur zyrat dhe du kupolat ajo e hapura për Senatin dhe tjetra e përmbysur për Dhomën e Deputetëve, projektuar nga arkitekti Oscar Niemeyer 1958.

**Fig3/1.** Plani pilot për Brasíliá-n i firmosur nga Lúcio Costa që daton 10 mars 1957, projekti fitues i konkursit. 1.Sheshi i

Tre Pushteteve 2.Sheshi i Ministrive 3.Katedralja 4.Sektori kulturor 5.Qëndër argëtimi e shplohjeje 6.Sektori Bankar 7.Sektori Tregëtar 8.Hotele 9.Kulla e Radio TV 10.Sektori Sportiv 11.Sheshi i Bashkisë ...

**Fig4.** Ndërtesa e Asamblesë Kombëtare në Dacha, Parlamanti i Bangladeshit, projektuar nga arkitekti L.I.Kahn 1964.

**Fig4.** Parlamenti i Bangladeshit



## Piramida midis simbolit të së shkuarës dhe së ardhmes

Arben Shtylla

Në korrik të vitit 2004, kur deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, miratonin njëzëri me rreth 140 vota, Vendimin për ndërtimin e parlamentit të ri pak kush parashikonte se për të, vite më vonë, në mediat shqiptare, do të ndizej një diskutim i gjallë dhe mjaft i nxehtë.

“Duhet prishur apo jo, Piramida”, ose më saktë, “Duhet apo nuk duhet një godinë për Parlamentin e ri”, apo siç debatonin specialistët, “A është ky vendi i duhur për një Parlament”, .... “vendi i përshtatshëm mund të jetë kudo, mjaft të mos jetë në qendër”...? këto ishin pyetjet që nxitën debatin!!!

Pikërisht këtyre pyetjeve nga pikëpamja thjesht profesionale do të mundohem t’i përgjigjem më poshtë.

Piramida dhe Parlamenti, janë dy objekte që për shumë arsye të ndryshme bashkohen në një pikë dhe që paraqesin një simbolikë tepër të fortë. Ata lidhen në përmbajtje, funksionin dhe qëllimin për të cilin janë ngritur dhe të cilit i shërbejnë.

Ndërsa parlamenti ka një funksion tashmë të kristalizuar qartë dhe shumë të rëndësishëm në vendet me një sistem demokratik, rasti i ndërtimit të piramidës është i veçantë dhe interesant në historinë e arkitekturës së fundit të shekullit 20.

Piramida u ideua, u projektua dhe u ndërtua si muze i një lloji të veçantë. Në të nuk u ekspozuan materiale relike dhe eksponate të epokës, por u tentua që në muze gjithçka të jepej nëpërmjet formës dhe arkitekturës.

Kjo ishte një zgjidhje origjinale jo vetëm se rimori nga lashtësia forma arkitekturore, të cilat i trajtoi në një këndvështrim krejt modern, por edhe sepse arriti të krijojë një vepër në formën e një memoriali. Pra, kemi një simbiozë jo të zakonshme në arkitekturën shqiptare, ku forma bëhet primare dhe funksioni utilitar i ndërtimit del në plan të dytë.

Gjithashtu, kemi të bëjmë me një shembull shumë të veçantë ku forma arkitekturore bëhet njësh me funksionin, ku ndërtesa paraqet që prej së largu qëllimin e ngritjes së saj dhe trajtimi i brendshëm mbetet unikal, jo funksional dhe utilitar, por formal dhe vazhdues i idesë së memorialit të eksterierit.

Janë këto veçori, në bazë të mos suksesit të ndërhyrjeve të njëpasnjëshme, të bëra në këto njëzet vjet, për të ndryshuar dhe përshtatur piramidën në një godinë me funksione të tjera si panair, ekspozitë, bibliotekë, zyra, teatër etj.

Piramida për fatalitetin e saj, nuk i pranoi



këto ndërhyrje. Ajo u krijua si një memorial dhe do të mbetet e tillë deri sa të ekzistojë.

I ngjashëm për sa i përket simbolikës është edhe godina e *parlamentit*. Kjo simbolikë është jo vetëm formale, por kryesisht funksionale, e lidhur me qëllimin e tij.

Ashtu si kishat në mesjetë, bankat në fillimet e kapitalizmit, godinat e parlamenteve kanë qenë dhe janë simbole të një sistemi, të një “regjimi” demokratik, ku nëpërmjet pushtetit të deleguar me anë të votës së lirë, diskutohet dhe vendoset për fatet e popullit dhe të vendit.

Në vendet me demokraci të zhvilluar, godinat e parlamenteve janë pika referimi të arkitekturës dhe urbanistikës së qyteteve ku ato janë ngritur.

Për këto veçori, zgjedhja e vendit të ndërtimit të *parlamentit* të ri, ka një karakter të fortë simbolik. Është kjo arsyeja që prishja e *piramidës* është e lidhur me ndërtimin e *parlamentit* të ri. Çdo ndarje e këtyre dy vendimeve (prishje dhe ndërtim) është e pavërtetë dhe jo logjike.

*Piramida* u ndërtua për të krijuar një memorial për një simbol të caktuar. Prishet për t’i lënë vendin *Parlamentit* të ri, një institucioni, si shtëpi e demokracisë.

Kjo simbolikë është e lidhur ngushtë edhe me vendin e ndërtimit. Sheshi, në kryqëzimin e bulevardit “Dëshmorët e Kombit” me atë “Bajram Curri”, paraqet një nga zonat më të mira të qendrës së Tiranës. Shtrirja e saj, hapja ndaj shikuesit, fushë-pamja mjaft e gjerë dhe sfondi në pjesën lindore të malit të Dajtit e bëjnë këtë shesh një nga sheshet më të mira dhe më interesante të kryeqytetit.

Ndoshta këto vlera kanë bërë, që çuditërisht, kjo zonë të lihet e paprekur, e bardhë, një shesh tabu, e vetmja ku nuk parashikohet asnjë lloj ndërhyrje nga projekti i qendrës së Tiranës.

Si përfundim, dua të nënvizoj faktin se, heqja e një simboli dhe vendosja e një tjetri nga pushteti legjislativ, nuk bën gjë tjetër vetëm se rritet dukurinë se çdo kohë, nëpërmjet përfaqësuesve të saj politik, vendos të lërë gjurmën e saj mbi urbanistikën e qyteteve tona. Përrjashtim nga kjo dukuri nuk bëjnë as kohët moderne, jo vetëm tek ne, por edhe në vende më të zhvilluara. Shembulli më i qartë është Parisi, ku gjurmët e “urbanistëve” më të rëndësishëm në strukturën e tij janë lënë nga G. E. Haussmann e deri te F. Mitterrand.

Përfundoi studimet për arkitekturë në vitin 1975 në Universitetin Politeknik të Tiranës. Ka kryer studime pasuniversitare në Milano në vitin 1985 dhe ka mbrojtur gradën Doktor i Shkencave në Arkitekturë në vitin 1987 në universitetin Politeknik të Tiranës. Ka punuar në Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Arkitekturës, Urbanistikës dhe të Veprave Industriale që prej vitit 1976. Duke filluar nga viti 2009 punon si pedagog në Universitetin POLIS duke kontribuar si drejtues i departamentit të shkencave të aplikuara dhe si lektor e drejtues projektesh në lëndët e Teknologjisë së Arkitekturës dhe Mjedisit. Që nga viti 2006 ka kontribuar në organizimin e konkursit ndërkombëtar për Kompleksin e ri Parlamentar të Shqipërisë, si edhe bashkëpunon me studjo të huaja për projekte me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare.



## Piramida

Artan Fuga

Pasi ideja e prishjes së ndërtesës në Bulevardin «Dëshmorët e Kombit», e quajtur në zhargonin tiranës «Piramida», u debatua furishëm, me pasion dhe kaloi në sallën e Kuvendit, çështja doli sigurisht edhe në ekranet televizive.

Sigurisht për t'u ndërlikuar edhe më.

Në fakt, shpesh, duhen mbushur me diçka orët e programimit televiziv. Ne mërzitemi ndoshta nga disa debate pa fund, por redaksitë televizive kënaqen, lumturohen, sepse programi mbushet. Dhe po të ankohe mi se përse humbim kohë me debate kaq të gjatë, atëherë edhe pyetja që na kap «mat» është e menjëhershme «Kur nuk i pëlqeni emisionet tona, atëherë përse na shikoni?» Ky është sekreti i mediave televizive, ato të ngulin përpara ekranit si për të shijuar të bukurën dhe interesanten, ashtu edhe gjërat pa shumë interes.

Të prishet apo jo ajo ndërtesa, e cila sipas zhargonit të rinisë tiranëse u quajt «Piramidë»?

Sipas meje, ajo ndërtesë dhe fati i saj nuk ka vend të politizohen.

Është një çështje thjesht urbanistike, kaq anësore, çështje financiare dhe arkitekturore, pra, por amà aspak, politike. Sipas meje, piramida as nuk ka simbolizuar diktatorin, sikurse shprehen antikomunistët, as nuk ka simbolizuar udhëheqësin, sikurse mund të shpreheshin kundërshtarët e tyre. As njerin dhe as tjetrin. Për një arsye të thjeshtë sepse aty, te Piramida, vetëm nga fundi i jetës së regjimit monist u ndërtua një bina e madhe, vlerat arkitekturore të së cilës nuk i

kam kuptuar kurrë sepse nuk jam arkitekt, funksioni i së cilës, si muze, nuk zgjati veçse dy a tre vjet. Ndërtesa në fjalë në asnjë rast nuk u asociua me përfytyrimin imagjinar të relikeve që mbante brenda saj nëpër vitrina. As nga komunistët e atëhershëm dhe as nga antikomunistët.

Mbi të gjitha, ndërtimi i një binaje të tillë në ato vite shihej me ironi nga popullsia, që nga njera anë, vrojtonte sesi partia në fuqi po dorëzonte pushtetin dhe po largohej me rendje të paniktë nga parametrat ideologjike që përfaqësonin reliket e atij që u quajt muze, dhe nga ana tjetër, shihte me lemeri sesi në kushtet e një krize edhe për bukën e gojës që pllakosi në Shqipëri në ato vite, pushteti i tërhequr nga grandomania harxhonte hekur, beton, mermer etj. për të ndërtuar fasada arkitekturore, ndërkohë që dihet nga të gjithë se e thjeshta është e bukur.

Aq më shumë që si ndërtesë, si praktikë, si akt, ndërtimi i Piramidës nuk kujtonte aq shumë njeriun që i mbante emrin, por ishte shprehje e manipulimit dhe e frikës së udhëheqjes së atëhershme për t'i dhënë kurajë vetes nëpërmjet ndërtimit të veprave faraoniake, solide, të shpërmasuara, gjigante, shtypëse për vështrimin qytetar, ndërkohë që psikologjikisht, kolektivisht, grupimi drejtues ndodhej nën një pasiguri të konsiderueshme e ankth për fatin e vet nga ndryshimet gorbaçoviane dhe më pas të atyre në Lindje. Frikën politike dhe ankthin psikologjik kolektiv që kishte pllakosur kërkonte t'a nxirrte jashtë, t'a «eksorcizonte», nëpërmjet ndërtimeve gjigantomane pa asnjë funksion



dhe rendiment as politik, as propagandistik, as ekonomik. Një “autogol” propagandistik – ky ishte në atë kohë ndërtimi i Piramidës.

Po kështu, ndërsa përpiquej mesa i vinte ndoresh për të transformuar diçka nga sistemi i mëparshëm, grupit politik drejtues të kohës i duhej të kënaqte edhe pritshmëritë e një pjese konservatore të shoqërisë, që mendonte se historia duhej të ndalte menjëherë pasi u vendos pllaka e fundit e mermerit të Piramidës.

Nëse ngjarjet e kaluara politike do t'i quajmë, sikurse bëjnë disa, si “trashëgimi kulturore e popullit”, atëherë me sinqeritet dhe ndershmëri duhet të pranojmë se piramida shenjon pikërisht këtë çast politik degradues në të gjitha kuptimet e veta dhe asgjë tjetër. Si simbole, për një brez nostalgjik apo të traumatizuar në kujtesë, shumë më tepër vlera sesa ajo kanë hekurudhat që tashmë janë mbuluar me ferra, hidrocentralet nga të cilët ende marrim energji elektrike, e për ata që kanë vuajtur, si simbol i së keqes, janë shumë më tepër kampet dhe burgjet.

Pasi barazojnë ndërtesën me reliket që ajo ka mbajtur brenda, përziejnë gjithçka tjetër. E quajnë “trashëgimi kulturore”.

Por, çfarë kujtese historike përfaqëson ajo ndërtesë?

Ta shohim me realizëm dhe të mos e krahasojmë me bunkerin e Hitlerit në Berlin që disa paskan pasur kohë dhe dëshirë për t'a vizituar. Të paktën duhet pranuar se aty, brenda saj, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje historike e shënuar për kombin. Veç ndonjë puthjeje si të fshehtë që ndonjë vajzë e re i ka

rrëmbyer shpejt e shpejt ndonjë djaloshi, ulur të dy rreth tavolinave, fshehur pas shtyllave, në kohën kur gjatë tranzicionit aty gëluan kafe ku kundërmonin nga larg aroma të pakëndshme wc-ësh të bllokuara.

Nuk paragjykoj fare kur them se në piramidë nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që disa mund ta quajnë shpëtimtare apo fatale për historinë e Shqipërisë. Në këtë kuptim, shumë më tepër kujtesë historike përmbajnë orendi fare të thjeshta, një stilograf, një palë pranga, një palë këpucë, një makinë shkrimi, disa kocka skeletike të gjetura në varre të përbashkëta, sesa një bina ku nuk ka ndodhur asgjë thelbësore, as për mirë e as për keq, që do të quhej një ngjarje historike për kombin.

Vetë ndërtesa është me një përmbajtje simbolike krejt tjetër nga ajo që i dha regjimi i kohës në atë etapë të fundit të ekzistencës së tij. Ishte vetëm muze, dhe aspak mauzole. Ndërkaq vetëm për pak vite. Askund nuk ngatërrohet përmbajtja e objekteve historike që “flejnë” në një muze, me muret apo karabinanë e vetë ndërtesës së muzeut.

Pasi thamë se binaja nuk ka asnjë peshë politike, apo nuk përfaqëson asnjë vlerë në trashëgiminë kulturore, fjalën e kemi, që të mos ngatërrohet ndokush. E prishin për të bërë një ndërtesë të re Kuvendi, apo nuk e prishin, dhe e lënë të rrënohet nga koha, sikurse kanë bërë të gjitha qeveritë deri më sot, edhe më keq sesa është braktisur, punë e tyre, por kujtesë historike ajo nuk përmban.

Më kot e politizojnë çështjen. As piramida nuk ka lidhje me diktaturën sepse



ndërtesa në fjalë nuk është veçse një objekt neutral, ngjyrosjen ideologjike ia kemi ngjitur ne njerëzit, kurse këtë ajo nuk e ka në vetvete. Ngarkimi i saj me një përmasë simbolike është një shfaqje e pastër fetishizmi si sjellje psikologjike, që ju atribuon sendeve shpirt, një lloj animizmi, i cili na vjen që nga popujt e vjetër dhe na shoqëron edhe ne banorëve bashkëkohorë të kësaj toke. Jam gati të pranoj hapur se objektet muzeale brenda saj, për mirë a për keq, kanë vlera historike. Por, jo godina në vetvete.

Nëse Piramida prishet për hakmarrje atëherë le të mos prishet, por nëse shihet si rinovim i fondit të ndërtimeve institucionale të vendit, qoftë me prishje a modifikim, nuk ka përse të hezitohet fare. Le të mos ia transferojmë përgjegjësinë e prishjes apo modifikimit ndonjë studioje të huaj. Ky është një vendim i urdhëruesit të projektit dhe jo i arkitektëve, të huaj apo shqiptarë.

Tjetër punë ana financiare pastaj. Pa asnjë lidhje me radhët e para të këtij shkrimi.

A duhej që të bëheshin ato shpenzime që thuhet se janë bërë për sallën aktuale të Kuvendit, apo për t'a kthyer Piramidën në teatër, ndërkohë që befasisht u vendos që ajo të prishet për t'u bërë ndërtesë Kuvendi?

Përsëri arsyetimi është pa pikë lidhjeje me vetë Piramidën. Kush i ka bërë ato shpenzime le të japë përgjigje. Por, shpesh, çdo administrator i mirë e di, se ndodh që nisësh për të bërë një investim, i hyn një rrugë, dhe pastaj gjatë realizimit të saj, vijjnë rrethana apo ide të reja dhe rruga ndryshon. Firo financiare si këto nuk i ndalon dot kush. Biles do të ishte gabim që për shkak të disa shpenzimeve të bëra tashmë, të vazhdohen investime edhe më të mëdha, në projekte pa të ardhme.

Ku ka financime që mund ta kthejnë Piramidën në një sallë teatri pa e përçudnuar krejtësisht atë nga jashtë dhe nga brenda? Apo rëndësi ka forma e jashtme kurse nga brenda nuk ka rëndësi se e shprehim “trashëgiminë kulturore”?

Ku ka investime që mund t'a kthejnë ndërtesën e një komiteti qendror stalinian në një hapësirë të ndërtuar për të mbajtur brenda saj një parlament demokratik?

Po qe se dikush do t'a realizonte dot këtë nga ana funksionale dhe estetike, do të meritonte një çmim të veçantë ndërkombëtar.

Pra, logjika nuk qëndron as kur ngatërrojnë prishjen apo ruajtjen e Piramidës me përlllogaritje financiare. Arsyeja është e thjeshtë: meqë disa investime, qoftë edhe për utopi, kursime, a naivitete, u bënë në një drejtim të gabuar, kjo nuk na lejon dhe justifikon për të thënë se meqë e nisëm kështu, ta çojmë gabimin deri në fund. Më mirë të ndryshohet drejtimi i investimeve sesa të vazhdohet për të investuar pa kuptim.

Administratorët e dinë mirë që janë disa kosto vendimesh të ndryshuara, të cilat nuk do të mund të evitohen. Sa herë është hapur dhe mbyllur sheshi “Skenderbej” në pesëdhjetë vjet, biles edhe vitet e fundit, atje ku tani bëhen punime? Hap e mbyll, mbyll e hap. Edhe përsëri do të hapet më pas.

Më duket se po politizohet halli i një ndërtese që po degradon nga dita në ditë, duke e ngatërruar atë me emra personash që ajo ka mbajtur apo mban, pavarësisht se personat historikë në fjalë nuk kanë asnjë lidhje, as të afërt dhe as të largët me atë ndërtesë.

Puna është se në Tiranë nuk ke më ku ndërton asgjë në qendrën e saj historike të tanishme. Asnjë ndërtim nuk mund të bëhet

pa prishur ndonjë karabina gjigante betoni, të lënë si gur në qafë nga koha apo të ndërtuar vitet e fundit. Tirana po shkon fatalisht drejt rithemelimit të qendrave të saj, pra drejt konfigurimit të hapësirave të veta urbane. Brezat që vijnë do të kenë dy rrugë : ose do të prishin ato që ndërtohen apo janë ndërtuar deri tani, ose do të ndërtojnë qendra të reja urbane, duke e braktisur atë që ne sot quajmë qendra e Tiranës. Piramida rezervon në vetevete një hapësirë të mundshme ndërtimi sot ose në të ardhmen. E rëndësishme, sikurse në piramidat mitike, nuk është ndërtesa për të cilën po debatohet, por trualli sipër të cilit ajo është ndërtuar. Konflikti për hapësira ndërtimi transformohet në një konflikt politik, me “simbole historike”, me “histori”, me “trashëgimi” etj.

E vërteta është se Shqipëria ka nevojë për një ndërtesë të re Kuvendi. Te piramida apo gjetiu. Kjo është punë e pushtetit ekzekutiv dhe nuk ka vend të merret Kuvendi me të. Kuvendi tani po uzurpon edhe kompetenca që nuk i ka fare, sikurse është vlerësimi historik i ndërtesave, planimetria e Tiranës, arkitektura etj. Qytetarët nuk i paguajnë për këto debate parlamentarët.

Shqipërisë i duhet një investim për së mbari për një ndërtesë Kuvendi. Qeveria, nëse i ka paratë, le të na e bëjë për t'a përdorur atë sa më shpejt. Por, vetëm në bazë të një parimi. Ndërtesa e Kuvendit duhet konceptuar si e qytetarëve dhe jo thjesht e deputetëve. Kuvendi nuk është tempulli ku rrinë deputetët. Arkitektura, zgjidhja urbanistike, planimetria, interieret etj., duhet të plotësojnë këtë parim. Me parkingje nëntokësorë në mënyrë që të mos ndotet mjedisi dhe prishet peisazhi nga mori veturash luksoze që përndryshe do të parkoheshin

jashtë, nëpër rrugët rreth e rrotull.

Me mundësi që brenda saj të instaloheshin qendra informacioni, kanale televizive, salla konferencash me gazetarët, që tani i marrin intervistat e tyre poshtë kangjellash me ndryshk.

Mbi të gjitha, një mjedis kuvendi ku të hyjnë qytetarët për të dëgjuar seancat e Kuvendit pa pasur nevojë për ftesa speciale a të përzgjedhur si “qytetarë të mirë”, dalluar nga një “turme anonime” që nuk qaset në asnjë institucion.

E mbi të gjitha një qendër sociale, që të riprodhojë brenda saj një qytet, vend aktivitetesh të shoqërisë civile, strehë për artistë e aktivitete intelektuale, salla mbledhjesh për aktivitete politike partish, shoqatash, koncerte etj., e hapur pra ndaj qytetit dhe qytetarëve.

Kjo është detyra e grupit konceptues dhe realizues. Qytetari ka nevojë të dijë nëse ndërtesa e re e Kuvendit që planifikohet të ndërtohet do t'i realizojë apo jo këto parametra demokratikë. Ky është problemi i vërtetë. Problemi në këtë rast është se çfarë do të ndërtohet. Nëse i realizon këto parametra, do t'a ketë jetën e gjatë. Do t'i shërbejë demokratizimit të vendit. Sepse ndërtesa e Kuvendit nuk është salla e deputetëve, është, përkundrazi, një kompleks i tërë që bën pjesë në mekanizmat e procesit demokratik. Po qe se nuk bëhet e tillë, edhe ajo, pas disa dekadash, do të ketë përsëri fatin e Piramidës së tanishme, në mos më keq. Nëse, larg qoftë, konceptohet e ndërtohet si “bunker”, i shkëputur nga jeta e polisit dhe nga qytetari, atëherë vërtetë, veç të tjerave, do të na vinte keq që Piramidën e tanishme e prishëm, dhe do ta kujtonim me nostalgji duke thënë : “Aty dikur ka qenë Piramida, e prishën kot !”



## Rikuperimi dhe trasformimi i boshllëqeve urbane në Medinën e Tripolit, Libi

Dorina Papa

### ABSTRACT

Radical interventions in the "heart of the historic city" present many difficulties. It is important not to damage the city's roots, its history, and the collective memory of the city. In order to preserve these aspects, we must respect the social and human heritage embodied in the city's architecture. Filling the empty space with "buildings", which quite often result from and exist to satisfy the personal ego of the architect, is not enough. New buildings should naturally and harmoniously interact with the existing context and the city's social life in general. The case of Tripoli's Medina is the case of a delicate intervention in the urban voids within the medina. The proposed project aimed to recreate the lost/previous atmosphere of the medina (the result of abandonment, demolition and poor maintenance), and bring it back as an important part of contemporary Tripoli.

Tema projektuese nis në kuadrin e një linje kërkimore që synon të ndërtojë strategji projektuese të afta të përballojnë problemin e rishkrimit dhe të transformimit të trashëgimisë ndërtimore ekzistuese, në aspekte dhe dimensione të ndryshme: që nga ato konstruktive e arkitekturore, te ato urbane, infrastrukturore dhe të peisazhit.

Ky problem duket të jetë qendror në panoramën e qyteteve mesdhetare (Algjer, Tunizi, Bejrut, Split, Palermo, Napoli, Marsejë, Barcelonë etj.), e karakterizuar nga një mbivendosje e vazhdueshme gjurmësh që synojnë të përcaktojnë një ekuilibër të ri urban, nisur nga elementet më interesante të ekuilibrit të mëparshëm.

### Rasti i Medinës së Tripolit

Studimi dhe transformimi i pasurisë arkitekturore përqendrohet në qendrën historike, Medinën e Tripolit, një qendër historike e shënuar thellësisht nga kultura e Islamit *magrebin*, me një histori urbane komplekse, që bashkëshkrin kontributin e komunitetit islamik, të krishterë dhe hebraik, në një amalgamë që e emërtojmë si *medinë mesdhetare*.

Medina e Tripolit, në krizë të thellë si pasojë e transformimeve më të fundit që

minojnë vetë esencën e sistemit urban të saj, kërkon strategji të reja projektuese, në gjendje ta riintegrojë, si pjesë të gjallë, në brendësi të Tripolit bashkëkohor.

### Medina e Tripolit - Vështrim historik

Tripoli shtrihet në një nga gjiret më të mrekullueshme të Afrikës Veriore. Që në themelimin e tij në shek. VII p.e.re nga fenikasët, qyteti u zhvillua në lidhje të ngushtë me portin, falë edhe pozicionit të tij qendror në Mesdhe.

Në kohët antike Mesdheu ka qenë një hapësirë gjeografike me rëndësi të jashtëzakonshme, djep i qytetërimeve që lulëzuan në brigjet e tij, falë lidhjeve që ky det krijonte ndërmjet botëve të ndryshme. Në shek. VII u bë teatër i qytetërimit arab dhe i përhapjes së tij në Europën Jugore. Më vonë tregtarët e republikave marine italiane, e shndërruan atë përfundimisht në një nyjë ndërlidhëse të Europës, Azisë dhe Afrikës.

Për vetë pozicionin gjeografik kyç dhe pasuritë natyrore, Tripoli ka qenë në shënjestër të qytetërimeve të ndryshme që hera-herës zotëruan në Mesdhe: qytetërimi romak, bizantin, arab, islamik, otoman e deri



në kolonizimin italian në shekullin e kaluar. Tripoli bashkëkohor, por mbi të gjitha, *Medina* janë rezultat i influencës dhe mbivendosjes së kulturave të ndryshme, aq sa mund të flasim për një qytet vertikal të shtresëzuar, ku dy shtresat kryesore janë qyteti romak dhe ai arabo-islamik.

## Tripoli - qyteti romak

Në shek.I p.e.re Tripoli u pushtua nga romakët, të cilët e përfshinë në provincën afrikane dhe e quajtën *Regio Syrtica*. Rreth shek. III p.e.re provinca u njoh si *Regio Tripolitana*, për shkak të tri qyteteve kryesore: *Oea*, *Sabrata* dhe *Leptis*.

Gjatë periudhës romake urbanistika e qytetit karakterizohet nga sistemi i rregullt *kardo* dhe *dekuman*. Arteriet e Tripolit të hershëm me origjinë romake, zgjaten sipas dy drejtimeve kryesore dhe kryqëzohen nën harkun e Mark Aurelit (prezent edhe sot). Kjo duhet të ishte edhe qendra e qytetit romak, sheshi kryesor.

Gjurmët e transeve dekumane dëshmojnë për një sistem rrugësh paralele me aksin kryesor, të orientuara nga deti, i cili ka qenë gjithmonë burim jete për qytetin. Nga qyteti romak sot mbeten vetëm disa shenja të sistemit urban dhe i vetmi monument është

Harku i Mark Aurelit. Ndërtesat publike dhe banesat janë të një periudhe më të vonshme.

## Tripoli - qyteti arabo-islamik

Gjatë pushtimit arab të shek. VII qyteti u transformua në një aglomerat shtëpish kompakte, me rrugë me dredha, nga hapen fare pak dritare. Rrugët e qytetit mysliman shpesh lidhen me rrugica qorre, të errëta dhe të ngushta (cul de suc), që krijojnë akses të drejtpërdrejtë për banesat, të cilat marrin dritë dhe ajër, jo nga rruga, por nga oborret e brendshme.

Qyteti kthehet në një agregat shtëpish që nuk e shfaqin jashtë formën dhe rëndësinë e tyre. Rregullsia e qytetit helen dhe romak braktiset tashmë, në favor të një sistemi urban më kompleks, që i përngjan strukturës së një labirinti, dhe si labirinti duhet parë nga lart për të kuptuar rregullin.

E parë nga lart, Medina ngjan si një masë e vazhduar, uniformisht e vrimuar (nga oborret e brendshme). Kalimet urbane kanë karakteristike harqet, kontrafortët dhe *sabatt*-et (kalime mbi rrugë nga banesa në banesë). Janë pikërisht këto elemente që i japin vazhdimësi sistemit konstruktiv dhe përcaktojnë një sistem kompleks kalimesh në disa nivele.

Dorina Papa ka kryer studimet në Arkitekturë në universitetin "Gabriele D'Annunzio" në Pescara dhe është diplomuar në vitin 2007 me një temë diplome në "Projektim urbanistik dhe kompozim arkitektonik" me temë "Rikuperimi dhe transformimi i boshllëqeve urbane në Medinën e Tripolit, Libi". Pas një eksperience gjatë periudhës së studimit në studio inxhinierie dhe arkitekture në Pescara dhe Ghieta u kthye në Shqipëri, ku punon në sektorin e Urbanizimit pranë Aluiznit të Qarkut Durrës. Gjatë kësaj periudhe bashkëpunon edhe me EPStudio Projekt në Durrës. Nga viti 2008 është asistente pedagoge për lëndën e Studios në Universitetin Polis.











Shtëpitë tipike të Tripolit të ndërtuara nga shek. XVII në shek. XIX janë të organizuara rreth një oborri qendror, me formë gati kuadratike, me portikë karakteristik, të rëndë dhe të plotë në bazament, dhe të lehtë në katet e sipërme. Përreth oborrit organizohen dhomat në një ose disa nivele dhe hyrja kryesore për në banesë bëhet gjithmonë nga oborri i brendshëm dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga rruga.

## ABSTRAKT

Ndërhyrjet rrënjësore në "zemër të qytetit historik" janë të vështira. Është e rëndësishme të bëjmë kujdes të mos cenohet kujtesa e qytetit, rrënjët e tij, historia, duhet respektuar trashëgimia në kuptimin e përgjithshëm (trashëgimia sociale dhe njerëzore, monumentale dhe arkitektonike, estetike dhe kulturore).

Kjo do thotë se nuk mund të na kënaqë vetëm mbushja e hapësirave boshe (me vepra fryte të fantazisë personale të arkitektit-artist), por duhet të krijojmë arkitekturë harmonike, të integruara dhe ndërlidhura me kontekstin që i rrethon.

Rasti i medinës së Tripolit është rasti i një ndërhyrjeje projektuese delikate në boshllëqet e formuara në brendësi të qendrës historike. Projekti i propozuar synon të rikrijojë atmosferën e humbur të medinës (pasqje e braktisjes, shembjes dhe mosmirëmbajtjes), për ta rikthyer atë në një qendër të rëndësishme të Tripolit bashkëkohor.



Arkitektura e shtëpisë arabe, përmes vendosjes së qartë të ambienteve, dekorit me shije, kontrastit elegant të strukturave murore të katit përdhes dhe elementeve të lehta prej druri të kateve të sipërme, krijon një identitet të fortë në qytetin arabo-islam, ku tashmë ndërtimet romake janë zhdukur plotësisht.

Nga pikëpamja e organizimit të funksioneve publike, qytetet arabe e humbasin kompleksitetin e qytetit grek dhe romak; nuk gjejmë në to fore, bazilika, stadione, gjimnaze, teatro dhe amfiteatro, po vetëm banesa private dhe dy tipologji ndërtesash publike: xhamitë për kultin fetar dhe hamamet për mirëqënien e trupit.

Xhamia është ndërtesa kryesore e kultit të fesë islame. Ajo, përveç funksionit fetar ka

edhe funksion politik e social: në fakt xhamia përbën edhe qendrën e një sërë funksioneve publike, si gjykatë, shkollë, sallë asambleje etj. Shpesh në ambientet që i bashkëngjiten Medinës gjejmë madje edhe biblioteka e spitale.

Në qytetet arabe nuk ekziston sheshi (thamë që të vetmet boshllëqe në strukturën urbane të medinës janë rrugët e ngushta dhe oborret e brendshme) dhe xhamia luan rolin

e një ndërtese kolektive për socializim.

Xhamia nuk i ngjan tempullit pagan (objekti i mbyllur për njerëzit, që shihet nga jashtë), dhe as kishave kristiane (ku të gjithë besimtarët marrin pjesë në ceremoninë kolektive). Ato janë salla të mëdha me kolonata ku secili besimtar apo grup besimtarësh gjen një vend të caktuar. Kjo është një karakteristikë e xhamive në Libi, pasi në tipologjinë tradicionale salla nuk është ipostile.

Xhamitë më të mëdha të Tripolit që reflektojnë më së miri këtë karakteristikë janë Xhamia Karamali dhe Xhamia Gurgi në pjesën jugore të Medinës.

Strukturat tipike të qytetit arab janë ato tregtare: *suk*-et që zgjaten në një apo

disa rrugë kryesore, të mbuluara apo të zbuluara në formë *bazar-i* ( bazar është një fjalë persiane (wazar, do të thotë shesh) dhe po kaq interesante është edhe origjina e termit suk , që do të thotë diçka e ngushtë e vazhduar), dhe *funduqet* që janë hotele apo hane për tregtarët.

Në Medinën e Tripolit pothuajse të gjitha funksionet publike janë të përqendruara përgjatë aksit kryesor që lidh harkun e

nga sistemi romak ka ruajtur një shtyllë kurrizore, që e lidh atë edhe sot në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetin bashkëkohor jashtë mureve.


## Tripoli - periudha e kolonizimit italian

Menjëherë pas zbakimit të italianëve në Libi në vitin 1911, qëndrimi i tyre ndaj Medinës theksohet më së miri



Qyteti Arab, rrugët

Mark Aurelit me hyrjen kryesore të qytetit . Vihet re pra, një lloj “zone e privilegjuar” në vendosjen e funksioneve publike, që nuk është aq e rastësishme, pasi i përgjigjet sistemit të hershëm *kardo* dhe *dekuman*, sistem që arriti të mbijetojë me gjithë transformimet e qytetit, pasi ishte i lidhur ngushtë me tri portat kryesore të qytetit: portën e detit dhe dy portat në jug dhe jug-perëndim nga ku krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë me rrugët kryesore, që të çonin në brendësi të vendit (në shkretëtirë) dhe në rrugën përgjatë bregdetit. Kjo do të thotë se ndryshe nga qytetet e mirëfillta arabe ( si Tunisi, Kairouan etj.) që janë më homogjene, si nga pikëpamja e strukturës urbane, ashtu edhe në aspektin organizativ, Medina e Tripolit e udhëhequr



Qyteti Arab



në Planin Rregullues të Tripolit të vitit 1912 . Italianët përqendrohen në ndërtimin e qytetit të ri përtej mureve dhe lënë thuajse të paprekur Medinën.

Ndërhyrjet e vetme në Medinë, kanë të bëjnë me rievimin dhe katalogimin e xhamive , kishës, sinagogës, zbulimin e harkut të Mark Aurelit deri në kuotën arkeologjike të qytetit antik, zgjerimin për arsye higjienike të rrugës që lidh Portën e Re me Portën e Detit.

Ky qëndrim shpreh një strategji të prerë projektuese që kërkon ta izolojë popullsinë vendëse brenda Medinës për të evituar përzierjen me qytetin e ri , të ndërtuar apostafat për italianët.

Plani rregullues i vitit 1914 konfirmon të njëjtat zgjedhje projektuese ku i vetmi ndryshim është prishja e mureve dhe shumimi i hyrjeve në qytet.

Tema urbane më domethënëse e Planit Rregullues të vitit 1914 është transformimi i hapësirës së paformës pranë portës Bab El-menscia, në jug të Medinës. Transformimi nis me ndërtimin e Bashkisë dhe teatrit Miramare, dhe vazhdon me ndërtesat me vullë racional-fashiste “ Banco di Roma “ dhe “Institutit Kombëtar të Sigurimeve”, të cilat përcaktojnë edhe kufirin e sheshit Italia. Sheshi i ri kthehet kështu në hapësirën qendrore publike të qytetit në dalje të Medinës dhe kështjellës (duke qenë se Medina nuk kishte sheshe), pikë takimi dhe ndalesë të detyruar për ata që vijnë nga rrugët më të rëndësishme: Rruga Sicilia që lidh stacionin hekurudhor në lindje, Rruga Vittorio Emanuele III që të çon tek sheshi i Katedrales dhe Shëtitorja Volpi (vaterfronti i ri ku ndodhen hotelet më në zë).

Periodha koloniale shënoi një lulëzim dhe një zmadhim të dimensioneve të qytetit,

por njëkohësisht edhe një shkëputje të raportit me Medinën. Medina edhe pse tashmë e zhveshur pjesërisht nga muret rrethuese, nuk arriti të integrohej në procesin e zhvillimit të qytetit kolonial. Kufiri ndarës ekziston ende ndërmjet Medinës dhe qytetit bashkëkohor, dhe një nga shkaqet është ndërtimi i një infrastrukture rrugore të pakapërcyeshme në shërbim të portit ( tashmë i zmadhuar sipas porosisë së planit italian të vitit 1914).

## Patologjitë aktuale

Transformimet më të fundit të Medinës mund t'i permblehim në dy arsye kryesore: dinamikat esogjene ( probleme që lidhen me raportet ndërmjet trupit të Medinës dhe qytetit bashkëkohor) dhe endogjene ( problemeve të lidhura drejtpërdrejt me kushtet e banimit në Medinë ).

Sot Medina perceptohet si pjesë e veçuar nga qyteti. Ndërsa ndërtesat kryesore përfaqësuese të institucioneve kolektive islamike ( xhami, medrese, hamam, funduk) të ndërthurura me rretjen e gjallë të kalimeve të mbuluara të suq-eve, përbëjnë akoma një zonë tërheqëse për popullsinë urbane, pjesa më e madhe e lagjeve të banimit dhe mbi të gjitha lagjet periferike pranë mureve janë në kushte të rënda degradimi nga pasojat sociale, ekonomike e strukturore. Në veçanti lagjja e hebrenjve, e artikuluar rreth sinagogës, zona në kontakt me portin, skajet pranë mureve antike të shembura nga italianët në periudhën koloniale, paraqesin hapësira të mëdha boshe si pasojë e shembjes së ndërtesave, ndërhyrjeve të papajtueshme dhe një braktisjeje në masë nga ana e banorëve vendës.

Më pas ngulja në struktura të tilla e popullsisë së imigruar nga zona të thella të

Afrikës, ka sjellë degradimin e mëtejshëm fizik dhe social, duke transformuar pjesë të “qytetit të vjetër” në “qytet të varfër” deri në shndërrimin e tij në *slum* vitet e fundit.

Përveç shembjes së disa pjesëve të mureve rrethuese dhe bastioneve gjatë periudhës koloniale, izolimit të disa monumenteve të antikitetit, si Harku i Mark Aurelit, ndërtimi i objekteve të reja që zor se ballafaqohen me strukturën urbane të qytetit tradicional islam ka përcaktuar plagë akoma më të thella që ende sot, nuk po shërohen. Shpesh herë gjejmë tipologji shtëpish perëndimore, shtëpi të izoluar, pa oborr të brendshëm dhe me dritare nga rruga. Ky fenomen, i shumuar, do të çonte në humbjen e asaj karakteristike urbane që është tipike e qytetit arab: vazhdueshmëria e strukturës urbane (shtëpitë me mure të përbashkëta) dhe introvertiteti i banesës apo ndërtesave të tjera publike.

Gjithashtu, ndërhyrjet punktiale restauruese në shtëpitë dhe ndërtesat publike më të rëndësishme, me vlera historike-arkitektonike janë zgjidhje specifike (rast pas rasti) dhe nuk janë në gjendje të përballen me problemin kompleksiv të rekuperimit dhe rikualifikimit të qytetit të vjetër.

## Strategjia e propozuar


Studimi i hollësishëm i Medinës tregon se aktualisht zona më e frekuentuar e saj nis në portën jugore (zona e Kështjellës, në kontakt me sheshin Italia) dhe përfundon në kryqëzimin e Harkut të Mark Aurelit. Historikisht kjo ka qenë zemra e Medinës, zona ku ngriheshin ndërtesat më të rëndësishme publike: xhamia, hamami, shtëpitë më të pasura dhe suk-et tradicionale. Ky zhvillim i përqendruar lidhet ngushtë me portat e Medinës, pasi ky aks është ai që lidh



*Boshlleqet urbane të Tripolit*



shtëpi ndertesa fetare hamam funduk





qytetin përmes portës Bab El-menscia me Portën e Detit.

Portat e Medinës kanë qenë të pakta deri në periudhën e shembjes së mureve rrethuese. Shembja e mureve rrethuese bëri që sistemi i penetrimit në Medinë të shumëfishohej. Kështu kufiri i jashtëm i Medinës që deri vonë paraqitej si i mbyllur dhe i mbrojtur, u kthye në një sistem më poroz, i aksesueshëm në pika të ndryshme. Porta e jugut nuk është më hyrje e privilegjuar pasi në Medinë mund të penetrohet edhe nga rrugica të improvizuara, jo gjithmonë të dukshme dhe të drejtpërdrejta. Kjo bën që Medina të jetë e përshkueshme në mënyrë me homogjene.

Strategjia e projektit nis pikërisht nga ky konstatim.

Ideja e projektit është ajo e krijimit të një rruge të dytë të rëndësishme që përshkon lagjen perëndimore dhe përfundon në një nga hyrjet e reja të Medinës, duke thithur rreth vetes një sërë aktiviteteve tregtare dhe hoteliere. Kjo ndërhyrje nuk cenon aspak ndërtesat ekzistuese të Medinës, pasi nuk ka për qëllim të krijojë një çarje, po shfrytëzon kalime ekzistuese dhe krijon kalime të reja në hapësirat boshe. Duke absorbuar sistemin e boshllëqeve urbane ( të transformuara në qendër kulturore, hapësira ekspozite, hamam, hotel etj. sipas propozimit të projektit ) ky kalim i jep jetë gjithë sistemit dytësor të kalimeve ( rrugicave që lidhen me hyrjet e reja në Medinë dhe rrugëve qorre (cul de suc)).

Rol të rëndësishëm në idenë projektuese e ka edhe studimi i lëvizjes në Medinë, i lëvizjes së këmbësorëve por edhe i makinave. Është e rëndësishme të theksoj se në Medinë nuk parashikohet hyrja e makinave. Rrugët



e saj janë të ngushta dhe me dredha. Medina jetohet vetëm më këmbë, madje në kalime në nivele të ndryshme. Kjo e bën joshëse Medinën. Na e kujton Kalvino në “Qytete të padukshme” ku duke përshkruar Smeraldinën thotë : “ Rrjeta e kalimeve nuk është e vendosur në të njëjtën kuotë, po ndjek ngjitje-zbritjet e shkallëve, korridoret, urat, rrugët e pezulta. Duke ndërthurur shenja të kalimeve të ndryshme...secili banor çdo ditë argëtohet me itinerare te paparacaktuara.”

Por, Medina e sotme për të jetuar duhet t’u përgjigjet ligjeve të jetës moderne. Është e nevojshme funksioni i saj nga pikëpamja teknike. Strategjia e projektit merr parasysh domosdoshmërinë e aksesueshmërisë me makinë në Medinë ( për arsye shërbimi për aktivitetet tregtare, turistike dhe aksesueshmëri në kantieret e ndërtimit apo restaurimit të ndërtesave në Medinë). Projekti parashikon një lëvizje të kufizuar me makinë dhe mundësi parkimi dhe shkëmbimi të përkohshëm, pasi qëllimi i projektit është që të ruhet atmosfera e qetë e Medinës. Medina do të vazhdojë të jetohet në këmbë, ajo do të vazhdojë të jetë një labirint, ku secili udhëtar duhet të zgjedhi nëse do t’i besojë rastit apo ta kërkojë vetë rrugëdaljen, duke e dalluar mes shumë kalimeve të mundshme.

Në këte strategji të pergjithshme urbane vendoset projekti i një qendre kulturore dhe një hoteli te shpërndarë ( tipologji kjo shumë e përhapur kohët e fundit në botën perëndimore) në zonën e boshllëqeve të mëdha të Medinës, në lagjen perëndimore.

## Ndërhyrja arkitektonike

Referenca, koncepte, frymëzime.

Ndërtesat e botës arabe janë të shumta. Studimi i hollësishëm dhe kuptimi i tyre më bën të





akses nga rruget kryesore

City of the Architects

banesa me akses nga cul de sac







## oborret e brendshem



*Sistemi i boshllëqeve urbane hapësira të mëdha boshe*

mendoj se ekziston një pikënisje e përbashkët në konceptimin e tyre. Për këtë arsye vendosa të analizoj dy objekte shumë të largëta në kohë nga njëri-tjetri, por që duket se përcjellin një frymë, një atmosferë, rezultat i një qasjeje të ngjashme.

E para është Xhamia e së Premtes në Isfan të Iranit dhe e dyta një arkitekturë moderne, Climat de France ( ndërtesë banimi) në Algjer. Në të dyja projektet vihen re tri koncepte bazë:

### 1. Muri rrethues

Në projektin e parë vëmë re se ekziston një kufi ndarës i mirëpërcaktuar i xhamisë. Në

këte rast muri rrethues, që është pjesë e vetë ndërtesës, është i vazhduar dhe ndërpritet vetëm në zonat e hyrjes në xhami. Këto zona janë të shumëfishta dhe nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën. Shpesh herë hyrjet nuk janë kalime drejtvijëzore, por kalime në formë bajonete.

Një element tjetër që karakterizon murin rrethues është organiciteti i formës së tij. Ai nuk është drejtvijëzor, i përcaktuar, rezultat i një gjeometrie të prerë, po është një mur gati spontan, që lind si pasojë e përshtatjes së kompleksit të xhamisë në kontekstin e ndërtimeve ekzistuese.







## boshlleqet urbane



Në ndërtesën e banimit “Climat de France” muri rrethues i përgjigjet formës drejkëndore të ndërtesës. Edhe në këtë rast, megjithëse paraqitet si kufi i fortë ndarës mes hapësirës së jashtme dhe asaj të brendshme, ai është një element poroz me hyrje të shumëfishta.

## 2. Pjesa e plotë

Në projektin e parë duket se objekti në vetvete atë që do ta quaj “ pjesa e plotë” në përgjithësi paraqitet si një hapësirë e mbuluar me kolonata të rregullta që i bashkëngjitet murit rrethues.

Ajo është një hapësirë e vazhduar, që komunikon si me ambientin e jashtëm edhe me oborrin e brendshëm.

Në Climat de France pjesa e plotë është pjesa e banimit. Në këtë rast muri rrethues dhe objekti bëhen një, aq sa mund të thuhet se vetë objekti është një mur me spesor. Pra, në këtë rast koncepti i murit zgjerohet dhe përfshin edhe funksione e hapësira në vetvete.

## 3. Oborri i brendshëm publik

Në të dyja ndërtesat oborri i brendshëm karakterizohet nga një geometri e pastër

*Sistemi i boshllëqeve urbane oborret*






## FORMIMI I BOSHLLLEQEVE

MEDINA NE 1910



## TRANSFORMIMI I SISTEMIT RRETHUES - FORMIMI I AKSESEVE TE REJA



\_ SISTEMA CHIUSO E PROTETTO  
DALLE MURA  
\_ POCHE PORTE DI INGRESSO  
ALLA MEDINA

AKSESET DERI NE VITIN 1910




MEDINA NE 1944

MEDINA NE 2006




AKSESET PAS VITIT 1944

\_SISTEMA APERTO, IN CERCA  
DI NUOVE RELAZIONI  
CON LA CITTA' MODERNA  
\_PLURALITA' DI ACCESSI  
( SISTEMA POROSO)







*Ideja e projektit*

katrore apo drejtkëndore. Ai përbën zemrën e të gjithë organizmit, pasi jeta e vërtetë zhvillohet në oborrin e brendshëm si tek xhamia, ashtu dhe në kompleksin e banimit.

Ideja projektuese bazohet pikërisht në përkthimin e këtyre tri koncepteve bazë frymëzuese në arkitekturë.

### Përshkrimi i projektit arkitektonik

Projekti arkitektonik bazohet në gërshetimin e tri koncepteve të mësipërme (mur rrethues,


pjesë e plotë dhe oborr i brendshëm), që reflektohen edhe në mënyrën se si realizohet konstruktivisht projekti.

Veprimi i parë projektues është përcaktimi i një muri rrethues, i cili do të përbejë edhe kufirin e jashtëm me rrugën, një lloj muri mbrojtës i kuartallit. Muri rrethues është konceptuar si një element i deformuar si në plan dhe në lartësi. Ai ndjek konturin e kuartallit dhe përmes formës së tij gjarpërore krijon një qepje me strukturën ekzistuese të Medinës. Element frymëzimi për këtë ka qenë

*Strategjia e propozuar*



*Struktura ekzistuese*








pikërisht atmosfera e Medinës. Kudo gjen mure të vazhduar (aq sa nuk kuptohet kufiri i njëjës banesë nga tjetra), të përkulur, me lartësi të ndryshme. Për këtë arsye, mendoj se muret nuk duhet të “vënë rregull” përmes një geometrie të prerë, por duhet të flasin të njëjtën gjuhë me arkitekturën e Medinës që është e lidhur ngushtë me strukturën urbane të saj, madje e shkrirë me të, aq sa është vështirë të dallojmë objektin arkitekturor nga struktura urbane (pasi është i gërrshetur në mënyrë të pashqitshme me thurjen urbane).

Veprimi i dytë është mbushja e murit. Ai realizohet përmes një sistemi setesh murore të rregullt, që zmaterializohet në brendësi: sete murore, sistem kolonash, deri në hapësirën boshe të oborrit të brendshëm. E njëjtja përpjekje prej lehtësisë dhe zmaterializimit ndodh edhe në lartësi. Setet murore shndërrohen në kolona dhe kolonat prej betoni kthehen në kolona druri. I gjithë sistemi konstruktiv lehtësohet. Edhe vetë mbulesa prej druri pëson një deformim që e bën atë më të lehtë, të penetrueshme

1. IL MURO DI BORDO - RIEMPIMENTO DEL BORDO

















SPAZIO VIGENIO      SPAZIO NOTTE





nga drita. Idea e një mbulesë të vazhduar prej druri nën të cilën zhvillohet e gjithë jeta në Medinë frymëzohet nga arkitektura tradicionale e Medinës ku sistemi konstruktiv është i vazhduar dhe shtëpitë realizohen me mure të përbashkëta.

Veprimi i tretë projektues është realizimi i një hapësirë të përbashkët në pjesën më të mbrojtur të çdo kuartalli. Kjo hapësirë nuk është aq e vrazhdë sa mund të jenë oborret e brendshme gjeometrike, por konceptohet si një hapësirë e vazhduar ku kalimi fiton dimamizëm. Nga hija në dritë, nga hapësirë e mbuluar, në qiell të hapur, nga hapësira të kompresuara mes dy muresh në zgjerime të papritura, nga kalime në kuotën e terrenit, në ngjitje në nivel. Këto ndryshime shoqërohen edhe me ndryshime në perceptimin e vetë objektit: të peshës së tij, të materialeve dhe të ngjyrës.

Hapësira nën mbulesë fiton edhe një herë rendësinë e një vendi socializimi pasi nga qendra kulturore dhe hoteli, shumica e daljeve të detyrojnë jo vetëm ta përshkosh këtë hapësirë, por edhe të ndalesh në ambientet me hije. Të njëjtin dinamizëm që lidhet me efektin surprizues fitojnë edhe kalimet në rrugët kryesore. Vetë seksionet e rrugëve janë të ndryshme. Duket sikur humbet në rrugët e Medinës, por në fakt ekzistojnë shenja, linja udhëzuese, asgjë nuk përsëritet në mënyrë identike. Principi është i njëjtë. Ajo që ndryshon është forma. Forma i shërben kujtesës: „nëse nuk duam të humbasim duhet të bëjmë kujdes, të zhvillojmë analizën, kujtesën, zgjuarsinë“ (Vittorio Ugo, 1991, fq 160). Forma jo gjithmonë ndjek funksionin. Funksionet në qendrën kulturore duken se shkrihen me njëra-tjetrën aq sa është e pamundur të përcaktosh një kufi ndarës. Ato janë fryt i një



logjike të së përkohshmes. Kjo lidhet ngushtë me vetë kulturën e vendit ku duket se të njëjtat ambiente përshtaten për funksione të ndryshme. (P.sh., xhamia shfrytëzohet si objekt social dhe jo vetëm fetar). Hapësirat e projektuara të bibliotekës, sallave të internetit, dyqaneve të ekspozimit dhe shitjes së mallrave tradicionale, xhamisë, sallës së konferencave, ekspozitës së mirëfilltë duken si homogjene. Megjithatë, duke qenë se në këto ambiente krijohen gjithmonë prespektiva të ndryshme, kjo i bën ato më dinamike. Rikrijohet pra edhe në brendësi të vetë ndërtesës ideja e një labirinti, brenda labirintit të qytetit. [shtë pikërisht vetë loja e labirintit, që lejon të shijohen këto ambiente në tërësi dhe e bën vizitorin të ambientohet me hapësirat që e rrethojnë.



“Labirinti nuk është rezultat i kaosit, nuk është sinonim i crregullsisë, por një mekanizëm i ndërtuar mjeshtërisht për të ngatërruar dhe asgjësuar kundërshtarin, për ta zbavitur mikun duke bërë shaka. Që në zanafillë, labirinti propozohet si artific dhe projekt.” (Vittorio Ugo fq.147-168)

## Bibliografi:

G. MESSANA, *La Medina di Tripoli*, “Quaderni dell’Istituto di Cultura di Tripoli”, I, 1979, fq. 6-36

P. CUNEO, *Storia dell’urbanistica. Il mondo islamico*, Roma-Bari, Laterza, 1986.

M. TALAMONA, *La Libia: un laboratorio d’architettura*, in “Rassegna” n. 51, *Architettura nelle colonie italiane in Africa*, 1992, fq. 62-79.

M. TALAMONA, *Città europea e città*

*araba in Tripolitania*, in *L’architettura italiana d’oltremare (1870-1940)*, catalogo della mostra omonima (Bologna, 26 Settembre 1993-10 gennaio 1994), a cura di G. Gresleri, Marsilio, Venezia, 1993, fq. 257-277.

L. MICARA, *Città storica e architettura moderna in Libia. Il caso di Tripoli*, in *Architettura Moderna Mediterranea*, Atti del Convegno Internazionale, Bari, 10 aprile 2002, a cura di G. Strappa, A. B. Menghini, Bari, Mario Adda, 2003, fq. 81-96.

L. MICARA, *Scenari dell’abitare contemporaneo: Tripoli Medina mediterranea*, “Piano Progetto Città, Rivista dei Dipartimenti di Architettura e Urbanistica di Pescara”, n. 20-21, 2003, fq. 134-141.


R.PAVIA, *Babele*, Roma, Meltemi, 2002, fq. 82-86.

Ideja e projektit



LE NUOVE FUNZIONI

CENTRO CULTURALE 1 e 2 Spazi espositivi e di vendita per prodotti artigianali tradizionali, 3 biblioteca, 4 sala internet, 5 sale espositive, 6 bar, 7 moschea, 8 sale studio (madrasa), 9 RESIDENZE TURISTICHE E 10 SUO



VISIONE DALL'ALTO  
TESSUTO ESISTENTE E PROPOSTA PROGETTUALE



VISIONE DALL'ALTO  
TESSUTO ESISTENTE E PROPOSTA PROGETTUALE




LE NUOVE FUNZIONI


CENTRO CULTURALE: 1 e 2. Spazi espositivi e di vendita per prodotti artigianali tradizionali, 3 biblioteca, 4 sale internet, 5 sale espositive, 6 bar, 7 moschea, 8 sale studio (madrasa), 9 RESIDENZE TURISTICHE




VISIONE DALL'ALTO  
TESSUTO ESISTENTE E PROPOSTA PROGETTUALE




VISIONE DALL'ALTO  
TESSUTO ESISTENTE E PROPOSTA PROGETTUALE













*Kalimi i brendshëm*





## Standarde të panjohura apo të pazbatuara? Legjislacioni shqiptar dhe mjedisi pa barriera

Blerta Çani dhe Bardhylka Kospiri

### ABSTRACT

In this article, the authors focus on the importance of accessible design in terms of social inclusiveness. They analyze the progress of the development of a legal framework in this field, and the problems in terms of its implementation in the surrounding environment. Through the results of the surveys, they bring to the attention of readers the fact that, despite the existence of legislation, the construction business continues to include barriers which prevent its equal use from everyone. The article emphasizes the importance that the educational process of aspiring architects, urban planners, builders, and engineers, plays on the prevention of barriers in construction. To this end, it is necessary to enrich the current curricula and teaching methodology with the indispensable knowledge needed towards a conceptualization of universal design. The article also presents the necessary steps towards progress.

### Hyrje

Parimet e mosdiskriminimit dhe të barazisë janë në themelet e një shoqërie demokratike.

Mohimi i aksesit në mjedisin e ndërtuar nuk është vetëm një veprim diskriminues për personat me aftësi të kufizuara, por edhe shkelje e të drejtës së një individ për të marrë pjesë në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Shumë ndryshime po zënë vend në shoqërinë tonë, të cilat kontribuojnë në të kuptuarit se si përshtatshmëria është çelësi drejt një shoqërie gjithë përfshirëse. Është në rritje vlerësimi që ne të gjithë jemi të ndryshëm, por kemi të drejta të barabarta. Të gjithë kërkojmë t'i përkasim një mjedisi ndërtimor të përshtatur, pa barriera që pranon dhe përshtat ndryshimet.

Që një individ të mund të gëzojë të drejtat e tij si qytetar duhet që, veç të tjerash, të arrijë të përdorë konstruksionet, ndërtesat dhe mjedisin në tërësi. Për këtë kërkohet detyrimisht që mjedisi të jetë i përshtatur në mënyrë që çdo person të ketë mundësi të strehohet, të kërkojë punë, të marrë edukim dhe trajnim dhe të bëjë një jetë ekonomike e sociale aktive.

“Aktualisht unë jetoj në një apartament, në një pallat të ri që është i pajisur me

ashensor, por ai fillon në një lartësi mes kati, dhe ka shumë shkallë për të arritur deri aty. Sforcimi i përditshëm i prindërve të mi për të më ngritur peshë në këto shkallë më ka detyruar të kërkoj një tjetër banesë për t'u strehuar, në një pallat që minimalisht të mos ketë shkallë në hyrje, të ketë ashensor që fillon që nga kati përdhes (më e mira nëse fillon nga parkimi nëntokësor) dhe që ashensori të ketë përmasa që të mund të futet karrigia ime me rrota në të.

Jam duke kërkuar në të gjithë Tiranën për një pallat që të ketë këto kushte. Ajo që kam gjetur deri tani është një numër gjithnjë e në rritje personash të tjerë me aftësi të kufizuara në kushtet e mia, me të cilët apo edhe me familjarët e tyre, po takohemi gjithnjë e më shpesh para pallatesh që na ofrojnë çdolloj pengese dhe vetëm zgjidhje jo.” (L. S. tetraplegjike)

*Përshtatshmëria* nënkupton lehtësi për të hyrë, për të marrë pjesë dhe përdorur mjediset e banimit, edukimit, punës e argëtimit, në mënyrë të sigurt, të pavarur dhe me dinjitet nga të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

*Territor i përshtatur* është territori, që ofron përdorim të sigurt, të barabartë e të

pavarur nga të gjithë personat, përfshirë personat me aftësi të kufizuara ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta<sup>1</sup>.

## Gilat janë barrierat mjedisore ?

- a) Pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuara, të përhershme ose të përkohshme.
- b) Pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo për përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve dhe pjesëve përbërëse<sup>2</sup>.

Përshtatshmëria e mjedisit ndërtimor lidhet me një numër të madh grupesh dhe personash të shoqërisë sonë. Më shumë se një e katërta e popullsisë së Europës përballet me problemet e përshtatshmërisë në jetën e përditëshme<sup>3</sup>. Secili prej nesh mund të përballet me këto lloje rreziqesh. Mjedisin ynë, veçanërisht në qytetet e mëdha

krijon pengesa dhe vështirësi kalimi, të përkohshme dhe të përhershme për të gjithë njerëzit, por në mënyrë të veçantë për personat me aftësi të kufizuara. Ata, të cilët rrethohen nga një ambient ndërtimor i papërshtatur natyrisht, në rradhë të parë janë personat me dëmtime fizike (të përkohëshme apo të përhershme), dëmtime të shikimit apo të dëgjimit, si edhe çrregullime të të mësuarit. Si këta mundet gjithashtu të jenë të mitur ose tepër të moshuar.

Rezultatet e vëzhgimeve të bëra në vitet e fundit në Shqipëri tregojnë se ..... *personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre ende i përkasin pjesës së marginalizuar të shoqërisë shqiptare. Ata janë të varfër dhe të izoluar në një shoqëri të cilës i duhet të zhdukë barrierat arkitektonike dhe shoqërore<sup>4</sup>.*

Ky artikull synon të bëjë prezent ecurinë e përmirësimeve të legjislacionit dhe politikave shqiptare për ndërtimin e mjedisit të përshtatur dhe procesin e zbatimit të tyre.

## Përshtatshmëria në legjislacion dhe politika

4 FSHDPAK (2009). Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara për vitet 2008 – 2009.



Blerta Çani, është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës dhe Fakultetin e Inxhinierisë, dega Elektrike, në Universitetin Politeknik. Ka kryer studimet Master pranë Fakultetit të Shkencave Sociale dhe është në fazën përmbyllëse të realizimit të Doktoraturës, e cila është e fokusuar në përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël në Shqipëri. Mbart një eksperiencë pune në Ministrinë e Punës dhe organizata të shoqërisë civile. Është autore e disa botimeve, studimeve e vlerësimeve në fushën e politikave për aftësinë e kufizuar. Është përfshirë si konsulente, moderatore, hartuese, koordinatore, trajnuese, folëse në shumë aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. Është aktualisht drejtore ekzekutive e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Bardhylka Kospiri, është diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Ching I Hua, Pekin, Kinë. Me një aktivitet projektimi deri në vitin 2002, kur për shkak të aftësisë së kufizuar shkëputet për t'u përfshirë në lëvizjen për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Anëtare e grupeve të punës në hartimin e dokumentave politike dhe akteve ligjore për ndërtime të përshtatura, si dhe rregulloreve të normave urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara. Autore dhe bashkëautore në studime mbi zbatimin e legjislacionit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë në realizimin e mjedisit ndërtimor pa barriera. Eksperte në auditimin për vlerësimin e nivelit të përshtatshmërisë së objekteve. Aktualisht është drejtuese programi në Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

1 Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009. " Për Planifikimin e Territorit ".

2 VKM Nr 1503, datë 19.11.2008 " Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara "

3 Raport i Grupit të Ekspertëve të Komisionit Europian, (2003). "2010: Një Europë e përshtatur për të gjithë".





Shoqëria shqiptare, e dalë nga një sistem totalitar, ku mungonte krejtësisht pjesëmarrja qytetare në planifikim e vendimmarrje, ka ecur me hapa shumë të ngadaltë në drejtim të gjithëpërfshirjes.

Në Shqipëri statistikat zyrtare flasin për 121500 persona<sup>5</sup> me aftësi të kufizuara në lëvizje, në shikim e dëgjim, të regjistruar dhe përfitues nga skemat e përkrahjes sociale. Ndërkohë që shifra reale është më e lartë, sepse kategori të veçanta të aftësisë së kufizuar, si persona me probleme zhvillimi, më dëgjim të dëmtuar etj. Janë të paevidentuar sepse nuk përfitojnë nga skemat e përkrahjes për shkak të mangësive ligjore. Personat me aftësi të kufizuara përjetojnë izolimin dhe veçimin, duke u diskriminuar me pamundësinë për të shkuar në shkolla, për t'u punësuar, për të arritur shërbimet e domosdoshme shëndetësore, për të marrë pjesë në aktivitete si gjithë të tjerët për shkak të barrierave të shumta që mjedisi ndërtimor ngre ndaj tyre.

Legjislacioni shqiptar gjatë viteve '90, i mënjanoi pothuajse tërësisht alternativat për realizimin e një mjedisi pa barriera. Përpyekjet e para ligjore për realizimin e ndërtimeve pa barriera i gjejmë në Statuset<sup>6</sup> e grupimeve të personave me aftësi të kufizuara, në vitet 1994-2000, ku në nene të veçanta u përfshi detyrimi për ndërtime të reja pa barriera për personat me aftësi të kufizuara. Këto nene nuk u

zbatuan për shumë arsye, duke veçuar atë të mungesës së vëmendjes dhe të vullnetit politik të institucioneve përgjegjëse, për të dhënë zgjidhjen e duhur. Fatkeqësisht edhe specialiste të fushës dhe rrethet akademike nuk luajtën rolin e duhur në këtë proces.

Pas vitit 2000, një përpjekje më e organizuar e një grupi shoqatash dhe individësh me aftësi të kufizuara, të grupuara pranë FSHDPAK<sup>7</sup>, nëpërmjet fushatave të shumta të ndërgjegjësimit, të avokatisë dhe lobimit për përmirësime ligjore në këtë fushë, bënë që të ndërtohej dhe të funksiononte një rrjet bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve dhe të përgatitej dhe miratohej në vitin 2004 një Paketë Normash Urbanistike dhe Arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara, e para e këtij lloji, si pjesë e Rregullores së Urbanistikës, me të njëjtin detyrim ligjor për zbatim<sup>8</sup>. Kjo Paketë Normash, gjatë gjithë kohës së funksionimit deri në shfuqizimin e saj, në nëntor 2008<sup>9</sup>, nuk arriti as të njihej sa duhej nga specialistët, ndërsa rezultatet e zbatimit të saj ishin pothuajse të padukshme.

Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me aftësi të kufizuara<sup>10</sup> në vitin 2005, e pozicionoi problematikën e mjedisit pa barriera në objektivat kryesorë të saj, si parakusht për integrim, në përputhje me rregullat

5 [www.minfin.gov.al/.../MPCSSHB](http://www.minfin.gov.al/.../MPCSSHB); Raporti i monitorimit për 6-mujorin e parë të vitit 2009, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale, dhe Shanseve të Barabarta

6 Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994, i ndryshuar, "Për Statusin e Invalidit të punës"; Ligji Nr.8098, datë 28.3.1996, i ndryshuar, "Për statusin e të Verbërit"; Ligji Nr. 8626, datë 22.6.2000, i ndryshuar "Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik"

7 Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, [www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al).



8 Vendim Nr.401, datë 25.6.2004. Paketa e Normave Urbanistike dhe Arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara.

9 Në 19 Nëntor 2008, miratimi i " Rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara", shfuqizoi " Paketën e Normave Urbanistike dhe Arkitektonike për personat me aftësi të Kufizuara".

10 VKM nr.8 , dt. 25 janar 2005 Strategjia Kombëtare e Personave me aftësi të kufizuar, [www.mpcs.gov.al](http://www.mpcs.gov.al)



Ashensori



Standarte të Kombeve të Bashkuara për Barazinë e Mundësive për personat me aftësi të kufizuara<sup>11</sup>. Në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie fusha e parë i përket pikërisht jetesës pa barriera, me objektiva dhe masa për zbatimin e tyre.

Hapa pozitivë u hodhën më tej në përfshirjen e problematikës së planifikimit dhe të zhvillimit të territorit pa barriera në ligjin e ri, në vitin 2009, “ Për Planifikimin e Territorit ”<sup>12</sup>, në grupin e punës për hartimin e të cilit kishte përfaqësim edhe të organizatave të aftësisë së kufizuar. Në këtë ligj çështja e planifikimit dhe zhvillimit të një territori të përshtatur për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara: a) Ka zenë vend në Qëllimin e ligjit; b) Është pjesë e Parimeve të planifikimit të territorit; c) përcaktohet si çështje e **Rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit**; d) Është detyrim për t’u përfshirë në rregulloret e ndërtimit; e) Është pjesë e objektivave të planifikimit vendor.

11 A/RES/48/96 (1993) Rregullat Standarde të OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Neni 5 përcakton detyrimet e shteteve për përshtatshmëri për personat me aftësi të kufizuara.

12 Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009. “ Për Planifikimin e Territorit “, neni 1, neni 3, neni 4, neni 6, neni 25, neni 27.

Një tjetër zhvillim pozitiv është edhe **miratimi i ligjit** ” Për mbrojtjen nga diskriminimi ”<sup>13</sup> që pozicionon dukshëm konceptin e “përshtatjes së arsyeshme” (reasonable accommodation), mospranimi ose kundërshtimi i së cilës përbën diskriminim në rastin e personave me aftësi të kufizuara. Ky koncept përbën një risi që duhet të ndikojë veçanërisht në nxitjen e zbatimit të legjislacionit aktual për ndërtimin e mjedisit pa barriera.

Ligji “ Për administrimin dhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit ”<sup>14</sup> parashikon gjithashtu detyrimin për sigurimin e përshtatjes së hyrjes në banesat e personave me aftësi të kufizuara, si detyrim të pushtetit vendor.

Në nëntor të vitit 2008 u miratua “Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara ”<sup>15</sup>. Në këtë rregullore përcaktohen rregullat teknike për ndërtime të përshtatura, njëkohësisht edhe për mjete transporti dhe

13 Ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 20.

14 Ligji Nr.10 112, datë 9.4.2009 “ Për administrimin dhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit, neni 40”.

15 VKM Nr 1503, datë 19.11.2008 “ Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.


Elemente përshtatshmërie

**ABSTRAKT**


Në këtë artikull autorët paraqesin rëndësinë e projektimit të përshtatur për gjithëpërfshirjen sociale. Ato analizojnë ecurinë e procesit të ndërtimit të kornizës ligjore në këtë fushë, si edhe mangësitë në zbatimin e saj, të jetësuar në mjedisin rrethues. Përmes rezultateve të vëzhgimeve ato sjellin në vëmendje të lexuesve se, edhe pse legjislacioni ekziston, mjedisi ndërtimor vazhdon të zhvillohet me barriera që pengojnë përdorimin e tij barazisht nga të gjithë njerëzit. Në artikull tërhiqet vëmendja se procesi i edukimit të studentëve - arkitektë, urbanistë, konstruktorë e ndërtues të ardhshëm luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e shfaqjes së barrierave në ndërtim. Për këtë është e domosdoshme të pasurohen kurrikulat dhe metodat e mësimdhënies me njohuritë e domosdoshme për konceptimin drejt projektimit universal. Në artikull paraqiten gjithashtu hapat që duhen bërë drejt progresit.



Elemente përshtatshmërie në rrugë



Përshtatshmëria në vendin e parkimit



në fokus të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar<sup>17</sup>.

## Çfarë ofron mjedisi i sotëm shqiptar?

Të gjitha studimet dhe vëzhgimet deri në vitin 2010 bëjnë të qartë se ka pasur përmirësime të kuadrit ligjor, kryesisht vitet e fundit, por moszbatimi i legjislacionit në vetvete përbën barrierë për ndërtimin e mjedisit të përshtatur. Ka përpjekje sporadike për zbatimin e legjislacionit, më të dukshme në Tiranë, në rikonstruksionin dhe ndërtimin e shkollave të reja; në objektet shëndetësorë, në kuadrin e investimeve nga Ministria e Shëndetësisë, etj. Megjithatë, niveli i realizuar i përshtatshmërisë në objekte, në asnjërin prej tyre nuk është në përputhje me të gjitha standardet.

Është vetëm një studim i mirëfilltë (FSHHPAK,1999)<sup>18</sup>, edhe ky shumë i

*promote the rights and full participation of people with disabilities in society: improving the quality of life of people with disabilities in Europe 2006-2015, in action area no.6.*

<sup>17</sup> Konventa e OKB u miratua në dhjetor 2006 nga Asambleja e Përgjithshme. Qeveria shqiptare e nënshkroi në 22 dhjetor të vitit 2009. Neni 9 i Konventës përcakton detyrimet e shteteve për arritje përshtatshmërie.

<sup>18</sup> FSHHPAK (1999) "Probleme të përshtatshmërisë të mjedisit ndërtimor në Shqipëri".

komunikimi të përshtatur. Gjithashtu aty janë vendosur edhe rregullat për zbatimin e këtyre rregullave teknike.

Ashtu si edhe vihet re, problematika e ndërtimeve pa barriera shfaqet kryesisht si pjesë në legjislacionet e përgjithshme, ndërkohë që është vetëm një dokument ligjor- "Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara", që i përket tërësisht kësaj problematike.

Një faktor që ka ndikuar në ecuritë pozitive për plotësimin progresiv të legjislacionit është edhe fakti se problematika e ndërtimit të një mjedisi pa barriera është direktivë e një numri dokumentesh europiane<sup>16</sup> si dhe është

<sup>16</sup> Recommendation Rec(2006)5 of the Council of Europe to member states on the Council of Europe Action Plan to



kufizuar, në lidhje me nivelin e arritshmërisë së disa objekteve publike në Tiranë nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Ky studim, i realizuar mbi bazën e një vëzhgimi të drejtpërdrejtë në disa objekte kryesore publike në Tiranë, për nivelin e përshtatshmërisë së tyre solli rezultatet e para që flisnin për papërshtatshmëri totale të mjedisit.


Të dhëna të mëtejshme janë marrë nga studime me fokus më të gjerë, në të cilat problematika në fjalë është pjesë përbërëse e tyre. Kështu, mund të përmendim studimin e realizuar nga CO-PLAN-i me rezultatet e vëzhgimit në qytetin e Tiranës, në vitin 2003, ku gjetjet tregojnë se papërshtatshmëria mjedisore shfaqet dukshëm në mjediset publike, të banimit dhe infrastrukturë në Tiranë<sup>19</sup>. Një studim i realizuar nga Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QKCSA-ISH) në Tiranë, në një këndvështrim më specifik, kryesisht për aksesin në qendrat e shërbimeve shëndetësore / spitalet, sjell të dhënat mbi nivelin e përshtatshmërisë (jo vetëm ndërtimore) nga 20 spitale të vendit. Nga ky studim rezultoi se 64 % e kërkesave dhe standardeve të përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në spitale nuk plotësohen, duke përfshirë hyrjet e spitaleve, pajisja dhe funksionimi i ashensorëve, aksesorët në dhoma e tualete etj.

Studimi “Lëvizja e lirë e personave me aftësi të kufizuara në Europën Juglindore : një e drejtë e paaksesueshme?”<sup>20</sup>, jep një tablo krahasuese të vendeve të rajonit për


19 Aliaj, B., Lulo K., Myftiu G. (2003), **Tirana - Sfida e zhvillimit urban**

20 Handicap International për Europën Juglindore (2006), “Lëvizja e lirë e PAK në Europën Juglindore : një e drejtë e paaksesueshme?”

**Banesa**



**Pozicionet e përshtatura në salla / auditore**







procesin zinxhir të lëvizjes së pavarur të personave me aftësi të kufizuara. Duke iu referuar intervistës me anëtarë të shoqatës së parë dhe tetraplegjikëve në Tiranë, në këtë studim bëhet e qartë se ... shumica e ndërtesave në Tiranë kanë shkallë dhe ashensorë të papërshtatshëm dhe për të hyrë e për të dalë një përdorues me karrige me rrota duhet të transportohet me krahë.

**Janë tri raporte studimi për monitorimin e Zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara për periudhat 2006; 2007 dhe 2008-2009.**

Këto studime u shtrinë në 6 qytete kryesore të Shqipërisë, duke bërë, krahas fushave të tjera, vlerësimin e situatës aktuale të mjedisit, me të cilin përballen çdo ditë personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri, si dhe paraqesin arritjet /mosarritjet në realizimin e një mjedisi të përshtatur, në përputhje me objektivat dhe masat për zbatimin e tyre në fushën e jetesës pa barriera të SKPAK<sup>21</sup>. Gjetjet në lidhje me përshtatjen e mjedisit ndërtimor në këto raporte monitorimi përmbledhen shkurt në një konkluzion brenda tyre, se “ Personat me aftësi të kufizuara i perceptojnë rrugët dhe komunitetin ku ata jetojnë si totalisht të papërshtatura. Ata, në 90% të rasteve, e kanë të vështirë të dalin nga shtëpia, të lëvizin në komunitetet e tyre, të marrin shërbimin e nevojshëm shëndetësor në poliklinika apo spitale, të shkojnë në vendin e punës apo të ndjekin shkollën apo kopshtin. Për më tepër, shumica e tyre ende nuk gëzojnë të drejtën civile më themelore: atë të votës për shkak të mungesës së përshtatshmërisë të shumicës së qendrave të votimit“.

Shqetësimi për moszbatimin e legjislacionit në këtë fushë shprehet edhe në Progres Raportin e vitit 2009 për Shqipërinë. “Kquadri ligjor për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara mbetet për t’u plotësuar. ....U miratuan masa të reja në planifikimin urban për të lehtësuar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, por zbatimi nuk ka filluar”<sup>22</sup>.

Një aspekt tjetër, ku jemi shumë të vonuar, por që do të ndikonte pozitivisht në ndërtimet e përshtatura, duke i paraprirë procesit që në fazën e konceptimit të projekteve,

21 FSHDPAK, 2006, 2007, 2008-2009. Zbatimi i planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara.

22 PROGRES RAPORTI 2009 PËR SHQIPËRINË, Bruksel (2009), Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2009-2010.

është edhe përmirësimi i procesit të edukimit të studentëve - arkitektë, urbanistë, konstruktorë e ndërtues të ardhshëm, duke pasuruar kurrikulat e tyre me njohuritë e domosdoshme për projektim universal. Është e nevojshme që strategjia e projektimit universal të futet njëkohësisht në kurrikulat dhe në metodat e mësimdhënies në fakultetet e arkitekturës. Është e nevojshme gjithashtu që t'i kthejmë çështjet e përshtatshmërisë nga pozicioni "shtojcë" i procesit të projektimit në pjesë integrale të tij<sup>23</sup>. Duhet vënë në dukje se ka përpjekje në këtë drejtim me nisma individuale nga rrethet akademike të fakulteteve përkatëse. Nuk ka studim në lidhje me rezultatet e këtyre përpjekjeve, por vëzhgimet dhe kontaktet e drejtpërdrejta me ta tregojnë se këto nisma janë të pamjaftueshme dhe asnjë nga fakultetet nuk ka një planifikim zyrtar që çështja e ndërtimeve pa barriera të jetë në vëmendjen e profesariatit dhe të ndërthuret në të gjithë hapësirën e mësimdhënies në fakultete.

**Sfida e së ardhmes : Nga projektim i përshtatur drejt projektimit universal**  
*Tashmë zhvillimet shoqërore po diktojnë kalimin nga projektimi i përshtatur drejt projektimit universal. Projektimi universal është i ndryshëm nga projektimi i përshtatur. Projektimi i përshtatur do të thotë që ndërtimet dhe pajisjet të jenë të përshtatshme dhe të përdorëshme nga personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa në projektimin universal ndërtimet dhe pajisjet e realizuara janë të përshtatshme dhe*

*të përdorëshme nga të gjithë, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Projektimi i përshtatur ofron zgjidhje për personat me aftësi të kufizuara, siç është për shëmbull vendosja e rampës anash shkallëve në hyrje. Projekti universal nga ana tjetër, ofron zgjidhje jo vetëm për personat me aftësi të kufizuara, por jep zgjidhje edhe për fëmijët, të moshuarit, mëngjarashët etj. Kjo do të thotë që një hyrje që është projektuar "universale" nuk duhet të ketë fare shkallë.*

Në fokus të projektimit universal nuk janë specifikisht personat me aftësi të kufizuara, por të gjithë njerëzit<sup>24</sup>.

Ndonëse projektimi i përshtatur siguron përgjigje për nevojat e personave me aftësi të kufizuara, projektimi universal integron akomodimin e aftësisë së kufizuar me konceptet bazë të projektimit<sup>25</sup>.

## **Cilët duhet të jenë hapat në vazhdim?**

Një rampë në hyrje të një objekti është e pamjaftueshme. Duhet që çdo hapësirë e brendshme dhe e jashtme, dhe të gjitha elementet në çdo objekt të jenë të përshtatura.

Kjo natyrisht kërkon shumë ndryshime në politika dhe zbatimin e tyre dhe kërkon partneritet të shumë aktorëve përgjegjës dhe përfitues.

Këto ndryshime duhet të përfshijnë:

- Një kuadër ligjor të plotësuar me akte nënligjore dhe me mekanizma të fortë detyrues.
- Struktura monitoruese që të kontrollojnë zbatimin e standardeve.

<sup>23</sup> Ostroff, E., Hunter D. (2003), *Social Justice in Architecture: Promoting Universal Design and Human Diversity in Architecture Education and Practice Through the Accreditation Process.*

<sup>24</sup> Mace R. L. (1998), *A Perspective on Universal Design.*

<sup>25</sup> Steinfeld E. (1994) **The Concept of Universal Design.**



- Buxhete të miratuara për të eliminuar barrierat e mjedisit.
- Plane konkrete dhe afate kohore të përcaktuara qartë.
- Trajnime dhe ritrajnime mbi projektimin universal dhe standardet e përshtatshmërisë për aktorët e përfshirë arkitektë, urbanistë, konstruktorë, ndërtues dhe autoritete lokale.

## Bibliografi:

- Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009. “Për Planifikimin e Territorit”.
- VKM Nr 1503, datë 19.11.2008 “Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.
- Raport i Grupit të Ekspertëve të Komisionit Europian, (2003). “2010:



*Elemente përshtatshmërie në Universitetin POLIS*

- Projektimi universal dhe standardet e përshtatshmërisë duhet të bëhen pjesë e kurrikulave zyrtare për fakultetet e arkitekturës, planifikimit urban, ndërtimit.
- Krijimi dhe ndërgjegjësimi të publikut si edhe e politikbërësve mbi rëndësinë e ndërtimeve pa barriera për të lehtësuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e komunitetit.

Tashmë që këto procese kanë nisur aftësia e kufizuar si çështje e të drejtave të njeriut duhet të vendoset në axhendën e të gjithë vendimmarrësve.

- Një Europë e përshtatur për të gjithë“.
- FSHDPAK (2009). Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara për vitet 2008 – 2009.
- [www.minfin.gov.al/.../MPCSSHB](http://www.minfin.gov.al/.../MPCSSHB); Raporti i monitorimit për 6-mujorin e parë të vitit 2009.
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994, i ndryshuar, “Për Statusin e Invalidit të Punës”; Ligji Nr.8098, datë 28.3.1996, i ndryshuar, “Për Statusin e të Verbërit”; Ligji Nr. 8626, datë 22.6.2000, i ndryshuar “ Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”.

- Vendim Nr.401, datë 25.6.2004. Paketa e Normave Urbanistike dhe Arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara.
- VKM nr.8 , dt. 25 janar 2005. Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara, www.mpcs.gov.al
- Rregullat Standarde të OKB për të drejtat e personave me aftësi të
- të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- FSHDPAK (1999)“ Probleme të përshtatshmërisë të mjedisit ndërtimor në Shqipëri “.
- Aliaj,B., Lulo K., Myftiu G. (2003), Tirana - Sfida e zhvillimit urban.
- Handicap International për Europën Juglindore ( 2006), “Lëvizja e lirë e



- kufizuara(1993).
- Ligji Nr.10 112, datë 9.4.2009 “ Për administrimin dhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit.
- Recommendation Rec(2006)5 of the Council of Europe to member states on the Council of Europe Action Plan to promote the rights and full participation of people with disabilities in society: improving the quality of life of people with disabilities in Europe 2006-2015, in action area no.6.
- Asambleja e Përgjithshme e OKB(2006), Konventa e OKB për
- PAK në Europën Juglindore : një e drejtë e paaksesueshme?”
- PROGRES RAPORTI i vitit 2009 PËR SHQIPËRINË, Bruksel (2009), Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore të viteve 2009-2010.
- Ostroff, E., Hunter D. (2003), Social Justice in Architecture: Promoting Universal Design and Human Diversity in Architecture Education and Practice through the Accreditation Process.
- Mace R. L.(1998), A Perspective on Universal Design.
- Steinfeld E. (1994), The Concept of Universal Design.



## Valentina Pistoli

### Arkitektja e parë shqiptare

Ky artikull është shkruar nga Sotir Dhamo mbi bazën e materialeve të vëna në dispozicion nga familja, AQTN, kolegë, si edhe artikuj të shkruar nga arkitektja dhe bashkëkohës të saj

Valentina ka projektuar mbi 160 objekte të shpërndara në 26 qytete të vendit për më se 32 vjet. Në listën e këtyre objekteve të bie në sy shumëllojshmëria tipologjike ku përfshihen kryesisht objekte social-kulturore si hotele, shkolla, spitale, ambulanca, qendra kulture, banesa etj. Përveç aftësive në matematikë e fizikë, që herët Valentina kishte shfaqur aftësi të mira edhe për vizatim. Për këtë arsye ajo vendosi të studionte për arkitekturë.

Valentina lindi në Korçë në vitin 1928. Arsimin e mesëm e kreu në Liceun e Korçës. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Sofjes në Bullgari ku u diplomua në Arkitekturë në vitin 1952<sup>1</sup>. Valentina është arkitektja e parë shqiptare. Aktiviteti krijues i Valentinës ka qenë i tillë, që edhe pse në presionin e kufizimeve ideologjike të kohës dhe “stuhisë” kundra “ndikimeve të huaja”, mundi të krijojë vlera profesionale që t’i rezistonin kohës. Valentina diti të gjejë rrugën e duhur për të krijuar një arkitekturë të pranueshme për regjimin dhe që njëkohësisht mbarthe



parimet moderniste të kohës. Disa nga komplekset e banimit të projektuara prej saj janë nga më interesantet për kohën, si kompleksi i banesave dhe PTT në Korçë, kompleksi i banesave në rrugën e Skelës në Vlorë etj. Hotelet ishin pa dyshim një nga arritjet më të mira të Valentinës ku kërkohej një shprehje arkitektonike më moderne.

Ja si e kujton arkitekti Pavllo Luarasi<sup>2</sup> Valentinën, me të cilën ka punuar për 12 vite. “Në projektim Valentina karakterizohej nga aftësia për të dhënë zgjidhje racionale dhe funksionale me linja të rregullta e të qeta të prirura nga modernia, për aq sa lejonin mundësitë e kohës. Kulmin e saj ajo e pati në projektimin dhe ndjekjen deri në detaje të zbatimit të Hotel “Tiranës”. Për këtë ajo vuri të gjitha forcat e saj, eksperiencën, dijet, pasionin, marrëdhëniet e sinqerta me grupin e punës për të realizuar godinën shumëkatëshe më të lartë në Shqipëri. Më kujtohen vizatimet dhe variantet e fasadave ... edhe ky variant që është sot

<sup>1</sup> Nderim veprës së tyre: album për disa nga emrat e shquar të inxhinierisë së ndërtimit; Botim i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit dhe Shoqatës së ndërtuesve të Shqipërisë; M Tollkuci, P Knuti, E Tundo; Tiranë, 2003.

<sup>2</sup> Kumtesë për jetën dhe veprimtarinë e Arkitektes Valentina Pistoli, qershor 1997, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit. Takimi i tretë: “Nderim figurave të shquara të inxhinierisë së ndërtimit”

i rikonstruktuar ishte një nga vizatimet e këtij hoteli”.

Hotelet në Elbasan, Kukës, Bajram Curri dhe sidomos Hotel “Tirana” në kryeqytet, Shtëpia e Kulturës në Pogradec, Kinoteatri në Durrës, Klubi i Marinarëve Durrës, tregojnë tendenca të qarta të një fryme më të re që po vinte në arkitekturën shqiptare të asaj kohe të influencuar nga arkitektura e periudhës së modernizmit, e cila prej kohësh ishte zhvilluar në vendet e tjera të rajonit. Kjo nuk ishte edhe kaq e lehtë në Shqipërinë e asaj kohe po të marrim parasysh faktin, që arkitektura sikurse edhe artet konsiderohej se duhej të bazohej në përmbajtje me principet komuniste dhe të diktohej nga parimet e realizimit socialist. Për Hotel “Tiranën”, që ka qenë ndërtesa më e lartë në Shqipëri deri në gjysmën e viteve '90, Valentina është nderuar me Çmimin e Republikës të shkallës së dytë.

Le të ndalemi pak më shumë tek ky projekt që jo vetëm ishte një nga më të rëndësishmit për Valentinën, por edhe një nga më të rëndësishmit për projektimin dhe realizimet arkitektonike të asaj periudhe, sikurse e dëshmon

edhe “Revista Ndërtuesi” e vitit 1985<sup>3</sup> në artikullin e shkruar për arkitekten me rastin e dhënies së Çmimit të Republikës. Atje faktohet se hotel “Tirana” është më i madhi në vend në tipologjinë e vet me një kapacitet 320 shtretër mjedise shoqërore për 1250 vende me shkallë komoditeti të lartë. Ky hotel konsiderohej si një detyrë e vështirë, ku duhej të harmonizoheshin një sërë problemesh të karakterit funksional, teknologjik, ekonomik, konstruktiv e të instalimeve, me çështjet e zgjidhjeve arkitekturore e artistike. Nga pikëpamja e llogaritjeve statike dhe e realizimit të këtij konstruksioni me kallëp inventari lëvizës, kjo godinë shënoi një hap përpara për shkencën tonë të konstruksioneve dhe për ndërtimin. Tek Hotel “Tirana” për herë të parë u aplikua në pjesën e bllokut shumëkatësh të fjetjes konstruksioni me parete betonarmeje mbrojtëse që zëvendësuan konstruksionin e kolonave dhe njëkohësisht kryejnë funksionin e mureve ndarëse të dhomave. Sikurse vazhdon më tej artikulli, në kontrast, por edhe në harmoni me horizontalitetin e vëllimeve të pallatit të Kulturës dhe të

<sup>3</sup> Ndërtuesi, *Organ i Ministrisë së Ndërtimit. Nr. 2, 1985.*

Muzeut Historik Kombëtar, hoteli ka theksim vertikal, që përshtatet mjaft mirë me funksionin e tij. Sikurse e dimë ky objekt ka qenë ndër elementet më të rëndësishme të ansamblit urbanistiko-arkitekturor të sheshit Skenderbej dhe ka qenë elementi vertikal, që jo vetëm dominonte siluetën e Tiranës, por që u kthye në një element të rëndësishëm identifikimi të banorëve të qytetit për një kohë të gjatë. Kështu, blloku vertikal prej 15 katesh nuk ishte brutal në prezencën e tij, pasi kjo balancohej me trajtimin lakonik dhe pa ngarkesa të tepërta të formës së tij të pastër ku lexoheshin me modesti brezat horizontalë të dritareve me gurë të bardhë të Karaburunit. Vlen të përmenden gjithashtu edhe interieret dhe në veçanti holli kryesor si elementi lidhës i të gjitha mjediseve shoqërore me lartësi dyfishë e me variacionin e gjallërinë që krijohet nga ballkonada që e qarkon.

Në vitin 1974 në artikullin “përmbi gjysma e popullsisë në banesa të reja<sup>4</sup>” arkitektja

<sup>4</sup> Revista “Shkenca dhe Jeta” nr. 3, 1974, *Revistë tekniko-shkencore.*





përshkruan përpjekjet e projektuesve të kohës për të përballuar kërkesën e lartë për strehim. Ajo shkruan se që nga fundi i luftës dhe deri në vitin 1972 ishin ndërtuar gjithsej 233 000 apartamente shtetërore dhe shtëpi të ndërtuara nga vetë njerëzit, ku u strehuan rreth 1 400 000 banorë që ishte pothuajse gjysma e popullsisë deri në atë kohë. Në këto përpjekje ku vetë arkitektja ishte pjesë, ajo thekson kujdesin e veçantë që ju kushtua zgjidhjes funksionale të

apartamenteve. Valentina projektoi në atë kohë kur mënyra e të banuarit në qytete e fshatra si edhe brenda apartamenteve po ndryshonte në mënyrë rrënjësore. Në kushtet e një ekonomie tejet të varfër në shkallë kombëtare, kur ajo flet për përpjekjet për rritjen e sipërfaqeve të banimit, tek i njëjti artikull shkruan: Janë bërë përpjekje për të dhënë zgjidhje sa ekonomike, aq edhe të mira duke peshuar me kujdes çdo metër e centimetër të sipërfaqes së



Hoteli në Kukës



Banesa në Vlorë





ndërtuar deri në detajet më të vogla. Kështu p.sh., vendin e kuzhinave të vogla të projektuara deri në vitet '60 me sipërfaqe 7-8 m<sup>2</sup> të destinuar vetëm për gatim, e zunë kuzhinat me sipërfaqe 12-14 m<sup>2</sup>, të cilat plotësonin më mirë funksionet e ndryshme të jetës familjare deri në atë kohe, që përfshinin gatimin, ngrënien, ndenjjen, studimin etj. Ndërsa më vonë futja e elementit të ri, aneksit të gatimit, i çliroi kuzhinat nga ky funksion, duke e kthyer kuzhinën në një

ambient më higjienik, më të kulturuar që ishte dhoma e ditës. Ky vëllim i madh i ndërtimeve, si edhe mungesa e kuadrove dhe materialeve, shkruan ajo, sollën nevojën e tipizimit të projekteve, përcaktimin e standardeve dhe ndërtimin në komplekse, gjëra me të cilat arkitektja nënkupton një proces më shkencor të projektimit. Kështu, në lidhje me projektet tip arkitektja Pistoli shprehet se kur ky proces nuk përdoret në mënyrë shabllone, por projektet përshtaten me



Komiteti Ekzekutiv në Librazhd



Hotel "Skampa" Elbasan



Kinema në Elbasan



Kopësht fëmijësh, Tiranë



Hotel "Skampa", Elbasan




ambientin dhe materialet rrethore, kur përpunohen si vëllime e trajtime të jashtme në përshtatje me vendin, ato mund të japin rezultate shumë të mira.


Valentina dha një kontribut të ndjeshëm edhe në fushën e edukimit,

duke punuar për një kohë të gjatë si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Degën e Arkitekturës. Ajo kontribuoi në mënyrë të veçantë në lëndët e kompozimit arkitektonik. Ja se si e kujton përsëri

Planimetria e katit përdhe, Hotel Tirana



Planimetria e katit përdhe, Hotel "Skampa", Elbasan



arkitekti Pavlo Luarasi<sup>5</sup>: së bashku konsultonim studentët e kursit të katërt të arkitekturës. Më çudiste durimi i saj. Gjithmonë konsultimet i mbaronte më vonë se të tjerët. Ajo kujdesej që studenti të përfitonte sa më shumë”.


Disa prej objekteve të tjera të projektuara nga Valentina janë: Godina banimi Cërrik, spitali Cërrik, Komiteti Ekzekutiv Cërrik, bllok banimi me dyqane Elbasan, hotel në Himarë, vila në Malin e Dajtit, godinë banimi Plazh Durrës, shtëpi pushimi Plazh Durrës, spitali i Elbasanit, godinë banimi me dyqane Korçë, konvikti i Teknikumit Bujqësor Peshkopi, Teknikumi Bujqësor Delvinë dhe Përrenjas, kinoteatër Krujë,

5 P. Luarasi. *Kumtesë për jetën dhe veprimtarinë e Arkitektes Valentina Pistoli, qershor 1997, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit. Takimi i tretë: “Nderim figurave të shquara të inxhinierisë së ndërtimit”.*

godina banimi Tiranë, shtëpi kulture teatër Durrës, komiteti i partisë Librazhd, kinema Elbasan, hotel në Pukë, Shkolla e Mesme Teknike Elbasan, hotel Bajram Curri, hoteli i ri Kukës etj.

Përpjekjet e këtij brezi arkitektësh për të arritur përsosmërinë funksionale edhe pse në kushtet e një ekonomie tejet të varfër, na kujtojnë përpjekjet e fazës së parë të arkitekteve moderniste për të krijuar “banesën minimale” si rezultat i kërkimeve shkencore dhe si përgjigje e kërkesave të kohës. Në konceptin teorik kjo banesë minimale nuk ishte banesa e mbijetesës, por një minimum standardi social, që mund të ofrohej i njëjtë për masën e gjerë të popullsisë. Referenca ndaj këtij koncepti sa shkencor, aq edhe me mision social është e qartë, pavarësisht pamundësisë për t’u deklaruar hapur për shkak të kufizimeve ideologjike të kohës.

Pamja nga lindja, Hotel “Skampa”, Elbasan





## 1.60 insurgent space - ditar pamor i Tiranës dhe hapësirave të saj intime

Një reflektim sesi mund të hyhet nëpër të çarat e arkitekturës - zhvillimit shoqëror, nëpërmjet artit dhe aftësia e tij sintetizuese.

Stefano Romano

1.60insurgent space is born from the idea of art as creation and spread of collaborative practices / in constant interaction with the urban space in which it is born and from which it is born / and because of this in possession of a "transient citizenship" from these places / collector of insurgent\*\* practices / destined to visualize/conceptualize an image and an "other" idea of art / exhibitions as signals for a new mental map of contemporary art / 1.60insurgent space is an open space enabling exhibitions in urban spaces, chosen through explorations in the city and realized each time with various collaborators. Exhibitions that question and are questioned on these urban spaces, "co-curated" every time by Stefano Romano and a different curator or artist.

Stefano Romano

\*Insurgent is not only the opposite, algebraically negative action, a mechanical upsetting that opposes and, at the same time, legitimates the existing social (and spatial) order. Actually, insurgent social practices result from positive collective intentions, planned, constructive: they transform antagonism into protagonism. These practices exist on another plane, on a thousand other planes, at times indifferent to the traditional world of the political fight and ideologies. "Apolitical" practices, often bad and illegitimate, in some manner, and, perhaps just for this, more effective politically. [Giancarlo Paba]


1.60 insurgent space lind nga ideja e artit si krijim e përhapje e praktikave bashkëpunuese / në ndërveprim të vazhdueshëm me hapësirën urbane, në të cilën lind e nga e cila lind / dhe për këtë e pajisur me "nënshtetësinë e përkohshme" të atyre vendeve / mbledhës i praktikave insurgent\* / të destinuara të vizualizojnë një imazh dhe një ide "tjetër" të artit / ekspozita si sinjale për një gjeografi të re mendore të artit bashkëkohor

1.60 insurgent space është një hapësirë për realizimin e ekspozitave në hapësirat urbane të zgjedhura çdo herë nga administratorë ose/ dhe nga vetë artistët. Ekspozita që pyesin dhe pyeten mbi hapësirat e gjetura. Çdo eveniment është i drejtuar nga Stefano Romano dhe nga kritikë të ndryshëm të ftuar nga muaji në muaj.

\* Sipas kuptimit që i dha Giancarlo Paba: Insurgent nuk është vetëm një veprim i kundërt, matematikisht negativ, përmbysje mekanike, që kundërshton e në të njëjtën kohë legjitimon rregullin shoqëror (dhe hapësinor) të vendosur.

Praktikat shoqërore insurgent janë në fakt rezultat i qëllimeve kolektive pozitive, të lindura nga projekte, konstruktive: ato transformojnë antagonizmin në protagonizëm. Ato janë praktika që qëndrojnë mbi një plan tjetër, mbi mijëra plane të tjera, ndonjëherë indiferente ndaj botës tradicionale të luftës politike dhe të ideologjive. Praktika "apolitike", shpesh të këqija e bastarde në njëfarë masë dhe ndoshta për këtë politikisht më efikase.

Kishte kaluar gati një vit që po je-toja në Tiranë, kur, duke parë realitetin lokal dhe duke reflektuar mbi sistemin e artit bashkëkohor ndërkombëtar, fillova të mendoj mbi një projekt artistik të aftë të vihej në marrëdhënie me hapësirën urbane. Një projekt i aftë të hynte nëpër të çarat e arkitekturës dhe urbanistikës, të historisë dhe shoqërisë shqiptare. Shqipëria, si një skenë e privilegjuar, nga e cila të mund të shihje botën dhe problematikën e saj, kaq të ndryshme dhe kaq të ngjashme, bija të atij shpirti të kohës për




të cilin fliste Kanti. Ideja ishte e thjeshtë dhe e përmbledhur, e drejtpëdrejtë, e ashpër dhe pa lajlelule, si lloji i artit që donte t'i transmetonte publikut: ekspozitat dhe eventet duhet të pronësonin një hapësirë dialogu me qytetin dhe njerëzit që e jetonin atë. Lindte kështu 1.60 insurgent space.

1.60 është koha që përdor normalisht aparati fotografik kur përdoret blic. Një e gjashtëdhjeta e sekondës, një kohë shumë e shkurtër, por e aftë për të na dhënë një imazh të realitetit. E njëjta shpëjtësi që kisha ndër mend për ekspozitat që doja të realizoja, të cilat pavarësisht nga projekti i propozuar nga artisti, duhet të zgjasnin patjetër vetëm një ditë. Zgjedhja nuk ishte një ndëshkim ndaj publikut, por një tentativë për të jetuar në një pikëvështrim tjetër një hapësirë, të cilën njerëzit e përdorin normalisht për të bërë pazarin apo për të shëtitur, duke i dhënë një fuqi të re, të papritur, që vetëm arti me sintezën për të cilën shquhet mund të krijojë. Artistët, ndërkombëtarë dhe lokalë, duhet

të mateshin me hapësirat publike urbane dhe/ose private të Tiranës, duke realizuar vepra "site specific". Numri i ekspozitave ishte 3-4 në muaj, çdo herë në një vend dhe me një artist të ndryshëm. 1.60 insurgent space nuk kishte një qendër, një vend ku mund të ekspozonte e ku artistët mund të punonin, apo një zyrë. Zyra jonë ishin lokalet e Tiranës, studioja jonë ishte kudo ku mund të gjenim hapësirë të mjaftueshme për të ndërtuar atë që na nevojitej për ekspozitën. Qyteti ishte një lloj kantieri për ne dhe artistët e ftuar, ekspozitat shfaqeshin e zhdukeshin së bashku me ne nëpër qytet. Mua me pëlqen t'i quaj disa "rave party" të artit, të organizuara dhe komunikuara përmes një tam-tami zërash, ftesash, sms-ve dhe email-ve. Në fund të mbrëmjes, ekspozita dhe i gjithë organizimi zhdukeshin, për t'u rishfaqur në një vend tjetër, në një moment tjetër, me një projekt tjetër.

Ekspozita e parë i përket janarit të vitit 2005, ndërsa e fundit shtatorit të vitit 2006. Në këta 20 muaj janë realizuar



Stefano Romano (Naples, Italy 1975) is an artist and an independent curator. He is a lecturer in the Architecture and Art Department at Polis University in Tirana. Between January 2005 and September 2006 he ran the curatorial project, 1.60 insurgent space in Tirana (Albania). In 2006 he co-founded and co-directed T.I.C.A. (Tirana Institute of Contemporary Art). In 2008 he realized the project GUNS, which was a reflection on the art system. He took part in various solo and collective exhibitions in Italy and abroad. The idea of system and identity, their inherent contradictions and issues, are the main focuses of his work which he develops often involving other people. Performances, installations, videos are used by the artist as recording tools of our society's devices and always through an ironical point of view.

He participated in solo exhibitions, amongst others: 2011- would you stay a little longer? / a do tërrihedhepak? ,zeta gallery, Tirana Albania, 2010- Stuck in a paradox, I start to shave myself, GHAN contemporary art gallery, Genova Italy, 2009 - Tremilaseicentocinquantagiornunialinea, careof, Milano Italy, curated by Chiara Agnello e Alessandra Pioselli, 2008- Segmenti.1 - 220, Placentia Arte gallery, Piacenza Italy, etc.

He also participated in collective exhibitions amongst others. - 54° Venice Biennale |Academy Pavillion, Arsenale, Tese di San Cristoforo, Venice, Italy; 2010- What's about Italy, in the frame of forwardlooking, Macro Future, Roma Italy, curated by Francesca Sandrini; 2009- 4 ways to, Zenit gallery, Tirana Albania, satellite event of TICAB (Tirana International Contemporary Art Biannual)2008- Soft Cell. dinamichenellospazio in Italia; 2007- In Contemporaneanumerouno, Triennale |Gadorna, Milano Italy, curated by ViaFarini; 2006- Traveling light, Ghelsea Art Museum, New York, USA, curated by Julia Draganovic 2005- Tirana Biennale3, international biennial of contemporary art, Goldi complex, Tirana Albania, curated by Roberto Pinto, etc.



49 ekzpozita të ndryshme, të cilat kanë përfshirë 60 artistë e administratorë të ndryshëm.

Projekti filloi pa asnjë buxhet. Së bashku me bashkëpunëtorët e projektit (të cilët punonin falë entuziazmit ndaj projektit dhe jo për paratë që nuk ekzistonin) kemi bredhur nëpër të tëra bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe tek gjithsecili që mund të na ndihmonte për të siguruar fonde për realizimin e ekspozitave, me rezultate jo gjithmonë pozitive madje edhe kur ishin të tilla jo gjithmonë arrinin të

Suedi, që nga Spanja e deri në SHBA. Edhe në Shqipëri mediat na ndoqën me vëmendje. U bënë reportazhe në lidhje me ekspozitat, ftesa për të shkuar në emisione të ndryshme kulturore, artikuj e ko-pertina. Ishte krijuar një publik i përbërë nga njerëz që na ndiqnin në zhvendosjet tona brenda qytetit dhe një publik "lokal" njerëzish që jetonin në vendin ku bëhej ekspozita e radhës dhe që rastësisht gjendej në ekspozitë, diçka e veçantë që vetëm hapësira publike mund t'ia dhurojë artit.

Në këtë pjesë dua të ndalem në disa



mbulonin 100% të ekspozitës. Pjesa më e madhe e artistëve dhe kuratorëve të ftuar nga janari e deri në tetor të vitit 2005 i kanë paguar vetë shpenzimet që kërkonin vepra që donin të realizonin. Më pas ndodhi diçka tjetër në mënyrë krejt të papritur: European Cultural Foundation vendosi të mbështeste ekonomikisht 1.60 insurgent space. Një mbështetje thelbësore pasi i dha një gjallëri dhe një entuziazëm të ri vazhdimësisë së projektit.

Impakti i 1.60 insurgent space që i tillë sa menjëherë të gjithë filluan të flisnin për të e kudo arrinin zëra. U realizuan shumë konferenca ku u ftuam të flisnim për projektin, që nga Kosova e deri në

nga veprat që ndoshta paraqesin më së miri shpirtin e 1.60 insurgent space, atë aftësi analize të hapësirës që nuk ndalon vetëm në të dhënë lokale, por që duke u nisur nga ajo, arrin të formalizohet në një punë ku reflektohet globalisht.

**Insurgent space 0105 [artistët e ftuar: Tatiana | Unz - Sislej Xhafa kurator: Edi Muka]**

Në janar të vitit 2005, përpara serisë së ekspozitave të projektit, Sislej Xhafa realizoi një projekt - workshop, ku artisti përfshiu disa studentë të Akademisë së Arteve të Bukura të Tiranës në një seri aksionesh në hapësirat publike. Aksioni i parë, i komunikuar edhe mediave lokale,

ishite një diskutim mbi temat qendrore të artit bashkëkohor i bërë në një autobus të linjës Kombinat – Kinostudio, gjatë të cilit Xhafa u kërkoi studentëve të vizatonin në mënyrë të shpejtë gjërat që për ta ishin më interesante. Disa studentë vizatuan portretet e personave që kishin përkrah, disa të tjerë vizatuan peisazhin që shihnin jashtë dritares, disa realizuan vizatime në bashkëpunim me personin përkrah. Pati dhe njerëz që kërkuan edhe ata një fletë për të vizatuar. E gjitha kjo ndodhi ndërkohë që artisti u shpjegonte të tërëve

disa nga problematikat e krijimtarisë artistike bashkëkohore. U krijua shumë çudi brenda e jashtë autobusit, me gazetarët që donin të hipnin në stacione për të xhiruar situatën. Një tjetër aksion i lajmëruar që krijoi po aq çudi ishte ajo e realizuar tek Tregu Industrial Lahi, më mirë i njohur si Tregu i Madh, ku Sislej Xhafa përdori të njëjtën teknikë, duke u kërkuar studentëve të skiconin në mënyrë të shpejtë situatat më interesante që gjenin duke shëtitur nëpër korridoret e Tregut. Pati dhe një moment ku kërcyen të gjithë




dëshirën për t'i realizuar këto projekte me çdo kusht. Kjo diçka ishte mundësia, mundësia që 1.60 insurgent space na jepte për t'i bërë vetes pyetjen "pse jo?". Përse të mos provonim për ta parë qytetin, arkitekturën, njerëzit që e jetojnë, kontradiktat e tij, në një mënyrë ndryshe? Përse të mos provonim të hynim në një hapësirë të dedikuar artit, arkitekturës, urbanistikës, shoqërores nga një tjetër pikëpamje, duke i shtuar domethënie të tjera gjërave dhe vendeve të menduara për të tjera qëllime.

Kjo ishte fuqia e projektit, ja pse edhe sot e kësaj dite, ndonjë që ka qenë pjesë e publikut rastësor i disa prej atyre

bashkë përpara një tezge ku shiteshin kasetta, nën tingujt e këngës së vënë nga tregtari, duke përfshirë edhe njerëzit që ishin aty duke bërë pazar.

Një tjetër ekspozitë tek e cila dua të ndalem është: **urban connections 0305** [aristët e ftuar: **Elda Gjokondi – Enisa Cenaliaj – Ilir Dupi** kurator: **Stefano Romano**]

E realizuar në mars të vitit 2005, në ekspozitën e dytë të atij muaji, Enisa Cenaliaj realizoi "untitled", një performancë në sheshin përpara ish-Kombinatit të Tekstileve Stalin. Artistja, e veshur me uniformën tipike të punëtores dhe tërësisht e lyer me të bardhë, hipi mbi bazamentin





# Arti në Hapësirat Publike

në të cilin dikur ishte statuja e Stalinit, duke marrë një pozicion krenar prej fitimtari, siç ishte në traditën e artit socialist, e projektuar drejt një të ardhmeje që sot na duket e shkretë dhe e dështuar. Artistja qëndroi kështu për 40 minuta gjatë orarit

sorizuar nga asnjë]

Kjo eskpozitë, realizuar në mars të vitit 2006, ishte një aksion i shpejtë dhe sintetik, që nisej nga një nevojë reale e njerëzve që jetojnë në Tiranë. Bashkia e Tiranës kishte realizuar prej pak kohësh



të daljes së punëtorëve nga fabrika. Aksioni, normalisht, gjeneroi konfuzion tek njerëzit, të cilët nuk dinin si të reagonin ndaj asaj që ngjante si një provokim, por dukshëm jo drejt tyre. Projekti ishte kompletuar nga një banderolë që ishte varur tek hyrja e kompleksit, tek e cila ishte shkruar shprehja: Mirësevini punëtorë të dashur! Projekti ishte një reflektim mbi përdorimin e monumentit si instrument fuqie dhe afirmimit të saj, por edhe një reflektim ironik mbi klasën punëtore dhe heronjtë e saj.

Ekspozita e tretë të e cila do të ndalem është: **ank 0306 [artistët e ftuar: ank aksionet e të cilave nuk janë të spon-**

një ndarës të gjatë të trafikut, që ndan ende sot dy korsitë e rrugës përgjatë Tiranës së Re. Një ndarje shumë e këndshme estetikisht, e mbuluar me bimë dekorative, por fatkeqësisht pa asnjë ndarje, pra pa asnjë mundësi për të kaluar në të gjithë gjatësinë e saj. Dikush kishte menduar të hapte një kalim për të gjithë ata që u duhej të kalonin dhe natën kishte prerë një pjesë të betonit dhe gjetheve të ndarëses së rrugës, duke hapur kështu një kalim midis të dyja korsive. Artistët e Ank nuk bënë gjë tjetër, veçse e legjitimuan këtë gjest, duke i pikturuar disa vija të bardha për këmbësorët. Vijat e bardha u realizuan në mënyrë abuzive, gjatë natës

dhe vetëm në mëngjes u komunikua ky aksion.

E katërta dhe e fundit ekspozitë që dua të thellohem në këtë tekst është: **next text 0806** [artist i ftuar: **Verica Kovacevska** drejtuar nga: **Stefano Romano**]

cili mund të ndiqte zhvendosjen e artistes në një hartë të Tiranës që ndodhej në ekranin e një kompiuteri. Performanca ishte një reflektim mbi konceptin e lirisë së kontrolluar gjithnjë nga institucionet, nga teknologjia dhe nga faktorë të tjerë.



Ekpozita është realizuar në gusht të vitit 2006. Performuesja zbriti tek stacioni i Trenit në Tiranë, ku e priste një asistent i projektit, i cili i dha një sim card me numër shqiptar. Ai numër shërbente për personat që donin të bashkëvepronin me artistin për t'i dërguar një nga këto udhëzime: përpara, mbrapa, djathtas ose majtas, të cilave artistja u bindej me përpikmëri. Sapo vinte një sms me një nga drejtimet, ajo fillonte te ecte nëpër qytet sipas atij drejtimi deri në arritjen e një sms tjetër me indikimin e një tjetër drejtimi, duke hetuar kështu qytetin nën një lloj arratisjeje me origjinë surrealistë, por absolutisht të kontrolluar nga publiku, i

Performuesja ishte në fakt një kukull në duart e audiencës dhe hetimi i saj mbi qytetin ishte i udhëhequr nga dikush tjetër, duke na bërë të reflektojmë mbi mekanizmat e kontrollit.


Vendosa të flisja për këto katër vepra, jo sepse kanë më shumë vlerë në krahasim me të tjerat që janë realizuar gjatë 1.60 insurgent space, por thjesht për arsye se në mënyra të ndryshme mishërojnë ndjenjën e kuriozitetit dhe të reflektimit të hapësirës publike dhe sociale, që edhe vetë projekti i përmbante.

Kishte diçka në ata 20 muaj, diçka që lidhi si me një fill të kuq të tëra projektet, diçka që udhëhoqi entuziazmin tonë dhe





# Arti në Hapësirat Publike





ekspozitave, kujtohet sesi koka e një dhie, e shoqëruar nga zëri i një qeni që lehte, lundronte mbi një kuti të zezë në ujërat e Lanës, apo sesi një vajzë tërësisht e veshur si një punëtore dhe e pikturuar me të bardhë, rrinte krenare mbi bazamentin që kishte qenë i statujës së Stalinit në sheshin e Kombinatit të Tekstileve. Apo sesi një grup njerëzish vraponin nëpër trotualet e ish- Bllokut, veshur me një bluzë të bardhë në një garë pa fitimtarë. Kjo, besoj, është gjëja më e rëndësishme që një projekt si 1.60insurgent space mund t'i lërë kujtimeve të ardhshme, mundësia për të bashkëvepruar me hapësirën publike dhe me njerëzit që e jetojnë duke u nisur nga poshtë, nga ato kontradikta të pazgjidhura, që normalisht kush vendos i lë të zbuluara dhe që janë buka e reflektimeve të artistëve dhe botës së tyre.

Për të ditur më shumë rreth projektit dhe të gjitha ekspozitave: [www.1-60insurgentspace.org](http://www.1-60insurgentspace.org)





## SAW - Java Ndërkombëtare e Arkitekturës në Shkup

### Pas përqasjes me "Bigness" ... titujt nuk vlejnë më

Eranda Janku, Mamica Burda, Elios Kovaçi



Ky workshop është zhvilluar ne kuadër të Javës së Arkitekturës në Shkup 1-6 Qershor 2011 që është një kërkim urban ndërkombetar që e trajton arkitekturën si një çështje publike. Ai e trajton qytetin si një laborator eksperimentimesh, idesh dhe veprimesh provokuese, duke lejuar të gjitha teknikat e mundshme të punës dhe me synimin për të pasur rezultate të paparashikueshme, duke mbledhur studentë nga gjashtë qytete të rajonit-Shkup, Boegrad, Tiranë, Prishtinë, Sofje, Firenze dhe Selanik, për shkëmbimin e koncepteve, ideve dhe metodologjive të ndryshme të punës. Ai u zhvillua nën drejtimin e Prof. Martin Gulevskit prej UACS ( Shkolla e Arkitekturës dhe Dizajnit në Shkup) dhe Jovan Jovanovskit, As.Prof në Fakultetin e Arkitekturës në UKIM, Shkup.

Duke ëndërruar për kuptimin e "SUPER QYTETIT" të sotëm,

bëjmë shumë pyetje rreth madhësisë, të cilat u përpunuan në "Laboratorin eksperimental" të Shkupit si një përgjigje ndaj çështjeve urgjente sociale të një gjendjeje urbane të caktuar.


Zakonisht termi SUPER CITY përdoret gjerësisht kur flitet për një aglomerim të gjerë urban që popullohet nga miliona njerëz, impakti ekonomik, social e kulturor i të cilëve është domethënës deri edhe në shkallë globale.

Pas tërmetit të vitit 1964, për Shkupin është shkruar një histori e re që përshkruan profesionalisht lëvizjen moderniste të arkitekturës dhe të planifikimit. Një veprim që i solli identitet qytetit të gjunjëzuar, por që në ditët e sotme si histori e harruar meriton të përmendet sërish me vërtetësi. Një temë e tillë zgjidhet të trajtohet në një qytet arenë të kohëve, një qytet paradigmë, ku kompleksiteti tashmë është kthyer në



UTOPIA PËRSËRI...

**SKOPJE**  
architecture  
**WEEK**





# Workshope Ndërkombëtare



*Pamje panoramike e Shkupit*

bën që këto dy fusha të gufojnë pas ritmeve entuziaste pa qenë në hapin e shoqërisë. I vetmi rast, në të cilin fluturimi është paralel ndodh në projektet utopike, që propozojnë skenarë të guximshëm teknologjikë, por edhe njerëzorë ku thelbi është revolucioni. Shpeshherë dëgjojmë të akuzohen tentativat e realizimit të utopive për dështim. Në fakt, utopia është maksimalisht e realizuar në momentin që provokimi dhe vizioni arrijnë pikun- sepse ato propozojnë tendecat e së ardhmes. S'mund të presim më shumë prej tyre. Ato në thelb lëvizin me shpejtësinë e dritës.

*Pamje nga zona e projektit: konviktet, Shkup*

Edhe workshopi i Shkupit synoi të hulumtojë propozime të guximshme, duke stimuluar

paparashikueshmërinë me anë të një përzierjeje interesante studentësh, fakultetesh, vendesh, mentalitetesh, metodologjish pune të ndryshme. A nuk është ky hibridizim një MINI SUPER SHOQËRI... një premisë e mirë për një superqytet?!

## « BIGNESS » - NE NUK MUND TË KTHEHEMI PASI!

Workshopi trajtonte “në terma arkitekturore” pashmangshmërinë ndaj “madhësisë”, si dhe raportin që ky fenomen has kur përballet me mundësitë tona për të bashkëvepruar me të. Sikurse thuhet në “SMLXL”(1995), “Qytetet bëhen gjithmonë e më të mëdha dhe më

të uritura për terren, sistemi i transportit bëhet më i gjerë, korporatat duhet të bëhen





gjithmonë e më të mëdha, në mënyrë që të mund të konkurrojnë me një shpresë për sukses në tregun global. Një kthim prapa në shoqëritë e kohës paraindustriale do të zhyste popullsinë e botës në varfëri dhe ndoshta dhuna, uria, semundjet dhe intoleranca do të rriteshin. **NE NUK MUND TË KTHEHEMI PAS.**

Teori të trajtuara nga Rem Koolhaas, Bruce Mau, Jennifer Sigler, Hans Werlemann shërbyen si një udhëzues gjatë eksperiencës kërkimore, secilit prej 6 grupeve iu kërkua të lexonte këtë material dhe njohja mes studentëve dhe profesorëve u bë pikërisht gjatë një diskutimi të hapur në lidhje me reflektimin, reaksionin mbi bazën teorike dhe ngacmimet e para lidhur me “bigness-in”. Frazat kyçe të sternëvizuara e damkuese ishin: 1- (....) BIGNESS – stimulon regjimin kompleks që mobilizon inteligjencën e plotë të arkitekturës dhe fushave të tjera të lidhura me të... ka potencial për një maksimum mundësish. 2-(....)Përtej një mase kritike të caktuar, një ndërtesë kthehet në “BIGNESS” dhe s’mund të kontrollohet me nga një gjest apo kombinim gjestesh të

arkitekturës.3-(....)-Arti i arkitekturës është i pavlerë në “BIGNESS”. Në “BIGNESS” distanca ndërmjet bërthamës dhe veshjes rritet deri në pikën ku fasada nuk tregon më atë që ndodh brenda.4-(....)“BIGNESS” çorienton, ngre dyshime, transformon qytetin në një shumësi misteresh.5-(....)“B”- nuk e përfill kontekstin dhe konkurren qytetin; është një vegël e modernitetit.6-(....)“B”- ndodhet atje ku arkitektura arrin njëkohësisht pikun më të lartë dhe më të ulët arkitekturor.

Sigurisht, nisur edhe nga kjo bazë teorike provokuese, udhëzimet konsistojnë në prezantimin e një përjasjeje të guximshme, artistike, vizionare, dhe natyrisht provokuese. Kur tema që propozohet është “superqyteti” automatikisht aktivizohet një mekanizëm i çuditshëm edhe në të menduar apo në të shprehur- që të kujton “parole in libertá”- të F.T.Marinetit... ku ekzistenca e njëkohshme e shumë fjalëve në ajër dhe bashkëveprimet ndërmjet tyre sjell procese të pakontrolluara dhe shumëllojshmëri mundësish vibruese – natyrisht pavarësisht përçarjeve apo entuziazmit të komunikimit në grup –





**SUSPENCITY** : (adj.) suspended city

The project attempts to redefine a number of terms connected to the city's history, such as centrality, community or even urban development. The "Suspencity", as a new landmark, introduces the "super-city's" model as an alternative way of living. By defining the starting points of this super-structure, it rises and spreads up like a cloud, providing visibility, flexibility of uses, a network of public spaces and a whole new experience of urban living.




city






's level



"super city's" level







*SUSPENCITY* fiton racionalizmi i ideve dhe ndjesive në sintaksën, me të cilën komunikojmë çdo ditë. Kjo nuk mohon faktin, që për një moment të mrekullueshem në ajër gëlojnë vizione dhe utopi marramendese apo shumë pikëpyetje.

## **BIGNESS-i njerëzor**

Esenca teorike u përpunua si menyrë për të pasur një përjasje ndaj madhësisë në një menyrë të pazakontë dhe si nje forcë formëkrijuese, formëfshehëse e formëkontrolluese. I gjithë procesi u sintetizua në një masë "Big", e cila fragmentizohej duke marrë kështu një masë të përbërë nga elemente, të cilat i japin shkallën njerëzore masës së përgjithshme. Të gjitha këto ide u konkretizuan në shumë

modele/makete konceptuale ( si mjeti kryesor i punës), të cilat shprehnin idenë e madhësisë në mënyra të ndryshme. Secili maket konceptual interpretoi qytetin e Shkupit nëpërmjet gjuhës së arkitekturës, duke u përpjekur të përkthejë tendencat e sotme të shoqërisë apo të udhëheqë drejt një lëvizjeje radikale që ndryshon thelbin e saj.

## **"OFIÇINA" NJERËZORE**

Një nga shpjegimet e termit workshop - është fjala "OFIÇINË". Në fakt për intensitetin e punës, të metodave spartane, efikase dhe artizanale, apo edhe atmosferës, kjo eksperiecë do ta meritonte një shprehje të tillë. Një OFIÇINË NJERËZORE.

A do të duhej të ndiqnim teorinë se "bigness-i" është një kontekst më vete dhe



nuk e përfill qytetin apo do të duhej ta trajtonim porpozimin tonë si mekanizmin filtrues shoqëror, formal e programatik të copëzave rrethuese?!

Në kuadër të këtij workshopi u krijuan 6 grupe pune (6-7 studente nga vende të ndryshme) për 6 projektide. Ky bashkëveprim ishte një eksperiencë e pakrahasueshme, pikërisht një OFIÇINË NJERËZORE. 38 studentë e gjetën veten mes të të shprehurit në gjuhën e asnjërit, por të të gjithëve, mes përplasjes së ideve dhe këmbënguljes për të gjetur gjetet e duhura gjuhësore dhe arkitektonike, orëve të gjata, kontradiktave, por mbi të gjitha, mes një hibridizimi të mrekullueshëm kulturash ku si përfundim humori i mirë, buzëqeshjet, dëshira për

komunikim janë një gjuhë e përbashkët pavarësisht kombësisë. Gjatë gjithë kohës ndiqeshin leksionet, filmat, prezantimet dhe bashkëbisedimet e mbrëmjes që zhvilloheshin paralelisht.

### **JAVA E WORKSHOPIT "SUPER-CITY-ACTION"!**

Dita I-rë.-31.05.2011

18.10- Mbërritja në Shkup

18.13- 19.00-Endje nëpër qytet për të gjetur strehimin. Verifikim i faktit që shprehja: " Kush pyet gjen Stambollin"- nuk është gjithmonë e goditur!

20.15- Drejtimi për te Dom na Armas ( Shtëpia e Ushtrisë)-pikëtakimi ndërmjet pjesëmarrësve dhe organizatorëve. Vendi ku do të zhvillohej workshopi.





20.30-Pajisja me logot përkatëse, kartat personale dhe udhëzimet për ditën pasuese.

21.30- Një grup i MADH prej 38 vetash, për një mision të përbashket. Njohja me kolegët nga Greqia, Italia, Bullgaria, Serbia, Kosova, Maqedonia. Bashkëveprim dhe njohje;pa ndarje grupesh për një integrim më të mirë. Fillon ndërgjegjesimi për njërin aspekt të fjalës Big- BIGNESS.

22.00 - BIRRË!

Dita II-të. 1.06.2011

9.00- "Study-tour" në qendrën e Shkupit.

9.30- Shkupi dhe historiku i tij nga kodrat rrethuese. Nga qyteti i hershëm brenda mureve rrethuese; shtrirja e mëvonshme përtej këtyre mureve; tërmeti i viteve '60; Koncepti urban dhe arkitektonik i Kenzo Tanges; shtrirja lineare e qytetit, dhe risitë e mëvona; projekti Shkup 2014, që shkakton transformime konceptuale: Shkupi nga qyteti modernist në "qytetin neobarok"

11.00 - Vizitë në zonën e ndërhyrjes.

11.00- Caktimi i grupeve të punës me 6-7 pjesëmarrës nga vende të ndryshme.

12.00- Prezantimi i prof. Besnik Aliajt dhe i prof. Sotir Dhamos.

13.00- Diskutimi rreth konceptit "Bignessit", reagimet dhe përjasjet e para.

18.00 - Prezantimi paraprak i idesë udhëheqëse të projektit.

21.00 - Shkëputje nga bigness-i, FOOD- TALKING & TALK- FEEDING!

Dita III-të. 2.06.2011

9.00- Puna sipas grupeve vazhdon ...

13.00 - Prezantimi i një maketi konceptual dhe diskutim i përbashkët.

20.00 Seancë "NIGHT TALKS" prof. Besnik Aliaj.

21.00 - Mbyllja e ditës së punës;

## **BIRRA! IGLO-PARTY dhe "after party".**

Dita IV- të -3.06.2011

Puna hyn në rrjedhën normale: "ankthe dhe kënaqësi të herëpashershme".

Dita V-të. 4.06.2011.

9.00 - Faza përfundimtare e realizimit të maketit dhe posterit përfundimtar.

22.30 deri ... - Përfundim-fillimi i "ditënatës" së punës.

Dita VI-të - 5.06.2011

9.00 - STRESI i paraqitjes së punëve.

17.00 - Dorëzimi i materialit- përgatitja e IGLOS- për prezantim.

18.00 - Grupet fillojnë të paraqesin punën në prezantim publik të hapur ... duartrokitje dhe mirënjohje.

21.00 - Shkëmbim i kontakteve dhe i mendimeve mbi eksperiencën (nën shi).

21.30 - LOS AMIGOS con tequila sunrise!

12.00 - Ditëlindja e Eliosit...(shumë urime për ty! Shumë urime për ty! Shumë urime për Elios-in).

12.30 - PARTY SECTION!

Dita VII-të 6.06.2011


8.08 - Nisja për Tiranë nga Rruga e Dibrës së Madhe.

13.04 - Tek "TETOJA"; dreka dhe diskutime profesionale në natyrë dhe në makinë ... midis utopisë dhe realitetit).

17.24 - Mbërritja në Tiranë.

Orë e pa orë - Ndjekja e prezantimeve të javës së arkitekturës në Shkup ndër të cilët: Alfred Jacoby (De-Dessau), 3+1 architects (Estonia), Salto Architectural Office (Estonia), G Paçarizi (Kosovë), Thomas Doxiadis (Greece), Ljubo Georgiev (Bulgaria), OIIO Architecture Office (Greece), Sadar+Vuga (Slovenia), Minas Bakalcev (Macedonia), Georgi





Katov (Bulgaria), Lulzim Kabashi+ Krunoslav Ivanisin (Croatia), Dekleva Gregoric Architecti (Slovenia), Aristide Antonas (Greece), Huus og Heim (Norëay), 3RW Archiotects (NorWay), Spora Architects (Hungaria), Anne Holtrop (The Netherlands) etj.

## **SUPER ZONA**

Në pjesën lindore të Shkupit, shtrihet zona industriale, që të infektojnë qytetin me karakterin e tyre parazitarr. Qyteti dallohet për një shumëllojshmëri trajtimesh brenda tij. Zona mbi të cilën do të punonim, nuk ishte as më pak, e as më shumë, se sa një copëz nga ky mozaik i përbërë. Në krah të zonës industriale shtrihet kampusi i godinave në shërbim të ambienteve universitare si fjetore, pra apartamente dhe dyqane të ndryshme. Në anën veriore, zona jonë kufizohet nga një lagje e tërë me banesa të reja private. Tipi amerikan i të trajtuarit të ndërhyrjeve në këtë zonë, është mjaft i dallueshëm. Shtëpi të vogla

private, shumica e të cilave prej druri; me kopshte përreth tyre; gardhe rrethuese madje disa prej tyre kanë edhe pishina. Nëse në pjesën më të madhe të Shkupit të trembin hapësirat gjigante, ku hapësira publike zë pothuajse të njëjtën sipërfaqe sa ajo e ndertuar; në këtë pjesë të qytetit kemi një trajtë tërësisht të ndryshme urbane. Shtëpitë private janë të vendosura pranë, duke e bërë të vështirë dallimin e kufijve, kështu imazhi që ofrohet sjell ndërmend tablonë e pikselave të një imazhi...pjesa e fundme kufizuese e zonës sonë, ishte një hapësirë e gjelbër gjatësore, që shërben si ndarëse mes pjesës tjetër të ndërtuar të qytetit.


Këto janë “copëzat” sa të ndryshme aq dhe të ngjashme, mbi të cilat do të punonim.

## **PROPOZIMET**

Të 6-të konceptet që u prezantuan nga secili grup pune, ishin sa të veçanta, aq dhe të ngjashme me njera-tjetrën. Të ngjashme

sepse po punonim mbi të njëjten zonë, dhe sinjalet fillestare që kjo zonë na dha, ishin të njëjta, dhe frymëzimet tona thuajse ishin të orientuara në të njëjtin drejtim. Por kjo nuk zgjati shume. Asistua në një shpërthim të mirëfilltë propozimesh, ku ndjekja e prezantimeve dhe e proceseve të grupeve të tjera, kritikave dhe diskutimet ishin leksione praktike të përditshme. Por sërish, elementi i fortë që na lidhte të tërëve, ishte karakteri UTOPIK i trajtimit të projekteve tona, që përbënte për ne një risi, të pëksperimentuar më parë.

**417 M-** Puna në grupin ku unë bëja pjesë, u bazua në një sërë analizash që ne vendosëm t'i bënim zoneë dhe objekteve që ndodheshin në të. E dinim që do ishte përpjekja jonë për ta njohur më mirë këtë zonë dhe karakterin e saj, që do të na orientonte drejt një koncepti, mbi të cilin do të bazonim punën tonë. Nisëm të bënim një lexim të thjeshtë të tërë zonës, ku në sy vazhdimisht na binte loja e boshit-meplotin, dhe trajtës kuadratike të trajtimit të çdolloj ndërhyrjeje në vend. U bazuam tek korpusi universitar i apartamenteve dhe dyqaneve. Katër nuklet kryesore që përbënin atë, kishin një lojë shumë interesante, sipas së cilës silleshin perreth tyre. Përmes lidhjeve që secila godinë kishte me tjetrën, përmes korridoreve të brendshme, ato formonin në mes tyre një kuadrat të rregullt, i cili dominonte në planin përkatës që ne skicuam. Të njëjtën formë, të së njëjtës madhësi, më të vogël, apo më të madhe, ne e hasëm edhe më tej në të tërë zonën. Ndaj nisur nga kjo formë që vazhdonte në mënyre të vazhduar të përsëritej sikur të ishte një element me karakter të fortë për tërë zonën, në arritëm






# Workshope Ndërkombëtare

tek koncepti i një nukliosë i një njësie bazë, që përsëritej, shumëfishohej / apo dhe ndahej në njësi më të vogla, për të krijuar një rrjet strukturash të vazhdueshme në të tërë zonën. Arritëm të përgatisnim formën e kësaj njësie bazë, duke krijuar struktura mjaft interesante, që përshkonin tërë zonën, për të formuar një mozaik formash me karakter të njëjtë, por me identitet të ndryshëm, që varej nga mënyra e përdorimit, apo funksioni që do t'i jepnim. Me anën e kësaj njësie bazë dhe formave komplekse që pasonin atë, depërtuam nëntokë- u ngritëm në lartësi dhe gjithashtu gjarpëruam mbi tokë për të dizenuar forma të ndryshme strukturash.

Në

këtë mënyrë krijuam një tërësi ambientesh dhe hapësirash, të cilat i përdorëm për arsye nga më të ndryshmet dhe për forma nga më të ndryshmet. Prioritet i dhamë karakterit publik të përdorimit të tyre, për të theksuar edhe më shumë atë për të cilën kjo zonë në tërësi kishte nevojë. Vetëm përmes një gërshtimi të tillë, përdorimit privat, publik, do të mund të krijojmë marrëdhënie ndërvarësie dhe bashkëpunimi mes tëra zonave rrethuese, të cilat duhej të merrnim në konsideratë. Krijimi i mundësive për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme tashmë në hapësirë, e jo më brenda, do të shtynte njerëzit të



bashkepunojnë më shumë mes tyre dhe jo vetëm. Ndërthurja e aktiviteteve të ndryshme, të realizuara si brenda dhe jashtë, me pjesëmarrjen e njerëzve të ndryshëm, të ardhur nga zona të ndryshme, do të ishte kyçi i krijimit të këtyre lidhjeve simbiotike që do të mbulonin tërë zonën...

**SUSPENCITY** (suspendet city) - prezanton modelin dhe shkallën "supercity" si një mënyrë jetese alternative, duke percaktuar pikën gjeneruese të kësaj megastrukturore. Sistemi ngrihet dhe përhapet si një re dhe siguron dukshmëri, fleksibilitet shërbimesh, një rrjet hapësirash publike dhe një përvijë krejt të re të jetës urbane.

Mënyra e pazakontë për të përdorur masën/plotin, plotëson kërkesat e një qyteti ku "muri urban" është një bllokues masiv i perceptimeve. Ky element fizik u përdor si një element për t'u riorganizuar që nga mënyra se si ai është formuar si bashkësi mikrostrukturash të bashkuara. Këto mikrostruktura shpërhapen për të formuar një mur të rrjetëzuar "pamje-jopamje".


Kalimi nga masa tek çmasizimi, duke i falur qytetit një hapësirë të re për eksplorim, ishte një ndjesi e subjektit të ndërmjetëm qytetas.

Hapësira e një Suspencity kërkon ta vendosi individin në një marrëdhënie jo më të përbërë nga marrëdhëniet e tij me ndërtesat, por të lexuar si dikush ndërmjet hapësirës.

Projekti përpiket të riperceptojë dhe tërësinë e termave që lidhen me historinë e qytetit, si qendërsia e cila nisi në mesjetë, ku kështjella ishte qendra e qytetit, bashkimi si rrjedhojë e evolucionit të qytetit gjithashtu

edhe zhvillimit urban nga e shkuara deri në periudhën e metropolit kontemporan.

